Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (181) SHTATOR 2021. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

BIG
një epokë e re dashurie
ndaj jush po nis tani

DEBAT/AKTUALITET

Zvogëlohet Dibra, të rinjtë ikin në emigracion

Nga **HYSEN LIKDISHA** — Faqe 6-7

REPORTAZH

Bulqiza, si ëndërr e keqe

Emisioni "Veting" në ABC News i kushton një reportazh special jetës së minatorëve në galeritë e Bulqizës.

— Faqe 8-9

HISTORI

Luftërat e Dibrës kundër ndërhyrjes ushtarake jugosllave i hapën rrugën shtetit kombëtar shqiptar

Nga **prof. BAJRAM XHAFA** — Faqe 16-17

EKSPOZITA

"NANA" - një rrëfim mbi historinë më të bukur që ka përcjellë njerëzimi

Nga **prof. SADIK SPAHIA** — Faqe 13

"Skavica, një ëndërr që ka nisur për t'u bërë realitet"

Disa banorë që kundërshtojnë ndërtimin e HEC Skavica u ndaluan të marrin pjesë në takim. Kundërshtimet e tyre deri më tani, bërë publike edhe përmes një peticioni dërguar autoriteteve të larta në vend, nuk janë marrë parasysh.

- **Neil Wilkinson, Drejtori teknik i Skavicës: "Në këtë luginë të bukur është vendi ku Skavica do të ndërtohet. Në këto momente jemi në procesin e kryerjes së studimeve, për të përcaktuar se ku do të jetë me saktësi vendndodhja e digës. Përtej kodrave do të kryhen studime të mëtejshme për të kuptuar madhësinë e rezervuarit, por edhe për të kuptuar limitet mjedisore që mund të ketë vetë. Punimet do të kryhen në funksion të mbrojtjes së mjedisit të bukur dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal".**
- **Belinda Balluku, Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë: "Ky investim do të ketë një impakt të madh edhe për zonën ku do të ndërtohet, e cila do të ketë një vëmendje të shtuar përmes zhvillimit të infrastrukturës, si dhe duke rritur mundësitë e zhvillimit turistik. Mbi të gjitha, HEC Skavica garanton për Shqipërinë një siguri energjetike e cila është një element mjaft i rëndësishëm. Zhvillimet e fundit, ku thuajse të gjitha shtetet po përballen me një krizë energjetike, e dëshmon më së miri këtë nevojë".**

Në foto: Ambasadorja e SHBA Yuri Kim dhe Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku në Skavicë, tetor 2021 (Foto: MEI)

KOMENT

Skavica, "ëndrra në sirtar" e qeverisë, është një ëndërr e keqe për banorët e luginës së Drinit dhe Dibrën mbarë

Deri më tani, si qeveria dhe si Bechtel duket se kanë frikë të përballen me banorët që shpërngulen. Disa prej tyre që kundërshtojnë projektin nuk u lejuan të hynin në kantier. Dhe kur qeveria dhe kompania nuk kanë "durim" të përballen me disa prej tyre, si do ta bëjnë atë me popullin e Dibrës?!

Nga **BUJAR KAROSHI** — Faqe 2

IDE: Rruga Lidhja e Prizrenit dhe investimet strategjike

Ndërtimi i Skavicës duhet të shoqërohet me një paketë investimesh strategjike në rajon

- **Lidhja me një rrugë nacionale të standardeve bashkëkohore të kategorisë C2 të Rrugës së Arbrit me Rrugën e Kombit dhe aeroportin Flatrat e Veriut, është një investim strategjik në dobi të vendit.**
- **Paketa e Investimeve Strategjike synon të ketë efekte të thella transformuese mbi të gjithë Luginë e Drinit të Zi, duke vlerësuar e marrë në konsideratë pasojat dhe ndikimin e HEC-Skavicës, jo vetëm për banorët nën kuotën e ujit 443 m, që do të detyrohen të zhvendosen, por edhe të të gjithë banorëve të rrethit të Dibrës, ku do të shtrihet ujëmbledhësi, pasi pasojat nuk janë vetëm mbi ata që zhvendosen, por edhe mbi banorët e fshatrave dhe qytetit Peshkopi, në të dy shpatet e vargmaleve, që konturojnë luginën e Drini të të Zi.**

Nga **HYSEN UKA** — Lexoni në faqen 4

NË BRENDËSI:

■ **Debati** në zgjedhjet vendore duhet të shpalosë idetë për zhvillimin e Dibrës së Madhe ■ **Selishta** - krahina e bukur që po braktiset për shkak të mungesës së rrugës ■ **Allajbegia**, lagjja ime ■ **Pavel Kunc**, aktivisti çek që po mbjell Lurën ■ Një ditë çoban në **Lurë** ■ **Zaim Elezi** ka krijuar simfoninë e tij në pikturë ■ **Lulzim Plaku**, djali i mrekullive ■ Pasioni për Dibrën i çidhnakut **Mustafa Tola** ■ **Beteja e Lanë Lurës**, epopeja e madhe e qëndresës ■ **Vesel Murrja** "Plaku" me famë i Dibrës ■ **Disa mbiemra** në trevën e Dibrës ■ Zall Dardha në ditarin e **Isuf Rashës** ■ Skamnorët, një novelë nga **Gëzim Loka** ■ Libri **"Kongresi i Dibrës"** i Qenan Zija Manastirit, dokumenti monumental ■ Lum ç`sokola ka le Lura, si **Marka Ndreca**, burrë mbi burra… ■ Ata sot janë përsëri bashkë…

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 9 (181). Shtator 2021
Gazeta doli nga shtypi, 5 shtator 2021.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit shtator 2021.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra
Editor i faqes online: Agim Deva
Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim Ashiku
Bajram XHAFA
Hysen LIKDISHA
Sadik SPAHIA
Ermir HOXHA
Dhimitri ÇIKA
Hysni BODINI
Agim SHEHU
Gafurr MUKA
Kamber FARRUKU
Bajram KRRASHI
Xhemal GAZIDEDE
Nafie JELLA
Danjel BICA
Gëzim LOKA
Arif MURRJA
Xheladin MURRJA
Haki PËRNEZHA
Valdrin VLESHA
Ilmi DERVISHI
Mevlud BUCI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Skavica, "ëndrra në sirtar" e qeverisë, është një ëndërr e keqe për banorët e luginës së Drinit dhe Dibrën mbarë

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ministrja Balluku prezantoi në Skavicë para ambasadores së SHBA "ëndërr në sirtar prej shumë dekadash", të cilën ajo dhe qeveria e saj po e bën realitet.

Por pavarësisht se diga në Skavicë do të mbulojë me ujë gjithë fushën e Dibrës, ajo nuk ka asnjë fjalë të thotë për këtë.

Ambasadorja e SHBA, krejt në detyrën e vet, i ka dalë në mbrojtje një kompanie amerikane, e cila ka marrë përsipër ndërtimin e këtij hidrocentrali. Por ata, në dukje, janë më të kujdesshëm. Thonë se "po përpiqen të punojnë me autoritetet lokale dhe komunitetin mes malesh në Skavicë", por për komunitetin pas malesh që do të mbulohet nga uji, nuk kanë fjalë për momentin.

Që të mos spekulojmë: qeveria shqiptare ka nënshkruar një kontratë me kompaninë amerikane Bechtel për ndërtimin e Skavicës, e cila ndahet në dy faza: faza e parë ka të bëjë me studimin teknik të projektit, si dhe studimin mjedisor e social, ndërsa faza e dytë është ajo e ndërtimit. Gjatë fazës së parë do të saktësohen edhe kostot e ndërtimit, diku te 500 milionë euro. Por mund të shkojë edhe 700 milionë euro, bazuar në përvojën e kësaj kompanie me financimin e Rrugës së Kombit. Por kjo është çështje tjetër.

Ndërsa banorët e Dibrës prisnin ditë pas dite nisjen e bisedimeve me kompaninë dhe qeverinë, kompania shkon dhe dërgon në Skavicë ca makineri shpimi për të parë strukturën gjeologjike të terrenit. Ndoshta ajo nuk e di se këto shpime janë kryer që në kohën e regjimit komunist, dhe me ato rezultate e projekte janë harxhuar deri më tani para nga KESH.

Sikur të mos mjaftonte kjo, Ministrja dhe Ambasadorja shkojne deri në Skavicë, për t'i thënë "medias së tyre" ato që i kanë thënë e stërthënë në konferencat e Tiranës në lidhje me HEC Skavica, së paku deri nga viti 2017 e këndej. Shkurt: Ata shkuan deri në Skavicë për planet me dron, sepse fjalët janë njësoj si në hollin e kryeministrisë.

Kronika e tyre e shkurtër televizive, sado e bukur dhe e mirë të jetë për investitorët dhe shpresëdhënëse për banorët e nën Shkodrës

Deri më tani, si qeveria dhe si Bechtel duket se kanë frikë të përballen me banorët që shpërngulen. Disa prej tyre që kundërshtojnë projektin nuk u lejuan të hynin në kantier. Dhe kur qeveria dhe kompania nuk kanë "durim" të përballen me disa prej tyre, si do ta bëjnë atë me popullin e Dibrës?!

Pamje nga Fushë-Alia, fshat i cili do të mbulohet nga rezervuari i HEC Skavica.

që do të shpëtojnë nga përmbytjet, është një kronikë plot lajme të kobshme për banorët e Dibrës. Përveç atyre që janë në qeveri. Madje, jo vetëm për ata 10 mije që do të marrin rrobat e do të shpërngulen, por edhe për ata të cilëve do t'u mbeten shtëpite në breg të liqenit apo kodrave të Dibrës.

Ajo që inxhinieri i Bechtel përpiqet të ruajë maleve rreth e rrotull Skavicës, nuk mund të ndodhë në fushën e Dibrës. Përveç aspektit historik e kulturor, që është shumë i rëndësishëm të ruhet, do të humbasin burimet e qëndrueshme ekonomike në këtë rajon. Studimi i Bechtel do ta nxjerrë në këtë konkluzion, por vendimi final: nevoja për energji do të jetë më e madhe dhe kështu që do ti hapet rruga ndërtimit të hidrocentralit.

Deri më tani, si qeveria dhe si Bechtel duket se kanë frikë të përballen me banorët që shpërngulen. Disa prej tyre që kundërshtojnë projektin nuk u lejuan të hynin në kantier. Dhe kur qeveria dhe kompania nuk kanë "durim" të përballen me disa prej tyre, si do ta bëjnë atë me popullin e Dibrës?!

Në këtë situatë, sot Kryeministri i vendit del si rrallëherë para popullit dhe njofton se po vjen një "krizë e jashtëzakonshme energjitike". Por "ne as nuk rrëzohemi as nuk dorëzohemi përballë sfidave të rënda të kësaj natyre... Më e mira do të bëhet dhe Shqipëria do të vazhdojë të synojë majën që i kemi vënë sëbashku, në rrugëtimin sfidues të kësaj dekade të re ku sapo kemi hyrë".

Kjo do të thotë se nuk ka konsultime. Edhe sikur të bëhen, ato do të bëhen diku fshehtas e diku nën presion e kërcënime. Ashtu siç ka ndodhur me çdo përrua në Shqipëri deri më tani.

Dhe kur gjithçka të ketë përfunduar fusha e nën Shkrodrës do të mbytet sërish, ashtu si edhe energjia në vend nuk do të jetë e siguruar. Atëherë dikush mund të kërkojë ndjesë, por do të jetë shumë vonë: Dibra do të jetë e ndarë në dysh dhe dhimbja e saj do të ndjehet veç te këngët me çifteli....

ZGJEDHJET VENDORE NË MAQEDONINË E VERIUT

Debati në zgjedhjet vendore duhet të shpalosë idetë për zhvillimin e Dibrës së Madhe

Nga **SHUAIP MARKU**

"If you win, you will be happy, if you lose, you will be wise" (Në qoftë se fiton, do të jesh i gëzuar; në qoftë se humb, do të jesh i mençur).

Me këtë fjali do e filloja këtë shkrim lidhur me këtë fushatë zgjedhore.

Le të jetë kjo fushatë një arenë idesh, që pa marrë parasysh se cili do të fitojë, idetë do të jenë një bazë e mirë për zhvillimin e Dibrës. Njëri do gëzohet, tjetri do të përfitojë eksperiencë e Dibra do të fitojë ide të reja, vullnet dhe optimizëm. Pra ja vlen!

Ja çka duhet të bëhet sipas meje:

1. Që të ketë ujë duhet së pari të rritet arkëtimet e pagesave të ujit nga ana e familjeve, bizneseve dhe institucioneve lokale. Nëse rritet përqindja e arkëtimeve, shumë lehtë mund të gjesh mbështetje për projekte të tjera. E kam fjalën këtu për pagesat e papaguara të faturave të ujit, jo për rritjen e çmimit të ujit.

2. Qyteti duhet të jetë i pastër, dhe për këtë duhet që qytetarët, bizneset, institucionet, fshatrat të paguajnë për mbledhjen e mbeturinave. Duhet që inspektorët të ndjekin pastërtinë në qytet dhe ti dënojnë ndotësit. I madh e i vogël e dinë se nuk duhet ti hedhin mbeturinat kudo, por përsëri i hedhin. Vetëm gjobat ndaj shkelësve do të çojë në ndryshimin sjelljes. Gjithashtu, duhet të fillojë të selektohen mbeturinat, së pari plastikën dhe letrën. Duhet të nxiten qytetarët që të denoncojnë ndotësit. Komuna të rifreskojë planet për veprim në mjedis dhe strategjinë për biodiversitetin".

3. Që të ndërtohet e të mirëmbahet qyteti duhet që komuna ti mbledh taksat komunale nga banesat, kompanitë. Duhet që ti mbledh koncesionet, tatimet nga shitblerjet, legalizimit, taksat komunale sipas vlerave reale.

4. Për të pasur komunikacion dhe parkingje duhet që parkimi në rrugën kryesore të bëhet me pagesë (deri në 20 min pa pagesë) me çka do të ketë gjithmonë vendparkime të lira dhe klientët do të kenë vend për të kryer shërbimet e për të bërë pazar.

5. Për tu zhvilluar ekonomia lokale, së pari duhet të freskojë strategjinë lokale të zhvillimit ekonomik lokal. Komuna duhet tu ofroj lokacion pa pagesë për ndërtime të objekteve prodhuese, tu sigurojë rrymë, ujë.... Të krijojë një ekip profesional, të cilët do t'u vijnë në ndihmë kompanive, bujqve e të rinjve në përgatitjen e planeve të biznesit, aplikimeve në fonde, grante e burimeve të tjera. Për investime nga diaspora komuna ta marrë përsipër kryerjen e të gjitha formaliteve administrative. Të nxisë zhvillim e turizmit e të investojë në markimin e vendeve turistike e aktivitete tjera për zhvillimin e turizmit (siç po bëhen në Peshkopi).

6. Për të zhvilluar sektorin e shoqërisë civile, komuna duhet t'u sigurojë një hapësirë të përbashkët, ku ata do të punonin, të mbështes me bashkëfinancime projektet, të aplikojë në projekte në partneritet me shoqata dibrane.

7. Për të qenë transparente dhe e hapur për qytetarët komuna duhet ta planifikoj buxhetin së bashku me qytetarët. Duhet që seancat e këshillit të jepen online në internet dhe live në televizionin lokal. Për çdo punë që bëhet të vendosen tabela me informata mbi punën si: vlerën, kohën e punimit, financimi, mbykqyrësi etj.

8. Që të zhvillohet kulturën, duhet që Pallati i Kulturës të kalojë në varësi dhe pronësi të komunës, siç kanë bërë shumica e qyteteve tjera. Në këtë mënyrë do të tërhiqen edhe financimet për kulturën.

Këto janë disa nga problematikat që duhet të dëgjohen gjatë një fushate si dhe mbeten për zgjidhje për fituesin e zgjedhjeve lokale në Dibër.

** Autori është aktivist i shoqërisë civile*

aktualitet

“Skavica, një ëndërr që ka nisur për t’u bërë realitet”

Neil Wilkinson, Drejtori teknik i Skavicës: “Në këtë luginë të bukur është vendi ku Skavica do të ndërtohet. Në këto momente jemi në procesin e kryerjes së studimeve, për të përcaktuar se ku do të jetë me saktësi vendndodhja e digës. Përtej kodrave do të kryhen studime të mëtejshme për të kuptuar madhësinë e rezervuarit, por edhe për të kuptuar limitet mjedisore që mund të ketë vetë. Punimet do të kryhen në funksion të mbrojtjes së mjedisit të bukur dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal”.

Belinda Balluku, Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë: “Ky investim do të ketë një impakt të madh edhe për zonën ku do të ndërtohet, e cila do të ketë një vëmendje të shtuar përmes zhvillimit të infrastrukturës, si dhe duke rritur mundësitë e zhvillimit turistik. Mbi të gjitha, HEC Skavica garanton për Shqipërinë një siguri energjetike e cila është një element mjaft i rëndësishëm. Zhvillimet e fundit, ku thuajse të gjitha shtetet po përballen me një krizë energjetike, e dëshmon më së miri këtë nevojë”.

FJALA E AMBASADORES YURI KIM NË FILLIMIN E PROJEKTIT PËR HIDROCENTRALIN E SKAVICËS

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku së bashku me ambasadoren amerikane në vendin tonë, Yuri Kim dhe drejtorin e KESH, Ergys Verdho kanë inspektuar zonën ku është parashikuar ndërtimi i HEC Skavicës, ku tashmë ka nisur puna në terren për përgatitjen e projektit final të kësaj vepre.

Në këtë inspektim ka marrë pjesë edhe një delegacion i nivelit të lartë të kompanisë amerikane Bechtel, i kryesuar nga Shaun Kenny, President global i Bechtel Infrastructure dhe Justin Siberel, President për rajonin e Europës dhe Lindjen e mesme.

Punimet e para në terren janë përqendruar në studimin gjeologjik të zonës dhe më tej do të vijojnë studimet për të përcaktuar vendin ku do të ndërtohet diga dhe elementët e tjerë të veprës.

“Në këtë luginë të bukur është vendi ku Skavica do të ndërtohet. Përafërsisht në gjysmën e luginës është vendi ku do të ndërtohet diga. Në këto momente jemi në procesin e kryerjes së studimeve, për të përcaktuar se ku do të jetë me saktësi vendndodhja e digës. Ne kemi filluar gërmimet e para, por duhet të bëjmë dhe disa gërmime të tjera për të parë dhe vërejtur gjeologjinë e gurit në këtë zonë. Në javët në vijim do të punojmë me Bashkinë dhe autoritetet lokale për të ndërtuar më shumë rrugë kantieri, që të na lejojnë aksesin për tek gryka”, u shpreh gjatë inspektimit Neil Wilkinson, Drejtori teknik i Skavicës.

Përtej kodrave do të kryhen studime të mëtejshme për të kuptuar madhësinë e rezervuarit, por edhe për të kuptuar limitet mjedisore që mund të ketë vetë. Përfaqësuesi i Bechtel siguroi se punimet do të kryhen në funksion të mbrojtjes së mjedisit të bukur dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin lokal.

Ndërtimi i HEC Skavicës, u shpreh ministrja Belinda Balluku, nuk është thjesht një vepër, por një ëndërr për të cilën tashmë ka nisur puna për t’u bërë realitet. Ndërtimi i kësaj vepre, jo vetëm rrit sigurinë energjetike, por edhe kapacitetet prodhuese të Shqipërisë duke avancuar kështu drejt ambicies për ta bërë vendin tonë në një eksportues të energjisë.

“Shqipëria prej kohësh po mundohet që të rrisë kapacitetet e prodhimit vendas, duke krijuar kështu një mundësi më të madhe të mbulimit të nevojave të tregut dhe duke e kthyer Shqipërinë në një vend eksportues të energjisë të rinovueshme dhe jo në një vend importues me çmime të mëdha, të cilat krijojnë probleme shumë të rëndësishme financiare në buxhetin e shtetit”, deklaroi Balluku.

Ky investim do të ketë një impakt të madh edhe për zonën ku do të ndërtohet, e cila do të ketë një vëmendje të shtuar përmes zhvillimit të infrastrukturës, si dhe duke rritur mundësitë e zhvillimit turistik. Mbi të gjitha, HEC Skavica garanton për Shqipërinë një siguri energjetike e cila është një element mjaft i rëndësishëm. Zhvillimet e fundit, ku thuajse të gjitha shtetet po përballen me një krizë energjetike, e dëshmon më së miri këtë nevojë.

“Duke ndërtuar Skavicën në këtë zonë ne kërkojmë të arrijmë disa parametra, të cilët kanë të bëjnë me sigurinë energjetike. Në ditët e sotme tek shohim se çfarë po ndodh në tregjet ndërkombëtare, me mungesën e fosileve apo me mungesën e gazit, apo qoftë edhe me masat e reja të cilat janë marrë për të dekarbonizuar situatën e krijuar nga prodhimi energjetik, sot shikojmë që në tregjet ndërkombëtare energjia po shitet me diferencë shumë të madhe nga ajo që shitej para një viti, duke krijuar kështu probleme dhe mungesa të mëdha dhe duke e bërë çmimin të arrijë limite të paparashikueshme deri më sot. Ndaj siguria energjetike është thelbi i këtij projekti të rëndësishëm”, nënvizoi Balluku.

Drejtori i KESH Ergys Verdho sqaroi se tashmë janë më shumë se 50 inxhinierë, të profileve të ndryshme, që bashkëpunojnë me kompaninë Bechtel dhe KESH në të njëjtën kohë dhe se projekti do të shqyrtohet nga tre palë dhe do të ketë oponencën e të gjithë inxhinierëve. *(MEI)*

Është e mrekullueshme që jam me ju sot pasi do të shënojmë një çast me të vërtetë të veçantë për Shqipërinë, për lidhjet tona të biznesit dhe për të ardhmen e energjisë në Evropë.

Sa rrugë të gjatë kemi bërë në këtë periudhë një-vjeçare! Gati 12 muaj më parë, më 3 tetor 2020, Nënsekretari i atëhershëm për Rritjen Ekonomike, Energjinë dhe Mjedisin Keith Krach vizitoi Shqipërinë dhe nënshkroi një Memorandum të Bashkëpunimit Ekonomik midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë.

Ishte një shenjë e përkushtimit të Shteteve të Bashkuara për të thelluar marrëdhënie ekonomike midis dy vendeve tona, çka është gjithashtu një nga tri prioritetet e mia si Ambasadore e SHBA në Shqipëri. Po atë ditë, Ministrja Balluku nënshkroi një marrëveshje mirëkuptimi me Bechtel për projektin e Skavicës.

Dhe ja ku jemi një vit më pas! E sotmja është një ditë historike në këtë marrëdhënie me fillimin e projektit për hidrocentralin e Skavicës, midis Qeverisë së Shqipërisë dhe një prej kompanive më të mëdha amerikane të infrastrukturës, Bechtel. Skavica ka qenë një ëndërr në vend, për dekada të tëra, dhe sot është një nga gurët më të rëndësishëm kilometrikë që më në fund po e shohim të bëhet realitet.

Ky projekt jo vetëm që do të krijojë më shumë energji të gjelbër, por gjithashtu do të ndihmojë që Shqipëria të jetë një hap më pranë shndërrimit në një eksportues të qëndrueshëm të energjisë, më shumë se sa importon, dhe që mund të ndihmojë për të zgjidhur ndryshimet klimatike dhe shqetësimet e shëndetit publik, jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe brenda një rajoni që është tepër i varur nga fabrikat ndotëse të qymyrit.

Projekti i përfunduar do të ketë një ndikim të thellë në peizazhin energjitik të Shqipërisë, një vend që tashmë mburret me një nga ndërthurjet më të gjelbra të prodhimit të energjisë elektrike në botë. Në fakt, sapo kam qenë në një konferencë ndërkombëtare të energjitikës dhe fola për rolin emocionues që Shqipëria po luan në sektorin e energjisë. Ky projekt jo vetëm që do të krijojë më shumë energji të gjelbër, por gjithashtu do të ndihmojë që Shqipëria të jetë një hap më pranë shndërrimit në një eksportues të qëndrueshëm të energjisë, më shumë se sa importon, dhe që mund të ndihmojë për të zgjidhur ndryshimet klimatike dhe shqetësimet e shëndetit publik, jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe brenda një rajoni që është tepër i varur nga fabrikat ndotëse të qymyrit.

Është një nder të jem këtu me Bechtel për të parë nisjen e punës në Skavicë. Ju përgëzoj që të gjithëve dhe mirëpres më shumë projekte mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara.

Fjalimi i parapërgatitur, marrë nga https://al.usembassy.gov.

Një ide se ku kalon rruga "Lidhja e Prizrenit" mund ta ndiqni këtu:
https://tinyurl.com/xethahwc
ose skano kodin:

Ndërtimi i Skavicës duhet të shoqërohet me një paketë investimesh strategjike në rajon

Nga HYSEN UKA

Nisma për rrugën "Lidhja e Prizrenit" është shpallur në maj të vitit 2019, në Konferencën e organizuar nga LID, me objekt zhvillimin e rrjetit lokal rrugor, në rrethet Bulqizë - Dibër dhe mban logon e shoqatës "Nisma për Zhvillim e Kulturë Rajonale – Nisma Dibrane, Peshkopi".

Shoqata "Nisma" nuk është grup interesi me mision të ngushtë e të përcaktuar për mbrojtje sipërmarrjesh apo e interesash ekonomike. Nuk ka synime, përcaktime e kufizime politike, por bashkon njerëz që kanë ide e vizione për zhvillim social-ekonomik e kulturor të rajonit të Dibrës. Shoqata jonë është grup ndikimi në vendimmarrjen politike të qeverive në vijimësi, për tejkalimin e prapambetjes së thellë dhe degradimit që po pësON rajoni i Dibrës, si një nga rajonet që kontribuon ndjeshëm me pasuritë e tij në zhvillimin e ekonomisë kombëtare, ku në rend të parë janë kromet, gipset, pyjet, ujërat, kontribut të vlerësueshëm në të ushqyerit e popullsisë me produkte të shëndetshme bujqësore e blegtorale.

Formalizimi i Nismës dhe vënia e saj në lëvizje nisej nga vlerësimi i ndikimit të faktorëve të rinj, nga realitetet e reja që krijoheshin në mbarë rajonin, posaçërisht në Luginën e Drinit të Zi (në pjesën nga Gjorica deri në Bushat-Kukës, ku Drini i Zi, derdhet në ujërat e Liqenit të Fierzës), me përfundimin në territorin shqiptar të Rrugës së Arbrit (ndërsa në vështrimin tonë, Rruga e Arbrit konsiderohet e plotë dhe e përfunduar vetëm kur të kyçet me Korridorin e Tetë, në Kërçovë (Izvor) në Maqedoni), me ndërtimin e pjesshëm dhe vënien në shfrytëzim të autostradës Durrës-Kukës-Morinë-Prishtinë, e ashtuquajtura Rruga e Kombit, me përparimin e punimeve për zgjerimin dhe vënien në përdorim si aeroport civil të aeroportit të Kukësit, tashmë i hapur dhe që mban emrin Aeroporti Zyed – Flatrat e Veriut.

Në këtë kontekst kohor, edhe pse ishte folur e flitej vazhdimisht, jo pak, por që prej 50 vitesh për ndërtimin e HEC-Skavicës, si një vepër e munguar që do të plotësonte projektidenë fillestare të sistemit kaskadë të HEC-eve mbi lumin Drin, në kohën kur ne shpallëm dhe vumë në lëvizje nismën nuk ishte evident ndërtimi i HEC-Skavicës dhe, përveç çfarë ishte folur e flitej vazhdimisht prej vitesh në opinion, nuk kishte plane të shpallura nga qeveria apo punë konkrete në terren, që të mendoje se ky projekt do të realizohet. Kjo kushtëzohej edhe me situatën dhe pamundësinë financiare të shtetit shqiptar dhe mospranimi prej qeverisë shqiptare i ofertave dhe mbështetjes financiare nga shtete jo mike për Shqipërinë dhe partnerët tanë strategjik. Faktori HEC- Skavicë është futur më vonë në kontekstin e faktorëve që ne kishim vlerësuar, ndaj nuk ka qenë premisë fillestare për ndërmarrjen e nismës nga shoqata, për ndërtimin e rrugës "Lidhja e Prizrenit". Pra, nisma për ndërtimin e rrugës "Lidhja e Prizrenit" ka lindur jashtë dhe e pavarur, e pakushtëzuar nga ndërtimi apo mosndërtimi i Hec-Skavicës. Kjo është një e vërtet që mbështetësit apo kundërshtarët e saj për ndërtimin e kësaj rruge duhet ta mbajnë fort parasysh. Ne nuk kemi pasur synim as të nxisim, të shpejtojmë dhe as të bllokojmë projektin për ndërtimin e HEC-Skavicës. Çdo interpretim e koment se Shoqata është ndikuar e përdorur nga qeveria si mbështetëse, ndikuese apo vegël e qëllimeve të saj, është dashakeqësë, thjesht shpirt e mendjengushtësi. Por, pohojmë gjithashtu se e çmojmë të dobishëm dhe investim të domosdoshëm për zhvillimin ekonomik dhe sigurinë energjetike kombëtare, ndërtimin e HEC-Skavicës, pavarësisht dhimbjes që na krijon transformimi rrënjësor dhe i përjetshëm i Luginës, e cila nuk do të jetë dhe as nuk mund të jetë më kurrë si më parë. Por, dikotomia e mirë - e keqe, pozitive - negative, e gëzueshme dhe hidhëruese, e dobishme, por dhe me pasoja..., është determinante dhe e pazhbëshme.

Ne, sipas optikës sonë, e kemi vlerësuar si projekt të domosdoshëm lidhjen me një rrugë nacionale të standardeve bashkëkohore, (rrugë të kategorisë C2), të Rrugës së Arbrit me autostradën Durrës-Kukës-Prishtinë, Rrugën e Kombit. Rruga aktuale Peshkopi-Kala e Dodës (Vasije 1150m)- Bushtricë- Lusën- Qafë Resk- Kolesjan- Kukës (75 km) është një anormalitet i papranueshëm, një zgjidhje e sajuar, një kompilim midis rrugëve të ish kooperativave malore të Kukësit e Dibrës me rrugët ushtarake të ndërtuara gjatë kohës së fortifikimit në brezin kufitar në rrafshat e Korabit. Ne e kemi quajtur këtë një "gjalm rrugor", sfilitës e i rrezikshëm, me ritëm qarkullimi tepër të ngathtë, tërësisht të papërshtatshëm jashtë kohe (si në fillim shekullit të kaluar).

Qëllimi i projektidesë për rrugën "Lidhja e Prizrenit" është eliminim sa më parë i këtij anormaliteti në rrjetin rrugor kombëtar në rajonin e Dibrës. Mungesa e një korridori rrugor, që do të bashkonte e do të optimalizonte lidhjen e infrastrukturës rrugore midis dy nukleve të qarkullimit e të transporteve, rrugore e aeroportuale, do të funksionalizonte gjithë Luginën e Drinit të Zi me qarkullim normal bashkëkohor, duke sjellë efekte të mëdha pozitive në të gjitha aspektet e jetës e veprimtarisë për banorët e Dibrës mbarë, e më gjerë të fushëgropës Kukës-Prizren Gjakovë dhe nga ana tjetër Dibër e Madhe - Strugë – Ohër, si dhe Prizren-Kukës Dibër – Tiranë. Pra, lugina "e thellë", "e errët" dhe "e mbyllur" e Drinit të Zi, (siç e cilëson V.Vaina) do të hapej dhe lëvizshmëria e lartë në të dy senset do të krijonte një realitet të ri, me më shumë dritë zhvillimi. Ne e gjykojmë tërë këtë prapambetje infrastrukturore, këtë mungesë vëmendje dhe mungesë investimesh në luginë, si mungesë vizioni, dritëshkurtësi në vlerësimin e prioriteteve dhe strategjive të zhvillimit në vend apo dhe mungesë vullneti e sektarizëm në shpërndarjen e të ardhurave dhe investimeve kombëtare. Kjo nyje gordiane urgjent duhet të pritet, të shpërbëhet, sepse i është lidhur në grykë jo vetëm luginës së Drinit të Zi, por zhvillimit në tërësi, rajoneve lindore nga Dibra e Madhe e deri në Prizren.

Këto pjesë të tërësisë tokësore të kombit tonë janë cilësisht një njësi unike kombëtare, jo pse këtë e themi apo e dëshirojë ne, por e gjithë historia jonë e vjetër dhe e re e dëshmon këtë, që nga përhapja e zhvillimi i qytetërimeve të vjetra brigjeve të dy Drinave, në kohën e qëndresës kundër perandorisë otomane, në vitet e lavdishme të Lidhjes së Prizrenit e deri në kohën e luftërave kundër invadorëve serbë në shekullin e kaluar. Strategët e mbretërisë serbe, punuan me të gjitha mjetet; politike, ushtarake e represive, diplomatike, të blerjes së disa krerëve e diversionit, që këtë rajon ta fragmentonin, ta ndanin, ta mbanin të përçarë, sepse si një i tërë përbënte një fuqi të rrezikshme për qëllimet e tyre. Ata përdorën të gjitha mjetet dhe aleancat që të mbetej e ndarë Dibra e Madhe nga Dibra e Poshtme (Dibra e Vogël), që Kukësi e Luma të ndaheshin nga Prizreni dhe i gjithë rajoni të mbahej i përçarë e i copëtuar.

Projekti ynë është menduar si një mjet integrimi fizik të këtyre krahinave, si faktor që mund t'i shërbejë rikthimit të komunikimit intensiv dhe përtëritjes e forcimit të unitet të thyer e të munguar. Nëse nuk shkojmë e nuk vijmë, nëse nuk shihemi e nuk takohemi, nëse nuk japim e marrim, nëse nuk ndjehemi, lidhja jonë zbehet, shuhet dhe shpejt në kohë, nuk jemi asgjë... Ndarja e izolimi i kanë kushtuar shumë veçanërisht dy Dibrave, Kukësit e Prizrenit, Tropojës e Gjakovës.

Ta aktualizojmë arsyetimin, të kthehemi në situatën e tanishme, ku po punojmë për promovimin e Nismës, për të fituar mbështetjen e banorëve të Dibrës e Kukësit dhe vëmendjen e qeverisë, për ndërtimin sa më të shpejt të korridorit Lidhja e Prizrenit, pra, t'i japim zë të fortë domosdoshmërisë së bashkimit sa më parë të Rrugës së Arbërit me Rrugën e Kombit dhe aeroportit, përmes rrugës "Lidhja e Prizrenit".

Tani është shtuar edhe një faktor i ri, ndërtimi i HEC-Skavicës, faktor i imponuar, i dëshiruar apo i padëshiruar nga një pjesë e banorëve që preken drejtpërdrejt prej tij, projekt që askush nuk ka mundësinë ta zmbrapsë dhe as nuk duhet ta pengojmë, duke arsyetuar mbi rëndësinë e madhe për sigurinë energjetike dhe ndikimin e drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare e zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Pas nënshkrimit me 3 tetor 2020 të memorandumit të mirëkuptimit midis SHBA dhe Shqipërisë për HEC Skavica, si dhe nënshkrimit të kontratës për studimin dhe ndërtimin e saj nga kompania Bechtel, ne nuk mund të jemi symbyllur e mendjeshkurtër për të mos marrë në konsideratë realitetin dhe kushtet e reja të krijuara. Në këtë kontekst të krijuar, rivlerësuam dhe ridimensionuam propozim-idenë tonë, duke konceptuar atë si një Paketë Investimesh Strategjike, ku bosht është ndërtimi i rrugës "Lidhja e Prizrenit", por që përmban edhe investime për elemente të tjerë të paketës.

Paketa e Investimeve Strategjike synon të ketë efekte të thella transformuese mbi të gjithë Luginë e Drinit të Zi, duke vlerësuar e marrë në konsideratë pasojat dhe ndikimin e HEC-Skavicës, jo vetëm për banorët nën kuotën 443, (pra nën kuotën e ujit) që do të detyrohen të zhvendosen, por edhe të të gjithë banorët e rrethit të Dibrës ku ko të shtrihet ujëmbledhësi.

Ne propozojmë me paketën tonë investime të gjithanshme dhe afatgjata në të mirë të të gjithë Dibrës, jo vetëm të atyre nën kuotën 443, pasi dhe pasojat nuk janë vetëm mbi ata që zhvendosen, por edhe mbi banorët e fshatrave dhe qytetit Peshkopi, në të dy shpatet e vargmaleve, që konturojnë luginën e Drini të Zi.

Dibra shumë shpejt do të kenë në prehër një ujëmbledhës aq të madh, nga më të mëdhenjtë në rajon, prej të cilit nuk duhet të vuajë vetëm pasojat, por të gëzojë edhe dobitë, të mirat, madje të shumëfishuara.

Pse ne e quajmë projet-propozimin tonë "Paketë Investimesh Strategjike"? Dikujt fjala "strategjike" i duket e madhe, teprim, barrë e rëndë për qeverinë dhe shtetin. Asnjëra prej këtyre nuk qëndron, madje mund të themi se si gjithmonë njerëzit tanë janë përmbajtur në kërkimin e të drejtave të tyre, të asaj çfarë u takon.

Paketa, së pari, kushtëzohet të jetë "strategjike", për shkak se detyrohet të realizohet si pasojë e një vepre apo projekti strategjik kombëtar, siç është HEC- Skavica. Ndikimet dhe pasojat e tij tejkalojnë disa herë zgjidhjet e thjeshta e të lehta operative apo zgjidhje të shpejta dhe afatshkurta. Një vepër strategjike si Skavica, për shkak të pasojave e problemeve shumë e të mëdha sociale-ekonomike, mjedisore, emocionale etj., detyrimisht kërkon mendim e zgjidhje strategjike. Ujëmbledhësi i madh pushton tokat, banesat, trojet, varret, rrugët, madje edhe rrugën e parë automobilistike të lidhjes Kukës-Peshkopi, rrugën historike, Rrugën e Rinisë, ndërtuar me aksion në vitin 1946.

Ujëmbledhësi vë nën vete brigje, ranishte, livadhe, pyje e gjallesa, peizazhe që konfiguracionin larmishëm, bukur e madhështor shtratit të Luginës, të papërsëritshëm e unikal, në të cilin breza e breza njerëzish kanë parë për të parën herë dritën e diellit, kanë endur jetesën e ëndrrat e tyre nga lindja në vdekje, duke ju krijuar një brengë e një pezëm të madh prej të cilit nuk do të shpëtojnë sa të jenë gjallë.

Këta njerëz, në këtë mjedis kanë mbrujtur kuptimin e fjalës atdhe dhe dashurinë për të. Se Atdheu është shtëpia, ara, livadhi, mali, përroi, lumi, ferra, lisi, pylli, zogu, bulkthi, bilbili, qukapiku, ujku, dhelpra, ariu, vesa e barit, krifat e pishave, rrahja e zemrës për të parën vajzë, netët ëndërrimtare për të parin djalë, përkëdhelitë e nënës dhe loti për të, malli për babain, gëzimet dhe trazimet nga lindja në vdekje... Të gjitha këto janë ajo pasuri, ajo pronë e paçmueshme, për të cilën nuk ka kurrë shlyerje nga asnjë bankë nga asnjë thesar... Këta njerëz të gjitha këto do t'i japin, do t'i bëjnë theror në themelet e një ujëmbledhësi, të një vepre prej të cilës i gjithë vendi do të marrë dritë dhe kjo është një sakrificë aq e madhe, që nuk mund të shlyhet me asnjë paketë investimesh sado e madhe e strategjike që mund të jetë.

E bëmë këtë enumeracion të asaj çfarë japin e sakrifikojnë këta njerëz për dritën, për të kuptuar se ata nuk mund të lihen në errësirë, në brengë e në dëshpërim, të nëpërkëmbën e të mashtrohen me thërrime, të përçahen e t'i nënshtrohen arbitraritetit.

Ata që planifikojnë ndërtimin e veprës për të gjitha këto duhet të mbajnë shënime e të bëjnë llogari, sepse vepra është një investim për fitim,

për të mirën dhe interesin afatgjat kombëtar, ndaj nuk mund t'i hyjë në hak asnjë qytetari e jo më një rajoni, një krahine.

Për këta banorë, një Paketë Investimesh Strategjike, që do të përmbante ndërtimin e rrugës "Lidhja e Prizrenit", përqendrimin në një qytezë, me emër domethënës, Kastrioti i Ri apo qyteti Gjergj Kastrioti, të të gjithë atyre që u pushtohen shtëpitë dhe trojet, një qytezë ku ata do të fitonin një mënyrë jetese urbane më të mirë, me shkolla, spitale, qendër kulture, siguri... (duke lënë pas mënyrën rurale të jetesës), duke ruajtur njësinë komunitare aktuale, duke mos e shpërndarë organizimin e sotëm sipas lagjes, fshatit etj., dhe më e rëndësishmja, duke mos i përzënë nga Dibra, por duke ju krijuar mundësi joshëse për të vazhduar në Dibër. Ndërtimi i rrugës "Lidhja e Prizrenit" do të jetë një faktor që do të ofrojë investitorë që do të kenë interes të përdorin krahun e punës në këtë qytet, duke bërë investime në industri të lehtë etj.

Në thelb, nisma jonë, me Paketën e Investimeve Strategjike, synon një marrëveshje të përgjithshme të të gjithë banorëve që u preket prona dhe mënyra e jetesës nga HEC-Skavica, të mos kërkojnë shlyerje apo kompensim të pronave dhe pasurive që humbasin me para në dorë, por të gjithë të bien dakord dhe të kërkojnë kompensim apo shlyerje të çdo njësie pasurie me njësi pasurie fizike, d.m.th për shtëpi që humbasin të marrin shtëpi sipas kurorëve në qytetin e ri, për tokat produktive, atyre që duan të ruajnë marrëdhëniet me tokën, t'u jepet toka nga tokat e ish NB-ve, aktualisht toka të braktisura, të njohura si publike, t'u jepen grante e mbështetje për t'i kthyer këto toka në prodhuese, të kompensohen e të mbështeten ata që duan të merren me blegtori, ata që duan të merren me bletari, peshkim etj...

Kjo mënyrë shlyerje mendojmë se mund të maksimalizojë kompensimin e këtyre njerëzve për sakrificën që do t'ju duhet të bëjnë dhe vetë Paketa Strategjike e Investimeve do të jetë një dobi e madhe jo vetëm për ata, por për të gjithë Dibrën, e cila përfiton një rrugë dhe një aeroport.

Paketa e Investimeve Strategjike duhet të studiohet, të integrohet e të realizohet njëkohësisht me fillimin e përfundimin e ndërtimit të HEC- Skavicës.

Kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe mirëpresim çdo vërejtje, propozim, por edhe kritikë për këtë skicë të idesë dhe të nismës sonë për Paketën Strategjike të Investimeve, me bosht ndërtimin e rrugës "Lidhja e Prizrenit".



© Foto Agim Totraku

Krahina **e bukur** që po braktiset për shkak të mungesës **së rrugës**

Braktisja e këtij segmenti të rrugës nacionale Peshkopi-Burrel po çon në braktisjen e fshatrave që e përdorin atë. Është gjendje e trishtueshme të shohësh gjithandej shtëpi e kulla të moçme 2- 3 katshe të rrënuara e të tjera në prag të shembjes, kur për ngritjen e tyre kanë bërë mund të madh disa breza dhe mbartnin ngjarje e histori interesante.

Nga **prof. HYSNI BODINI, ing. AGIM SHEHU**

Rruga nacionale Burrel-Peshkopi po bën një shekull nga ndërtimi. U fillua nga qeveria e mbretërisë së Zogut I dhe u përfundua nga Italia menjëherë pas pushtimit të Shqipërisë. Dy qytetet ishin të lidhura edhe me rrugën Peshkopi- Bulqizë- Burrel.

Pse u ndërtua atëherë kjo linjë? Mendoj se studimi dhe propozimi i ekspertëve të mbretërisë dhe atyre italianë për ndërtimin e kësaj rruge është argumentuar jo vetëm për shkurtimin e distancës me 30 km por edhe në leverdinë ekonomike jo vetëm të komunave të Lisit, Macukullit, Selishtës, Muhurrit etj. dhe dy qyteteve Peshkopi e Burrel, por edhe në shkallë kombëtare për pasuritë e mëdha minerare, pyjore,bimëve mjekësore, resurseve turistike,pasurive kulturore,vendbanimeve të lashta historike që mbartin këto zona. Arsye e dytë ka qenë ajo gjeostrategjike. Nuk mund të them me saktësi por besoj mund të jetë rruga e vetme që lidh dy qytete akoma e pa asfaltuar. Në 80 vite përmes kësaj arterie rrugore janë përcjellë çdo vit mijëra metro kub dërrasë (kur funksiononin stabilimentet e sharrave Prat e Mbasdeje), lëndë ndërtimi për nevojat e vendit, trup ahu e pishe, degë vozi për eksport, shtylla miniere e dru zjarri. Përmes kësaj rruge janë transportuar sasira të mëdha mineral kromi, mermeri e bimësh mjekësore për eksport, duke dhënë kontribut në buxhetin kombëtar. Për një periudhë të gjatë kjo rrugë ka përballuar transportin e mijëra ton drithëra buke e ushqime për rezervën shtetërore në depot e posaçme në Qafmurrë e Lunarë dhe po aq municione e materiale tjera ushtarake në Macukull e Selishtë.

Këtë rrugë e kanë shfrytëzuar për shumë vite ish parqet automobilistike të Tiranës e Durrësit dhe më vonë të Dibrës, Matit e Laçit. Kur ka bërë një shërbim kaq të dobishëm jo vetëm lokal por edhe kombëtar sigurisht që diku e nga dikush tjetër do ishte asfaltuar dhe mirëmbajtur.

Problemi është se në 6 fshatrat e njësisë administrative të Selishtës jetojnë akoma njerëz që nuk u është venitur shpresa për përmirësim e asfaltimin e rrugës, pavarësisht premtimeve në çdo prag zgjedhje lokale e kombëtare e më pas gënjeshtrave spektakolare.
Braktisja e këtij segmenti të rrugës nacionale Peshkopi- Burrel po çon në braktisjen e fshatrave që e përdorin atë. Është gjendje e trishtueshme të shohësh gjithandej shtëpi e kulla të moçme 2- 3 katshe të rrënuara e të tjera në prag të shembjes, kur për ngritjen e tyre kanë bërë mund të madh disa breza dhe mbartnin ngjarje e histori interesante.

Tek e fundit kur ekzistonte një ndërmarrje e mirëmbajtjes së rrugëve në periudhën e regjimit komunist dhe disa viteve postkomuniste kishte punëtorë të përditshëm që punonin e përgjigjeshin për mirëmbajtjen e disa km., ndaj gjendja ishte më e pranueshme. Sot është rrugë e braktisur, ndoshta e përshtatshme për makinat sportive të Reallit, të cilat edhe këtë vit e përdorën për gara.

Drejtuesit e mjeteve që përshkojnë segmentin Muhurr-Lis ballafaqohen shpesh me vështirësi e defekte të kushtueshme për ti riparuar. Në hall edhe pasagjerët që shkundin brinjët kur udhëtojnë me linjat e përditshme për Peshkopi, Burrel e Tiranë.

Problemi është se në 6 fshatrat e njësisë administrative të Selishtës jetojnë akoma njerëz që nuk u është venitur shpresa për përmirësim e asfaltimin e rrugës, pavarësisht premtimeve në çdo prag zgjedhje lokale e kombëtare e më pas gënjeshtrave spektakolare.

Fillimi i tranzicionit e gjen zonën e Selishtës me mbi 6000 banorë, ndërsa aktualisht nuk është as 1/6 e tyre.

Arsyet e largimit janë të ndryshme por ndër më kryesoret është rruga. Pos të tjerave nxënësit që mbarojnë klasën e 9-të nuk mund të ndjekin shkollën e mesme në qytet, pasi sot duhet 1 orë e gjysmë, kur 25 km për Peshkopi mund të përshkohen për 30'.

Mjekët hezitojnë të vinë të punojnë në qendrën shëndetësore Selishtë pasi nuk mund të kapin orarin e pas punës të kthehen pranë familjes. Ndodh jo rrallë që urgjencat për lindje e sëmundje tjera të dërgohen në spitalet e Peshkopisë apo Burrelit me mjete të rastit. Nuk po llogarisim vështirësitë e furnizimit apo mundësisë për të dalë në tregun e qytetit me shitur prodhimet blegtorale dhe fermerët nuk i mjelin delet e dhitë, por ua lënë qumështin qingjave e kecave. Zaten tani numërohen me gishta fermerët që po mbarështrojnë bagëti të imta, pasi shumë kanë hequr dorë, kur vendi është ideal për ti shtuar e siguruar të ardhura të mira. Para kolektivizimit vetëm zona e Selishtës ka arritur mbarështonte rreth 20.000 krerë të imta.

Disa familje kanë sakrifikuar për arsimimin e fëmijëve, shërbimin mjekësor e shërbime tjera duke marrë shtëpi me qera në periferi qendrave urbane Tiranë, Durrës etj. ku kanë kaluar e po kalojnë vështirësi për pagesën e qerasë dhe shpenzimeve tjera të domosdoshme për ushqimin, ilaçet, energjinë, ujin, transportin, tarifat e shkollimit etj. Disa nuk gjejnë punë e mjaft të tjerë (kryesisht gra e vajza) furnizojnë "ushtrinë e skllevërve modernë" të fasonerive me paga që mezi mbulojnë qiranë e shtëpisë.

Rruga e Selishtës - Foto Agim Totraku

Në programin që paraqiti qeveria "Rama 3" në kuvendi thuhet se një nga drejtimet do jetë "Rritja e mirëqenies së popullit " . Popujt zgjedhin qeveritë e shpenzojë për to pikërisht për tu rritur mirëqenien e sigurinë. Le të shohim, por mirëqenie pa prodhim nuk ka. Pikërisht mos braktisja e fshatrave dhe aktivizimi i burimeve ekonomike që zotërojnë ato i shërben shtimit të prodhimeve bujqësore, blektorale, perimeve, frutave etj. (shumë më cilësore të garantuara se ata të importuara).

Nuk dëshirojmë tē zgjatemi duke numëruar vlerat arkeologjike e historike (aq pak ose aspak të studiuara) të kësaj zone që ka gjenezë në lashtësi. Ekzistenca e gjurmëve të 4 kalave, 10 kishave, shpellave me gjurmë banimi është objekt i mirë studimi për arkeologë e historianë kompetentë, që për fat të keq nuk janë dukur këtyre anëve.

Nuk dëshirojmë të numërojmë as resurset në burime minerare, pyjet, burimet mujore, natyrën e liqenet e mrekullueshme, florën e faunën e pasur etj., që i kanë paraqitur me detaje autoritetet e komunës e në mënyrë të veçantë Agim Totraku, të cilin gjejmë rastin ta falënderojmë.

Braktisja e këtij segmenti të rrugës nacionale Peshkopi- Burrel po çon në braktisjen e fshatrave që e përdorin atë. Është gjendje e trishtueshme të shohësh gjithandej shtëpi e kulla të moçme 2- 3 katshe të rrënuara e të tjera në prag të shembjes, kur për ngritjen e tyre kanë bërë mund të madh disa breza dhe mbartnin ngjarje e histori interesante.

Do kisha dëshirë që drejtuesit e bashkive Dibër e Mat të vënë dorë në segmentin rrugor 45 km Muhurr-Lis me mundësitë e tyre buxhetore dhe kërkesën pranë qeverisë për fonde tani në fazën e hartimit të buxhetit për vitin 2022. Këtë kërkesë edhe për deputetët e Dibrës e Matit pa ngjyra partiake.

Le të shpresojmë!

Rruga e Arbërit nr. 181

Emisioni "Veting" në ABC News i kushton një reportazh special aksidenteve në minierën e Bulqizës, duke sjellë intervista të dhimbshme me dëshmi e faktë rreth jetës së minatorëve dhe sakrificave të tyre e familje të tyre.

Ndiq reportazhin e plotë në:
https://abcnews.al/bulqiza-si-enderr-e-keqe/

Bulqiza, si ëndërr e keqe

Heshtja ka kapluar Bulqizën duke bërë që edhe ky vit t'ua ngjajë atyre paraardhës. Vështrimin drejt saj, pronarët e pasur e kthejnë veçse për kromin, "gurin e zi me xixa", që u shton peshën "xhepave" të tyre. Ndërsa politikanët, indiferencën prej dekadash e thyejnë me një heshtje simbolike, ndaj tragjedisë së radhës, madje edhe atë janë gati ta mohojnë në emër të proçedurave parlamentare.

Në 23 qershor, ata pas një ngurrimi aspak human, mbajtën një minutë heshtje për të ndjerin Muharrem Plaku. Minatorin 61-vjeçar që u shua këtë mes shtatori në galeritë e Bulqizës, ndërsa i ishte rikthyer punës në miniera për të shlyer një kredi. E gjithë skena e nderimit një minutësh, të kujton nderimin e munguar ligjërisht të deputetëve gjatë këtyre tri dekadave, ndaj Plakut e kolegëve të tij. Statusi i mohuar është plaga e shumë bulqizakëve që kanë humbur familjarin minator, e cila nuk mund të zëvendësohet me trajtimin financiar të ligjit 29/2019, që nuk është tjetër veçse arnim i ligjeve të vjetra. Siç tregojnë minatorët për "Vetting" çdo përpjekje për ta fituar këtë status si shumë profesione të tjera që kanë një shkallë vështirësie më të ulët, është shtypur që në lindje.

Pushimet nga puna, ka qenë përgjigjia e beftë e administratorve të minierave, ndaj çdo proteste, apo "internimi" i tyre i përkohshëm në miniera të largëta, siç ka ndodhur në rastin e ish minatorit Ferhat Kurti. Ndonëse aksidentet në miniera, ndodhin edhe për shkak të riskut të lartë të punës, heshtja ndaj masave të ulëta të sigurisë në punë, bën që numrat e të lënduarve në minierat e Bulqizës të shtohen edhe më tepër në raportet e Inspektoriatit të Punës si dhe Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në miniera. Besimin tek drejtësia e kanë humbur. Siç rrëfejnë gjatë dekadave vite në punë, nuk kanë hasur asnjë rast ku subjekti minerar, pronari apo administratorët të jenë ndëshkuar me ndonjë masë serioze. Krahas dëmtimeve apo vdekjes, në rastet fatale, miniatorëve viktima u është lënë edhe faji i aksidenteve.

Dënimi ligjor, siç ata rrëfejnë, prek vetëm hallkat e brishta, siç janë brigadierët, përgjegjës të turnit. Por, siç shtojnë më tej, e vërteta e disa prej ngjarjeve tragjike për të cilat është folur në Bulqizë, ka mbetur e pazbardhur, për shkak të fshehjes apo manipulimit që i është bërë. E megjithatë, minatorët, të lënë në mëshirë të fatit, e dëshmimtar të këtyre ndodhive, nuk duhet ta ndërpresin punën në miniera. Vëmendja tek ata, kthehet vetëm në tragjedinë e radhës. Nën presionin e volumit punës që rritet, e pagës që mbetet e ulët, nuk mund të bëjnë tjetër veçse të heshtin. Kush mundet, kryesisht të rinjtë po i drejtohen dita-ditës emigrimit. Lulzim Alla, është një nga minatorët e rinj, të brezit të tretë, gjithashtu anëtar i Sindikatës së bashkuar të Minatorëve të Bulqizës, që tregon se si Bulqiza po shuhet dita-ditës e minatorët nuk mund të bëzajnë për shkak të presionit, ku kërcënohen me bukën e përditshme.

Ai thotë se qeveritarët janë bërë njësh me pronarët dhe minatorët janë braktisur tërësisht. Privimi nga paga deri në një vit, është një tjetër fakt tronditës për të cilin minatorët bulqizakë që po e vuajnë nuk mund të flasin, në rastin më të mirë, prej frikës së papunësisë që është ulur këmbëkryq në qytet. Një faktor që bëhet nxitës shtesë i emigracionit, e Zyrat e Punës, me kërkesat e punonjësve të kualifikuar mund të bëjnë pak. Keqmenaxhimin e paunifikuar të subjekteve minerare të Bulqizës, e rrëfen për "Vetting" edhe ish-drejtuesi i saj, Martin Cukalla. Inxhinieri vë theksin tek domosdoshmëria për të hapur burime të reja, si dhe tek shpërfillja që po u bëhet specialistëve. Këto ngërçe, sipas tij duhen zgjidhur nga shteti, që pasojat fatale tek minatorët, të mos shtohen.

Minierat e Bulqizës, nuk fshehin vetëm kromin e minerale të tjera, por edhe sekrete të errëta të tragjedive, që duhen zbardhur e parandaluar. Në këtë dokumentar, minatorët rrëfejnë çka ndodh brenda galerive dhe kërkojnë që të kenë një status, siguri për jetën, të drejtën për të folur pa u pushuar e kërcënuar. Kërkojnë t'u rikthehet dinjiteti, ndërsa ushtrojnë zanatin më të vështirë në botë. Kërkojnë gjumin e munguar të nënave, që portretet e bijëve minatorë, i shohin netëve përmes ëndrrave të këqija, ndërsa u përshpërisnin prej nën tokës : "Ah, moj nënë, kush i qan hallet tona!"

"FAVORIZOHEN PRONARËT", FLET MINATORI PËR VDEKJET NË BULQIZË: KOLEGËT HESHTIN SE I MBAJNË NËN PRESION

Flaka e qirinjve që shpërndahej zbehtë xeherorëve, në shpatet afër galerisë. Ishte protesta e heshtur e minatorëve të Bulqizës këtë fund shtatori. Në përkujtim të kolegëve që s'janë, minatorët që shembin shkëmbinj në kurriz të maleve, nuk mund të rebelohen, as të rrëzojnë nga karriget zyrtarët e kollarisur, por mundohen të fshehin lotët në terrin e natës. Kostoja e lartë e varfërisë dhe e papunësisë, i detyron të japin në heshtje lamtumirën minatorit Muharrem Plaku, viktimës të 677-të që ndahet nga jeta gjatë punës në minierë.

Një masiv i madh kromi u shemb e u bë mur për t'ia ndalur përgjithmonë dritën, e rrugën e kthimit. Muharrem Plaku qëndroi pesë ditë në fundin e galerisë, në thellësinë 450 metra. Orët e vona të datës 20 shtator, u gjet i pajetë trupi i tij në fundin e galerisë. Në moshë pensioni, tuneleve të galerisë, e kishte rikthyer nevoja për të shlyer një kredi. Ishte një nga minatorët më të zotë të Bulqizës. Siç thonë kolegët e tij, ai mësonte më të rinjtë e kujdesej për kolegët. E megjithatë, sipas Autoritetit për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, vdekja i erdhi pikërisht për shkak të pakujdesisë së tij, pasi "ka hyrë në një hapësirë të vjetër të zonës së shfrytëzimit". Përsëri faji i mbetet viktimës apo përgjegjësit të turnit…

Edhe pse rrallëkush në këtë vend e njeh si ata peshën e padrejtësisë, që e thellon tragjedinë njësoj si masivët shkëmbor që u vërsulen në befasi, ata kanë frikë të flasin. Në një ditë të zakonshme pune, kur disa syresh janë duke lënë turnin e dytë, gazetarët e "Vetting" përpiqen të bisedojnë me minatorët e Bulqizës për të kuptuar nevojat, por edhe vështirësitë e punës në minierë.

Nga radha e gjatë e burrave të Bulqizës, ku djemtë e rritur para kohe ecin me kokën mënjanë e qesen e bukës në duar, pranon të flasë vetëm Lulzim Alla. Ai është nga brezi i tretë i minatorëve dhe po ashtu është anëtar i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës…

Kanë frikë se i kanë mbajt nën presion. Nuk duan të shfaqen… kanë frikë… Unë kam frikë atje brenda në galeri, nuk kam frikë jashtë galerisë, -thotë Alla për kolegët që refuzojnë të flasin.

Janë mesatarisht 7 minatorë në vit, që nuk arrijnë të kthehen të gjallë në pragun e shtëpisë. Ndërsa numri i të aksidentuar shumëfishohet. Vetëm në vitin 2019 sipas të dhënave të Inspektoriatit të Punës u shkaktuan 27 aksidente, nga të cilat 7 me pasojë vdekjen. E ndonëse në pandemi, e me punën e kufizuar, edhe gjatë vitit 2020, 5 minatorë humbën jetën, nga 28 aksidente të ndodhura. Pesha e fajit nuk bie mbi drejtuesit e administratorët e minierave, po godet sërishmi në hallkën më të brishtë.

Nuk mund t'i mbetet përherë faji viktimës… se askush nuk hyn atje që të vritet… as unë nuk dua të vritem, asnjë mintator nuk do të vritet. Ato janë aksidente që ndodhin dhe nuk ka pse ta marrë fajin viktima. Le të bëhet transparente ashtu siç ka ndodhur ngjarja, nëse e ka viktima le ta thonë, por ka shumë momente që nuk ndodh për shkak të viktimës dhe s'ka pse t'i mbetet faji viktimës gjithmonë", – shprehet minatori.

E pavarësisht tronditjes, punonjësve të nëntokës, në shkëmbinjtë që shokët gjymtohen e lënë jetën u duhet të vijojnë të kërkojnë mineralet, kromin. Ndërsa, familjarët përjetojnë ditë e natë humbjen e njerëzve të dashur, e jetojnë me makthin se një tjetër tragjedi do të sos.

Heshtja e bulqizakëve nuk është e rastësishme, ajo është e imponuar nga indiferenca 30-vjeçare e institucioneve shtetërore. Halli i minatorëve nuk ka qenë dhe nuk është obligim i qeveritarëve.

"Qeveria favorizon pronarët. Qeveria me pronarët janë një, janë bashkë dhe nuk shohin hallin e minatorëve. Ne kemi kontribuar një jetë të tërë në minierë. Nuk jam vetëm unë, por jemi tre breza që kontribuojmë në minierë dhe janë lënë në harresë. Ja si shkojnë gratë për të mbledhë krom nëpër stogje… 25 lekë kilja bën…"

ËNDRRA KOBËZEZË E NËNËS, RRËFIMI I FERHAT KURTIT: KËRKOVA STATUSIN E MINATORIT, JA SI U NDËSHKOVA

"Shigjeta dhe fjala e thënë s'kthehen pas", këto fjalë i kumbojnë ende sot minatorit Ferhat Kurti, ndërsa shikon djemtë e ri, të zbresin në galerinë ku ai punoi. Ajo derë, atij iu mbyll, pasi mendoi për sigurinë e tij e të ardhmen e tyre, për Statusin e munguar të minatorëve.

"Jam ndëshku… pse jam ndëshku?! Se në vitin 2017 u bë një protestë të miniera e Bulqizës dhe una dola pak më shumë se shokët dhe kërkova pse nuk na jepet Statusi i Minatorit… I thashë drejtuesit të Sindikatës, pse nuk kërkon t'i statusin e minatorit?! Dhe pas kësaj, unë jam pushuar nga puna… U ka shku, shpi për shpi minatorëve dhe i'u kanë thënë, nëse shkoni pas Ferhat Kurtit do pushoheni nga puna… Edhe nëpër zyra: Po shkuat pas Ferat Kurti do pushoheni nga puna… kështu është 100 për qind dhe s'kisha shpëtim…", tregon Kurti.

Zëri i punonjësve për mbrojtjen e të drejtave të tyre, mbytet nga frika e papunësisë apo edhe kërcënimet. Kush ka folur si Ferhat Kurti, Behamir Gjimi etj., ka vuajtur pasojat.

Kurti, minatori që punoi në galeritë e Bulqizës për 3 dekada, na mëson përmes historisë së tij se në ish "Qytetin-Burg" nga administratorët e minierave ndiqet ende mentaliteti i dënimeve. Kështu pas protestës së bujshme të tij në çadër në kryeqytet, atë e "e degdisën" për dy vjet në minierën e Trepçës, ku bënte rreth 30 minuta rrugë në këmbë, ndërsa ndiqte edhe trunin e natës. Tregon se në këtë periudhë është ndier si i persekutuar dhe totalisht i pambrojtur në vendin e tij. Por ,si ai, edhe minatorët e tjerë janë të vetëdijshëm, se nëse flasin i pret papunësia.

"Janë pushu shumë kolegë të mi kur ishin në protestën e vitit 2019… I kanë pushu padrejtësisht! Inspektoriati i Punës di vetëm të heshtë… di të favorizojë kompanitë… të marrë urdhëra nga shteti apo drejtues të ndryshëm… Pra, nuk mund të gjesh një zgjidhje te Inspektoriati i Punës…", tregon minatori Lulzim Alla.

Minatorët e Bulqizës shprehen se ndihen krejtësisht të pambrojtur nga organet e drejtësisë si dhe të tallur nga politikanët që i vizitojnë veçse për të sulmuar njëri-tjetrin a për tu bërë premtimet e radhës në kërkim të votës. Me zërin e mbytur të sindikatave, nuk u mbetet tjetër veçse hallet t'i qajnë mes njëri-tjetrit e familjarëve.

"A don ta diftoj një andërr që kam pa?! N'at andërr hyra brenda në minierë… ça me pa, tunelet zi ziii ziiii ziiii… M'u shfaq një djalë i ri, që varej teposhtë në fund të tunelit… U kthye e më tha: -Oj nanë, ça bën këtu… I thashë: Ka ardhë nana me ju pa … -Oh moj nanë, – më tha, nuk qahen hallet tona….", rrëfen Sulltane Jani, nëna e minatorit.

reportazh

FATBARDHA, NËNA E 5 FËMIJËVE PËRVESHI MËNGËT PËR 33 VITE NË KROM: THYENIM BLLOQET, ME DRIDHET LAKU I KËMBËS KUR E KUJTOJ

Me ankthin për jetën e bashkëshortëve në miniera, dhe shqetësimin për rritjen e fëmijëve, shumë prej grave të Bulqizës, kanë përveshur mëngët për të punuar edhe ato në këtë sektor të vështirë. Ndër to është edhe Fatbardhe Loshi, nëna e 5 fëmijëve, e cila për 33 vite me radhë ka seleksionuar kromin, duke përshkruar kilometra në këmbë, në mungesë të një autobusi që do t'u mundësonte transportin. Puna e seleksionomit të kromit nga gratë, është padyshim një nga zantet më të rënda, që siç rrëfen Fatbardha, ka lënë pasoja fizike te ajo dhe mjaft kolege të saj, deri në gjymtim e paralizë. Vetëm për vitin 2020, 3 gra u aksidentuan gjatë punës së seleksionimit të kromit, ndërsa me duar e këmbë në ujë u duhet të ndanin mineralin nga blloqet e rënda të gurit. Disa prej grave, siç tregojnë minatorët, jo rrallëherë kanë marrë me vete edhe fëmijët, për të grumbulluar më shumë krom. Pasi me 25 lekë që shitet kilogrami, mund të bëjnë shumë pak në betejën e përditshme ndaj mjerimit.

"Puna jonë e përditshme ishte shumë e vështirë me thënë të drejtën. Kam punu me tre turne... Jo vetëm unë, por edhe shoqet e mia. Është një punë jashtëzakonisht e vështirë... Edhe sot që kam dalë në pension, kur e pëmend sidomos turnin e tretë, me thënë të drejtën me dridhet laku i këmbës, se është një punë jashtëzakonisht e vështirë. Gjatë kohës së punës kishim edhe pastrim... Edhe gurët e blloqet që binin në tokë ishim të detyruara t'i thyenim vetë, jo të vinte dikush tjetër t'i thyente, por ishim të detyruara t'i thyenim vetë. Rufie Nurçja ka këput dorën në minierë... ajo sot nuk jeton më në Bulqizë jeton në Tiranë...", tregon ajo për "Vetting".

Në këto kushte të vështira, e veçanërisht të nxitura nga tragjeditë në galeri, gratë e minierave të Bulqizës janë përpjekur të rebelohen, por protestat e tyre për përmirësim të kushteve janë "mbytur" që në lindje.

"Kur isha në punë me thënë të drejtën jemi mundu me ba edhe greva, por ne na e kanë ndërpre grevën.. na e ndërprisnin, nuk na linin... Na thoshin se ju heqim nga puna... dhe ne frikësoheshim, stepeshim. Sepse s'kishim mundësi tjetër, s'kishim mbështetje..."

Fatbardhën, tanimë në moshën 62 vjeçare e shqetëson Bulqiza që po shuhet dita-ditës. Ekonomia në rënie, tragjeditë që pasojnë njëra tjetrën, siç tregon, e bëjnë këtë qytet të pashpresë e pa të ardhme për fëmijët e saj.

"Kur vriten në minierë më duket sikur i kam fëmijët e mi... se unë e di si është miniera, e di si punohet atje, dhe e di si merret leku... Po kjo është jeta...", thotë ajo.

"KA KOLEGË NË BULQIZË QË NUK PAGUHEN PREJ NJË VITI", MINATORI: KËTU NUK SHTYHET MË, S'NA MBETET VEÇ TË EMIGROJMË

"Të gjithë rrugët të çonin në Bulqizë dikur", tregon ish minatori Ferhat Kurti, teksa kujton kohën kur nga e gjithë Shqipëria vinin punëtorë për një pagë më të mirë. Ndërsa sot, ai shikon të rinjtë e qytetit që dita-ditës marrin rrugën e emigracionit. Kështu ndodhi dhe me tre djemtë e tij, siç rrëfen ai për "Vetting", pasi me të ardhurat e pakta të punës në miniera, ai nuk mundi t'u siguronte një të ardhme ndryshe. Puna në miniera atyre iu mohua për shkak të protestave të babait minator, por me shumë gjasa, në galeri, ata do t'i nënshtroheshin të njëjtit fat.

"Si punëtor i vjetër, 30 vjet përvojë, më thuaj t'i çfarë ndihme kam pasë?! Ky është punëtor, ka punuar gjithë vitin, rezultati ka qenë 200 për qind, ose 180 për qind, dhe këtij punëtori i takon të shkojë në plazh përshembull.... A kam shku ndonjë herë? Shpërblim, kam marrë ndonjëherë? Asnjëherë! Shpërblim të paktën...", tregon Kurti.

Emigrimi në qarkun e Dibrës ku bën pjesë dhe Bulqiza është thelluar ndjeshëm vitet e fundit, si një përpjekje për t'i shpëtuar mjerimit. Vetëm në vitin 2020, ndonëse në situatë pandemike me kufijtë e mbyllur, u larguan sipas INSTAT 2,6 për qind e popullsisë. Siç tregojnë banorët e Bulqizës, në vend po ndihet një valë gjithëpërfshirëse, ku të rinjtë e shikojnë shpëtimin jashtë vendit, e prindërit detyrohen të pajtohen me dhimbjen e të pasurit fëmijët larg, përballë alternativës kobzezë të humbjes së tyre në miniera.

Minatori Lulzim Alla, thotë se qeveritarët me "nëpërkëmbjen" që po u bëjnë të drejtave të minatorëve, po "i dëbojnë" nga vendlindja. Dhjetëra kolegë e të afërm të tij, tanimë kanë emigruar, dhe ai, prej pasigurisë e vështirësive ekonomike ka vendosur të lërë qytetin

"Ma merr mendja që nuk shtyhet më shumë... Besoj se dhe unë do të lëvizë... kanë lëvizë shumë veta..."

Çdo aktivitet në Bulqizë, burimin e të ardhurave e ka në miniera, thotë Alla. Dhe me vështirësitë ekonomike në këtë sektor, papunësia ka dhënë efektet e saj duke nxitur edhe më tepër emigracionin. Kështu, ndonëse popullsia është në rënie, shifrat e papunësisë në tokën e arit rriten çdo ditë. Vetëm për vitin 2020, nga Zyrat e Punës u regjistruan 1150 banorë të Bulqizës si të papunë. Me problemin e nivelit të ulët të arsimimit ku më pak se 10 për qind gëzojnë arsim të lartë, u punësuan vetëm 32 për qind të tyre. Ndërsa 114 punëkëruesve iu ofrua pagesë papunësie, 668 të tjerë nuk gjetën zgjidhje në këtë strukturë.

Në këto rrethana të rinjtë që ende s'kanë mundur të lënë qytetin, u drejtohen minierave.

Ndërsa vënë çdo ditë jetën në rrezik u duhet të përballen dhe me vonesat e pagave. Gjatë gushtit në dyert e "Albchrome" gjejmë disa punonjës të minierave të tjera të Bulqizës që përpiqen të transferohen.

"Sektori privat i ka mbytë te pjesa e pagës, se nuk i ka pagu pagën... Kanë gjashtë muaj e mbi një vit që s'kanë marrë pagat... vijnë këtu tek ne, se këtu realisht pagat janë dhënë", rrëfen Alla.

Mes pasigurisë për një vend pune rrëfejnë jashtë kameras se po mbushin vitin pa u paguar dhe gjenden në një labirint pa krye për të siguruar nevojat bazike. Qeveria, si mburojë ndaj këtyre padrejtësive, mund të kishte pranuar kërkesat e vazhdueshme për t'u njohur statusin e minatorit. Por, pavarësisht premtimeve, minatorët janë braktisur në fatin e diktuar nga pronarët e administratorët e minierave.

"GURI MË KËPUTI KËMBËN", MINATORI: PUNOVA ME PROTEZË PËR 20 MIJË LEKË, MA ZBRITËN PENSIONIN PAS 40 VITESH PUNË

Ka etje për drejtësi në Bulqizë. Drejtësia kërkohet më së shumti nga familjarët e minatorëve që nuk janë më, por edhe nga invalidët e gjymtuar në miniera, që i takon në çdo rrugicë. Ndër ta është edhe Haxhi Loshi që ndonëse ka humbur njërën këmbë gjatë punës në sistemin komunist, është detyruar të punojë në miniera për katër dekada, për një pagë prej 20 mijë lekësh. Teksa e rrëfen ngjarjen për "Vetting" kapërdin lotët, e zëri i mbytet në rrëfimin e trishtë.

"Më ra guri nga lart, më bllokoi dhe më këputi m'u në mes të kockës këmbën... Mbeti këmba aty... Pasi preva këmbën ndenja në shtëpi dy vjet...shkova bleva një protezë për këmbën në Tiranë dhe u ktheva në punë me të drejtë rroge".

Për Loshin, të riniste punën në sipërfaqe

të minierave ishte padyshim një stërmundim mbinjerëzor i imponuar prej varfërisë. Po aq i imponuar edhe prej qeverive, që në mungesë të një trajtimi financiar të mjaftueshëm si invalid, e detyruan të rikthehej me një këmbë të prerë në minierë.

"Ishte shumë e vështirë, se me këmbë me protezë ngjitu lart e poshtë, me turne..", rrëfen ish minatori.

Ndërsa minatorët shpresonin se me kalimin e viteve politikat do të viheshin në shërbim të sigurisë e jetës së tyre, tregojnw se politikanët u pozicionuan nw krahw tw pronarëve. Bashkëshortja e Haxhiut, Fatbardhe, kujton se si në vitet 2000, pikërisht prej statusit të invalidit bashkëshortin e saj e lanë papunë.

"E kanë lënë pa punë totalisht dhe punoi nëpër privat se halli e nxorri me punu privatisht.. Kamën e ka lënë në minierë krejt. Me një këmbë ka shku në Greqi dhe ka punu... Ka shku në Greqi, rrugës nëpër male...", tregon Fatbardha e përlotur.

Të dy bashkëshortët, ish minatorë, janë tanimë në moshë pensioni, por mungesa e statusit dhe indiferenca e qeverisë, i lë të braktisur edhe në këtë periudhë të brishtë të jetës së tyre. Qeveria i braktisi punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë dhe ata të metalurgjisë në 2017-ën kur i përjashtuan nga ligji 8/2017 "Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit". Ligj që nuk gjeti asnjëherë zbatim deri sa u zëvendësua nga ligji 29/2019, në të cilën fasada për t'u dhënë një dorë minatorëve u "bojatis" me rrengjet e ligjeve të vjetra. Shtojca për pensionin e pleqërisë dhe të invaliditetit, përfshin një shtesë prej 1 përqind për çdo vit pune të siguruar, kur punonjësi ka të paktën 6 vjet në miniera. Nga miniatorët e Bulqizës prej nëntorit të vitit 2019 e deri në 11 gusht të vitit 2021 kanë përfituar vetëm 798 minatorë, ndërsa në qarkun e Dibrës 1581.

"Kur dola në pension, dorëzova letrat në Peshkopi dhe ma nxorën pensionin 270 mijë lekë. Pas rreth tetë muajsh ma zbritën... Më vunë një million lekë gjobë... se t'i kemi dhënë gabim, thanë... Unë paguaj akoma atë gjobë, sipas atyre të Peshkopisë", tregon Loshi.

Por çfarë përfitojnë konkretisht minatorët përmes fondit suplementar të vënë në dispozicion që ka edhe 8 vite "jetë"? Në rastin më të mirë nëse një punonjës ka punuar në miniera për 30 vjet, pensioni i pleqërisë rritet me 3600 lekë. Shumë kjo me të cilën minatorët nuk mund të sigurojnë as ilaçet, apo të mbulojnë taksat mujore. Minatorët me të cilët biseduam tregojnë se ndonëse kanë më shumë se 30 vjet punë pensioni i tyre nuk i kapërcen 24 mijë lekë .

"Mua më doli pensioni shumë i vogël, sepse më thanë se duhet të kisha 37 vjet punë. Unë nuk i kisha 37 vjet punë, kisha 33 vjet e katër muaj... pensioni më doli 214 mijë lekë dhe ato nuk më dalin as për ilaçe, se jam sëmurë", rrëfen ish minatorja.

AKSIDENTET NË PUNË, NËNA E MINATORIT: "IM BIR KA VUAJT SI KRISHTI, ASKUSH S'TA SHEH HALLIN"

Kur të rinjtë hyjnë në galeritë e minierave të Bulqizës, mësojnë fillimisht se gjithçka ndodh në nën tokë, mbetet aty. Mësojnë të pajtohen me "kodin e heshtjes" që i rri si mantel çdo aksidenti a vdekje. Dita e parë e punës për secilin prej tyre, është vetëm fillimi i rezistencës ndaj errësirës, e vdekjes. Zanatin e mësojnë nxitimthi pasi siç tregon ish minatori Ferhat Kurti, tani pronarët e administratorët e subjekteve private mendojnë se si ta shfrytëzojnë punëtorin, që në ditët e tij të para në nëntokë, deri në "skllavërim". Me më shumë se tri dekada punë në minierë, ai kujton se përballja e tij me nëntokën nuk ishte e lehtë. Mirëpo, e gjithë pesha e familjes i kish rënë mbi supe e nuk mund të dilte prej aty, pa fituar bukën e përditshme.

"Kur hyra për herë të parë në minierë, nuk e dija ku po shkoja... komplet botë tjetër. U futa poshtë dhe nuk dija si të dilja nga ashensori, nuk mund ta kuptoja. Futeshe në një anë dhe nuk e dija si të shkoja në anën tjetër. Ecja, nuk e dija ku... më kapi një shok për dore dhe më tregoi rrugën"- tregon ish minatori.

Pavarësisht puseve që ka hapur, e kromit që ka grumbulluar, për pronarët e subjekteve minerare, situata financiare e Ferhat Kurtit nuk ka ndryshuar prej ditës së parë kur nisi punën. Jeton në pallat punëtorësh, dhe në bankë numëron veçse kreditë që i janë dashur për të përballuar operacionet që i është nënshtruar si pasojë e punës në minierë e rritjen e fëmijëve. Dy infarkte të kaluara në brendësi të galerive e gishtat e prera të njëjtës dorë, janë vetëm shenjat e dukshme fizike, që tregojnë jetën e vështirë të tij. Më mirë se kushdo vuajtjet e tij, i njeh e ëma, që e ka përcjellë çdo ditë skutave të minierave. Për 3 dekada me radhë, nënë Sulltanja, si shumica e grave të Bulqizës, me dhimbjen që u kaplon shpirtin, është përshëndetur me djalin e saj, duke lënë një lamtumirë pezull deri në kthim.

"Një djalë që kam minator... ka vujt si Krishti, si Krishti kur them, ka vujt si krishti... Shkonte pa bukë gjithnjë, se s'kisha ça t'i jepja me vete... Vetëm vinte, hante drekë a darkë... qeveria nuk të sheh hiç a ke hall a si e ke hallin.. a të sheh? Hiç nuk të sheh... A duam llafe të bukura ne në televizor, apo duam të hamë... si thua? Se sa nëna qajnë, se sa fëmijë mbeten jetimë... e halli nuk i qahet askujt", tregon ajo.

Pavarësisht varfërisë, me vdekjen që përgjon minatorët në galeri, nënë Sulltanja ndihet me fat që të birin e ka gjallë. Janë 50 minatorë që vetëm në 7 vitet e fundit kanë dhënë në miniera frymën e fundit. Ndërsa më shumë se 257 kolegë të Kurtit, kanë në trup plagë e gjymtime të parikuperueshme të shkaktuara gjatë aksidenteve në punë.

Dritëhijet pas asaj çka ndodh në thellësi të nëntokës, amortizimi, aksidentet e vdekjet "të sistemuara" zyrave me gjoba modeste, bëjnë që minatorët, të heshtin e të frikësohen. Çdo fjalë e thënë prej tyre mund t'u heq bukën e gojës, apo akoma më keq të lihen të pambrojtur ndaj kërcënimeve "të të fortëve" që zotërojnë arin e nëntokës... Këto janë vetëm disa nga arsyet pse aksidentet apo vdekjet në miniera, edhe mund të fshihen, apo të manipulohet e vërteta .

"... në një sektor ku ndodh aksidenti...këta e bllokojnë. I vendosin një kryq që kur të vijë ISHM-i, se ata kontrollojnë minierat, dhe i çojnë në turn të dytë dhe të tretë që nuk ka kontroll..."-tregon minatori.

Harta e zezë e aksidenteve dhe vdekjeve të punonjësve gjatë një viti, për shkak të minierave e karrierave prek kulmin në qarkun e Dibrës. Viti 2018 ka shënuar një nga periudhat më tragjike, me 42 të aksidentuar e 8 të vdekur në minierat e këtij qyteti. Por, masat që janë marrë janë thuajse të papërfillshme. 20 paralajmërime, 3 pezullime dhe 7 gjoba me vlerë 840 mijë lekë, as që nuk ndihen në xhepat e kamur të pronarëve të minierave ku punonjësit kanë lënë jetën. E nga ana tjetër, vetë minatorët, që kanë dekada punë mbi supe tregojnë se nuk kanë hasur asnjë rast ku për humbjet e jetëve të jetë ndëshkuar me masa serioze subjekti apo administratorët.

(abcnews.al/bulqiza-si-enderr-e-keqe)

Pse po shpopullohet Dibra?

Zvogëlohet Dibra, të rinjtë ikin në emigracion

Pse Dibra është një ndër rajonet më të varfëra dhe më të shpopulluara në vend dhe si mund të frenohet një dukuri e tillë?
Flasin përfaqësues të shoqërisë civile: Gafurr Muka - profesor në Universitetin e Tiranës, Kamber Farruku - publicist, Xhemal Gazidede - avokat,
Nafie Jella - kryetare e Forumit të Pavarur të Gruas në Bulqizë, Bajram Krrashi - ish-kryebashkiaku i Dibrës dhe Danjel Bica - Kryetar i Shoqatës "Ekspertët e Rinj Mjedisor"

Gafurr Muka, Pro. Asoc. Dok. në Universitetin e Tiranës:

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Pas rrëzimit të regjimit komunist, nisi edhe rënia e pandalshme e popullsisë në vendin tonë, e cila vazhdon prej 3 dekadash, për shkak të emigracionit, por jo vetëm. Një tjetër shkak që ka ndikuar në rënien demografike, ka qenë dhe mbetet edhe ulja e lindshmërisë, që sipas INSTAT-it, ka rënie me 65% që nga 1990. Po sipas INSTAT -it, sot vendit tonë i mungojnë rreth 1 milion e 112 mijë banorë, ose afro 38.8% e popullsisë aktuale.

Në vitet 70-80 Shqipëria kishte rritjen më të lartë të popullsisë në Europë, me 2% në vit, aktualisht rritja është negative me -0.35%. Popullsia e Shqipërisë është tkurrur me 15% që prej vitit 1989, kur kishte afro 3 milion e 300 mijë banorë. Komponentët që ndikojnë në rritjen ose rënien e popullsisë janë lindjet, vdekjet, dhe emigracioni. Në rastin e Shqipërisë emigracioni është faktori kryesor i tkurrjes.

Sipas INSTST emigrimi i të rinjve, rënia e lindshmërisë si dhe vdekshmëria më e ulët që nga viti 1989, kanë zvogëluar peshën e brezave të rinj dhe kanë rritur atë të brezave më të vjetër në popullsinë e përgjithshme, duke çuar drejt një moshimi demografik, me kosto me të larta financiare. Pa u marrë shumë me shifrat, që dihen tashmë, se vijojnë të mbeten shqetësuese, përsa i përket dukurisë së shpopullimit dhe plakjes së vendit tonë, në përgjithësi dhe rajonit të Dibrës në veçanti, doja që nëpërmjet këtij shkrimi, të bëja një analizë të thjeshtë:

"Pse Qarku i Dibrës është nga më të prekurit nga kjo dukuri?"

Natyrshëm që shpopullimi i një rajoni, ecën paralelisht me varfërinë e tij në resurse ekonomiko-financiare, emigracionin, lindje-vdekjet, të cilat veprojnë në korrelacion mes tyre.

Qarku i Dibrës, ku bëjnë pjesë bashkitë Mat, Klos, Bulqizë dhe Dibër, sipas INSTAT, vijon të mbetet një nga rajonet më të prekura nga plakja dhe ulja drastike e popullsisë. Shpopullimi i këtij qarku, bëri që në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit të këtij viti, të ulet edhe numri i deputetëve përfaqësues të tij, në Kuvendin e Shqipërisë, nga 6 që ishte në zgjedhjet e kaluara, në 5 të tillë. Për të parë dhe analizuar trendin e rrudhosjes dhe plakjes së popullsisë, së këtij qarku, le tu hedhim një pamje shifrave të statistikave demografike, për dy vitet e fundit, 2019-2020.

Sipas Institutit Kombëtar të Statistikave, në vitin 2019, popullsia në rang qarku ka qenë gjithsej 118 948 banorë, nga të cilët 61 946 meshkuj dhe 57 002 femra. Kurse në vitin 2020, popullsia ka pësuar rënie, duke regjistruar gjithsej 115 857 banorë, nga të cilët 60 455 meshkuj dhe 55 402 femra. Kështu, rritja vjetore e popullsisë së këtij qarku, që është regjistruar në 2020, rezulton të jetë negative minus (-2.6%). Pra shihet se trendi i uljes së popullsisë, vijon nga viti në vit. Sipas statistikave të marra nga 4 bashkitë e këtij qarku, për lindje-vdekjet, në dy vitet e fundit 2019-2020, mësohet se në uljen e popullsisë, veç emigrimit të të rinjve, ndikuan dukshëm edhe ulja e lindshmërisë së grave. Në vitin 2019, nga të gjitha njësitë administrative të bashkisë Bulqizë, janë konfirmuar gjithsej 50 akte lindjeje dhe 203 akte vdekje, duke prevaluar kështu çuditërisht vdekjet ndaj lindshmërisë, madje me rezultat të thellë. Ndërsa për vitin 2020 janë regjistruar 109 akte lindje dhe 284 akte vdekje.

Në bashkinë Klos, për vitin 2019, janë regjistruar gjithsej 155 lindje dhe 133 vdekje. Në vitin 2020, janë regjistruar 141 lindje dhe 136 vdekje.

Në bashkinë Mat, për vitin 2019 janë regjistruar gjithsej 121 lindje dhe 62 vdekje. Në vitin 2020 janë regjistruar 122 lindje dhe 105 vdekje.

Në bashkinë Dibër, në vitin 2019 janë regjistruar gjithsej 801 akt- lindje dhe 82 akt-vdekje. Kurse në vitin 2020 janë regjistruar 686 akt-lindje dhe 97 akt-vdekje. Edhe nga këto statistika, të lindje-vdekjeve, shihet me shqetësim, se raporti i diferencës mes tyre, mbetet i vogël, përsa i përket ndikimit në rritjen natyrale të popullsisë. Sipas INSTAT, popullsia në qarkun e Dibrës, më 1 janar 2020, u rrit përkatësisht me minus (-2.6%). Ndërkohë që në rang vendi rritja ka qenë (-0.6%).

Ndërkohë, ndikim negativ në këtë shpopullim, krahas emigracionit, që mban peshën kryesore, ndikon dukshëm edhe rënia e lindshmërisë së grave. Një prej shqetësimeve kryesore të ekspertëve lidhet me lindjet, të cilat kanë rënë me 65% që prej vitit 1990 kur kishte 82 mijë lindje në vit. Numri i fëmijëve për një grua në moshë riprodhuese është 1.37 dhe që prej 19 vitesh është nën nivelin 2.1 që është kufiri i nevojshëm për të ruajtur popullsinë.

Masat e qeverisë për stimulimin e lindjeve përmes bonusit të bebeve, konsiderohen nga ekspertët si e pamjaftueshme. Shqipëria ndodhet nën mesataren e nivelit të lindjeve, prej 1.55% të Bashkimit Evropian.

Dukuria tjetër shqetësuese lidhet me shtesën natyrore të popullsisë ose ndryshe raporti mes lindjeve dhe vdekjeve që ka rënë me 89% krahasuar më vitin 1990 kur popullsia rritej me 64 mijë persona në vit. Por edhe pse Shqipëria ka shtesë natyrore pozitive të popullsisë, kjo shtesë nuk dominon mbi emigracionin, ndaj dhe rritja e popullsisë, vijon të mbetet negative.

Emigracioni, kryesisht i të rinjëve të moshës 20-35 vjeç, në kërkim të një jete më të mirë, jasht vendit, dhe ulja e lindshmërisë së grave, janë dhe mbeten ndër shkaktarët kryesor, por jo vetëm, që e rendisin Dibrën në rajonin më të prekur nga shpopullimi dhe plakja. Emigracioni në ekstrem, siç ka ndodhur në këtë rajon, natyrisht që stimulohet nga varfëria, ku rajoni i Dibrës, në veri-lindje të vendit, renditet nga më të varfërit. Sipas ekspertëve të ekonomisë, një rajon i caktuar, përfshihet nga varfëria, kur atij i mungojnë resurset natyrore, për zhvillimet ekonomike. Në këtë rast natyrshëm lind një pyetje e dytë: "A i mungojnë rajonit të Dibrës, resurset natyrore, për zhvillimin ekonomik?"

Dhe pa mëdyshje përgjigja do të ishte jo, përkundrazi, Qarku i Dibrës është i pasur me burime natyrore, siç janë: Minierat e kromit në zonën krommbajtëse Tërnovë-Bulqizë-Batër Martanesh, dy fabrika të pasurimit të mineralit të kromit, në Burrel dhe Bulqizë, madje edhe fabrikë mermeri. Ka lugina pjellore agro-bujqësore si ajo e Drinit të Zi, dhe Matit, për zhvillimin intensive

Ekspertët numërojnë një sërë shkaqesh, por kryesore mbetet mungesa e investimeve strategjike në ekonomi, qeverisje lokale dhe qëndrore pa vizionin e zhvillimit të rajonit, infrastruktura e dobët, investimet periferike, mbyllja e tregjeve etj.

të bujqësisë. Në retrospektivë, kujtojmë se para viteve '90-të, nga Sina e Epërme e deri në Qanok, numëroheshin mbi 500 mijë rrënjë mollë, ku mollët e Dibrës ishin nga më të kërkuarat në tregun e vendit tonë. Kishte fabrika që prodhonin reçel, mollë, dardhë, qershi e kumbull, si dhe pije alkoolike si raki 'Penestia', një markë Dibre asokohe mjaft e e preferuar dhe kërkuar në vendin tonë. Prodhon energji elektrike, ka pyje e kullota pafund, resurse turistike, si 'bjeshkët e Korabit, Lura turistike me 7 liqenet, Liqeni i Zi, Ulza turistike, kalaja Petëralbës, Raduçi, në Klenjë, ujra termale llixhat e Peshkopisë, etj, etj. Atëherë, përderi sa nuk mungojnë resurset natyrore ekonomike "përse Dibra e varfër, që të rinjtë të rendin eksremisht drejt emigracionit pandalur?!

Sipas INSTAT, rajoni i Dibrës ka rënie në zhvillimin ekonomiko-financiar, ku në 2020 kjo rënie është 2.8% krahasuar me vitin 2009, gjë e cila të çon të mendosh me të drejtë se politikat lokale të zhvillimit ekonomik, në mos kanë munguar, kanë qenë në nivele jo të mjaftueshme zhvillimi për këtë rajon. Atëherë një pamundësi e tillë për zhvillimin ekonomiko-social, të këtij rajoni, natyrshëm që ka stimuluar emigracionin në ekstrem, jasht vendit të të rinjve për një jetë më të mirë.

Përse rajoni i Dibrës është nga më të varfrit, dhe për pasojë më të shpopulluarit në vendin tonë dhe si mund të frenohet një dukuri e tillë? Këto janë pyetje mjaft shqetësuese, që kanë të bëjnë me të ardhmen e këtij rajoni, mbeten dhe duan përgjigje. Në përpjekje për të marrë një përgjigje, sa më gjithëpërfshirëse dhe të gjithëpranueshme, kemi intervistuar për të marrë opinione nga persona të njohur publik të fushave e profesioneve të ndryshme.

MUKA: Gjithsesi unë mendoj se këto masa, lidhen me politikat qeveritare: Të investimeve në infrastrukturë ("Rrugës së Arbërit" duhet t'i përkrahëzohen rrugët rurale, të cilat veçanërisht në Dibër, janë lënë krejt mbas dore). Të mbështetjes të investimeve të të larguarve, pasi këto rritin jo vetëm numrin e të punësuarve, por edhe shpërblimin më të mirë të tyre.

Egjej si domosdoshmëri, angazhimi, për të shkruar mbi temën e shpopullimit, në rastin konkret atij të Dibrës. Do përmend disa ndër shkaqet specifike që kanë kontribuar që Dibra të jetë rajoni më i prekur nga shpopullimi.

1.-Dibranët janë njerëz punëtorë të vetëdijshëm se me punën e tyre, ia dalin të krijojnë një ekzistencë më të mirë, atje ku jetohet më mirë. Përderisa puna në vendlindje nuk shpërblehet mirë, dibranët zgjedhin rrugën e largimit.

2.- Dibranët e mbështesin njëri-tjetrin, aty ku janë vendosur dibranët, rrallë gjen familje të veçuara, atje gjen lagje dibranësh. Kjo traditë e inkurajon largimin.

3.- Dbranët janë prindër të mirë. Shumë kanë ikur për t'iu siguruar fëmijëve një të ardhme më të mirë.

4.- Dibranët janë fëmijë të mbarë. Të larguarit nga Dibra, sidomos ata që janë mbi 18 vjeç nuk ua kanë kthyer shpinën prindërve, përkundrazi ata i kanë përdorur paratë e kursyera për të përmirësuar jetesën e tyre: duke ndërtuar shtëpi të reja; duke blerë mjete transporti ; duke blerë bagëti apo pajisje bujqësore etj. Pikërisht, këto përmirësime të jetesës së familjarëve, sipas parimit "sheh rrushi-rrushin dhe piqet", i kanë nxitur të rinjtë e tjerë të ndjekin shembullin e të ikurve, për një jetë më të mirë të familjarëve të tyre.

5.- Po si fëmijë të mbarë, kur kanë siguruar një ekzistencë më të mirë, atje ku kanë shkuar dhe duke parë që megjithëse më investimet e tyre, jeta e familjarëve nuk bëhej ashtu siç mund t'ua siguronin ata, kryesisht për shkak të politikave të mbrapshta, i kanë marrë me vete, duke kontribuar në rritjen e shpopullimit.

6.- Dibranët i krijojnë familjet duke u martuar me " vajza vendi". Ndjekja e kësaj tradite ka sjellë si pasojë largimin e femrave dibrane. Edhe këto, si fëmijë të mbarë e si motra të dashura, kanë krijuar kushte që të largojnë nga Dibra familjarët e tyre (prindër, motra. vëllezër, kushërinj etj).

Sa i përket pyetjes së dytë, për masat që duhen marrë për frenimin e kësaj dukurie, e kam të vështirë t'i shpëtoj përsëritjes përkatësisht skematizimit. Gjithsesi unë mendoj se këto masa, lidhen me politikat qeveritare: 1.-Të investimeve në infrastrukturë ("Rrugës së Arbërit" duhet t'i përkrahëzohen rrugët rurale, të cilat veçanërisht në Dibër, janë lënë krejt mbas dore). 2.- Të mbështetjes të investimeve të të larguarve, pasi këto rritin jo vetëm numrin e të punësuarve, por edhe shpërblimin më të mirë të tyre. Ka plot raste që të larguarit duan të kthehen dhe të investojnë në vendlindje, por klima për efiçensën e këtyre investimeve është e pa përshtatshme. Edhe një dështim i vetëm në këto sipërmarrje, sjell hezitimin e shumë të tjerëve për t'u kthyer. 3.- Të mbështetjes së investitorëve të huaj. Jo se është në modë të thuhet, por unë mendoj se Dibra ka vërtet resurse, për t'i tërhequr investitorët e huaj. Por ajo që i mungon Dibrës është më së pari infrastruktura e transportit. Ndërtimi, përmirësimi dhe plotësimi i kësaj, do të çonte tek krijimi dhe funksionimi i rrjetit të tregtisë dhe ofrimit të shërbimeve të tjera që janë të domosdoshme për investimet e huaja. 4.- Të mbështetjes së arsimit 9 vjeçar nëpërmjet krijimit të shkollave me konvikte, ku të sigurohet numri i nxënësve, pajimet e duhura

mësimore dhe të punësohen mësues cilësorë. Kjo është vendimtare si në frenimin e shpopullimit, sidomos të familjeve të reja, ashtu edhe në rritjen e kthimeve të atyre që duan të ringrenë ekzistencën e tyre në vendlindje. 5. Duke qenë se Dibra është vend edhe bujqësor edhe blegtoral, qeveria duhet të hartojë politika "on line" për mbështetjen dhe zhvillimin e tyre.

Kamber Farruku, gazetar, publicist:

Mendoj se zhvillimi ekonomik në Dibër, ka disa anë, që duhen analizuar. Blegtoria është një sektor, i cili befason me prapambetjen e saj. Nuk ka tufa të mëdha të imtash, nuk ka ferma lopësh e viçash. Edhe zona tradicionale si Kalaja e Dodës me delen rudë, nuk kanë tufa të mëdha bagëtishë. Po kështu edhe i gjithë pellgu i Drinit, me pyje e zona malore në anën perëndimore, nuk ka tufa të imtash. Ka një familje në Dardhë, nga fshati Merskane, familja Poleshi, me disa qindra dele e dhi. Kaq. Shkaku kryesor, për një mungesë të tillë të tufave me të imta, apo gjedhe, është se të rinjtë, nuk shkojnë me bagëti. E quajnë zanatin e bariut, gati si një ofendim, një punë për njerëz të rëndomtë, që nuk marrin vesh nga bota. Takova fermerin Poleshi, ja ç'farë më tha ai:

- "Kam ndërtuar jetë shumë të mirë, me bagëtitë, kam ngritur stalla në bjeshkë, kam dy fuoristrada, kam të ardhura. Por vetëm njëri djalë më ndjek në këtë punë, tjetri më ikën me DJ nëpër dasma nga Kalisi. Jam gati ta lë këtë punë". Edhe zona si Selishta nuk po mbajnë më bagëti të imta si dikur. Mbajnë sa për të jetuar, për konsum vetjak. Kjo ndodh në një kohë kur kërkesat për mish vendi bio, janë të mëdha. E njëjta dukuri edhe për bagëtitë e trasha. Në gjithë ultësirën e Drinit, nga Katundi i Ri deri në Fushë-Alie, nuk gjen një fermë lopësh. Pse? Sepse brezi i ri nuk pëlqen të merret me ta. I duket një punë pa leverdi dhe e pa përshtatshme. Për bujqësinë ka disa lëvizje në pemtari në zonat e Melanit, Maqellarës, apo fshatrat rreth Peshkopisë. Po kështu edhe në prodhim djathi, por fare pak. Po kështu ka filluar të vlerësohet bletaria.

Infrastruktura rrugore në shumë zona, ndikon për keq në zhvillimin ekonomik. Sidomos në anën perëndimore të Drinit. Por rritja e tufave me qindra e mijëra të imta, nuk është tek rrugët, por te mungesa e interesit të njerëzve. Bujqësia e blegtoria duan mund dhe durim, aftësi për sigurim tregjesh, pasion. Kjo mungon. Edhe zona që i kanë arteriet rrugore afër, siç është ta zëmë Zerqani, nuk janë përqendruar tek blegtoria. Emigracioni është shkak thelbësor për prapambetjen. Mes mijëra të rinjve të ikur, do kishte prej atyre që do t'i hynin punës në bujqësi, blegtori, përpunim etj, për të siguruar jetesën. Mirëpo i'u pëlqen emigracioni, sepse atje lodhesh më pak e fiton më shumë. Çdo gjë tjetër si rrugët, hekurudhat, parqet e lulishtet, ndërtesat me gazifikim apo kushte të mira, spitalet e shkollat, atje i kanë gati. Brezat e shteteve të zhvilluara, kanë lënë kockat dikur prej shekujsh, për vendin e tyre dhe i riu shqiptar e gjen gati. Në vendin e tij i duhet një jetë e më tepër, të arrijë atje dhe zgjedh largimin nga vendi i vet. Të rinjtë shqiptarë janë shumë të zot të bëjnë vend edhe në shtetet më të zhvilluara. Kjo është fazë kalimi në Shqipëri. Edhe në shtetet e tjera ka një largim të madh nga fshati drejt qendrave urbane. Në Italì ka ligje për punimin e tokës, megjithë atë nëpër fshatra ajo po mbetet djerr dhe kthehet në livadhe. Shumë familje sigurojnë disa të ardhura nga toka dhe delet e lopa dhe mbahen me paratë e fituara në Greqi dhe Europë, etj. Kjo sepse atje të jepet paraja në dorë, kurse në Dibër do punosh gjithë vitin dhe do të shesësh prodhimin. Shqipëria është një treg i vogël dhe pa industri ushqimore. Mendoj se Rruga e Arbërit do të sjellë një farë zhvillimi, sepse Tirana mbetet një treg i madh dhe konkurrues në cilësi. Në Tiranë pëlqehen sidomos prodhimet bujqësore të Korçës. Këtë duhet të arrijë edhe Dibra. Një marrëveshje e qeverisë me vendet arabe, siç thuhet për eksportin e të leshtave, që ata i marrin për festat fetare, do ftonte një bum zhvillimi të tufave të deleve. Maqedonia këtë e ka fituar që në kohë të Titos. Dibra është shumë e vobekët në rrafshin turistik. Nuk kanë nevojë, nuk kanë pasion, nuk kanë interes, -kjo nuk merret vesh. Këtu kemi një mungesë të theksuar të ndërtimit të rrugëve në akset turistike si, Korabi, Lura, Liqeni i Zi etj. Nuk është ecur me një studim, ku dhe mungojnë kërkesat dhe investimet private. Edhe aty kur dikush shkon pranë një gurre e një pylli, ndërton kasolle dhe ndot vendin, më mirë të mos kishte shkuar fare. Kështu ka ndodhur te Gurrat në Çidhën, me ca baraka turistike të shëmtuara, me hedhje plehrash anë e kënd. Politikat shtetërore janë vendimtare vetëm kur ata kryhen me një presion komunitar. Duhet presion dhe profesionalizëm i njerëzve, që ta nxisin qeverinë të bëjë investime. Nëqoftëse vetë lurianët e shkatërruan pyllin mijëravjeçarë dhe nuk e mbrojnë as sot e gjithë ditën, çfarë tu bësh atyre!? Po të ishte ruajtur Parku i Lurës, i mbrojtur edhe me ligj, unë jam i bindur se rruga nga Rrësheni në Kurbnesh e në Lurë, do të ishte bërë dhjetë vite më parë dhe sot Lura do të lulëzonte nga turizmi. Sepse nuk mund të ndërtosh fushë futbolli dhe aty të mos ketë kush të luajë!

Mendoj se dibranët bëjnë shumë pak për propagandimin e pasurive natyrore për të nxitur turizmin. Pak bëhet edhe për propagandimin e shembujve të mirë në bujqësi, pemëtari, përpunim, vreshtari apo bletari për të nxitur të tjerët. Gjithsesi, Dibrën duhet ta bëjnë dibranët, ashtu si tropojanët në grykën e Valbonës, apo korçarët në fushat e Korçës.

Biznesmenët edhe me subvencione nga shteti, me lehtësime fiskale, duhen ftuar në Dibër. Këtë e bën një pushtet vendor vizionar dhe atdhetar. Po qe se nuk e bëjnë, ata nuk janë dibranë të mirë. Dibra ka edhe pasuri të tjera, mbi të gjitha Minierën e Bulqizës. Kam përshtypjen se biznesmenët e këtij pellgu të madh mineral-mbajtës dhe pasurie, fitimet i transferojnë jashtë Dibrës. Mbase këta biznesmenë duhen detyruar me ligj që një pjesë të pasurisë së tyre, t'i investojnë në Dibër, kryesisht në sektorin turistik.

Xhemal Gazidede, avokat

Dibra është zona më e prekur në vend nga shpopullimi, pasi në Dibër me gjithë resurset natyrore, si pasuritë minerare nëntokësore, nuk është paraparë asnjë strategji për zhvillimin e saj ekonomiko-social. Madje Dibrës do t'i shërbejë pak Rruga e Arbërit që po ndërtohet (dhe kjo e lënë në harresë, këto kohët e fundit). Rajoni i Dibrës ka shumë burime natyrore të tjera përveçse blegtorisë e pemëtarisë, të cilat ishin të zhvilluara para viteve '90-të, si industria e lehtë dhe ushqimore, por edhe shfrytëzimi i mineraleve të tjera përveç kromit si, bakri, mermeri, gipsi etj. Shpopullimit në Dibër do t'i kontribuojë edhe më shumë projekti për ndërtimin e Hecit të Skavicës

Masat për frenimin e shpopullimit janë ata që thashë më lart, një strategji e mirmenduar ekonomiko-sociale, duke shfrytëzuar studimet e bëra ndër vite, që janë në Arkivin e Dibrës.

Bajram Krrashi, ish-kryebashkiaku i Dibrës

Shpopullimi i Dibrës është alarmant! Ndër shkaqet kryesore është humbja e besimit në zhvillimin e politikave mbështetëse rurale dhe urbane. Me humb pasurinë humbet diçka, me humb besimin, humbet gjithçka. Mungesa e infrastrukturës rrugore, ku akoma ka qendra administrative të njësive vendore, të bashkive, që lidhen me rrugë të pa asfaltuara. Mungesa e infrastrukturës arsimore, ku shkolla, kopshte, çerdhe, thuajse të abandonuara. Mungesa e qendrave shëndetësore, qenja formale e tyre, mungesa e zhvillimit të bizneseve, në fushën e përpunimit agro-ushqimorë, për të rritur sigurinë e besimit të përpunimit për fermerin, ose mungesa e qendrave të grumbullimit, standardizojnë certifikimin e tregtimit, të prodhimit bujqësor e blegtoral etj. Dibranët janë shumë të lidhur me vendbanimin e tyre, por përballja me këto kushte, duke shtuar mungesën e punësimit permanent, mos tregtimin e prodhimeve bujqësore blegtorale jua shton varfërinë dhe rrugëzgjidhja shihet me largimet për banim në qendrat e zhvilluara si Tirana, Durrësi, apo zona të tjera, shto edhe emigracionin. Largimet në emigracion, krijimi i punësimit e rritja e të ardhurave në familje, hapja e bizneseve të tyre, jua këput besimin e rikthimit. Dibra është vend i zhvillimit bujqësor e blegtoral, por politikat e zhvillimit të bujqësisë, nuk kanë qenë mbështetëse, në përputhje me ligjet e zhvillimit të ekonomisë së tregut për bujqësinë. Pa përqendrim-specializim-kooperim, pa ndarje shoqërore të punës, duke zhvilluar prodhimin e madh bujqësor e blegtoral, ndarje e prodhimit me marketingun e tregtimin, përqendrimi i grumbullimit e tregtimit të prodhimeve bujqësore, nuk zhvillohet rajoni i Dibrës me kaçile, karroca, apo tezga vend e pa vend. Investimet në këto politika, në zhvillimin dhe organizimin e tyre, me teknologji moderne, rrit besimin tek brezat e dibranëve, për të mos u larguar. Në Dibër kostoja e jetesës, është më e madhe se në Tiranë, Durrës, apo më tej. Shpenzohet më shumë për ngrohje (kalori e energji), rrugëtim, arsimim, shëndetësi, pra ka një kosto jetese më të madhe, se në zona të tjera si ata të Shqipërisë së Mesme dhe Jugut. Vetëm se rrimë, jetojmë e punojmë, në këto zona urbane e rurale, duhet që ata të mbështeten financiarisht me politika konkrete, e jo "çikrima" si subvencione lëmoshe, që kalojnë ditën e vitin, por jo të ardhmen e zhvillimin e qëndrueshëm e të vazhdueshëm ekonomiko-social.

Ndërkohë, memdoj se zhvillimi i bujqësisë e blegtorisë, në frutikulturë, qendra përpunimi agro-ushqimore, rritja e agroturizmit, si dhe turizmit malor, zhvillimi e tregtimi i bimëve medicinale e aromatike, shfrytëzimi i burimeve minerale, mbështetja e biznesit, rritin punësimin dhe të ardhurat, për frenimin e largimeve.

Politikat e studiuara, projektet e mëdha, sjellin realizime të mëdha dhe përmbysje konceptesh e veprimesh, që rritin besimin, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomiko-social dhe popullimin dhe jo shpopullimin.

FARRUKU: Mendoj se dibranët bëjnë shumë pak për propagandimin e pasurive natyrore për të nxitur turizmin. Gjithsesi, Dibrën duhet ta bëjnë dibranët, ashtu si tropojanët në grykën e Valbonës apo korçarët në fushat e Korçës.

KRRASHI: Politikat e studiuara, projektet e mëdha, sjellin realizime të mëdha dhe përmbysje konceptesh e veprimesh, që rritin besimin, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomiko-social dhe popullimin dhe jo shpopullimin.

Nafie Jella kryetare e Forumit të Pavarur të Gruas në Bulqizë.

Ndër faktorët kryesorë të shpopullimit, natyrisht që mbetet emigrimi i të rinjve mbi 20 vjeç, të cilët për shkak të papunësisë, rendin jashtë vendit për një jetë më të mirë, pasi rajoni i Dibrës, ka mbetur ndër më të varfërit edhe pse resurset për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nuk i mungojnë. Një tjetër shkak, për shpopullimin e Dibrës, po kaq i rëndësishëm sa emigrimi, mendoj se është edhe lindshmëria e ulët e grave, në moshën e pjellorisë, për shtimin natyral të popullsisë. Një nga masat e qeverisë për stimulimin e lindjeve, përmes bonusit të bebeve, është e mirë në këtë drejtim, por jo e mjaftë për zgjidhjen e këtij problemi. Në këtë drejtim organizata jonë e gruas, është përpjekur, duke u fokusuar tek bisedat me gratë dhe vajzat, për emancipimin e ndërgjegjësimin e mëtejshëm të tyre në: kërkesat që ata duhet të kenë për barazinë dhe kushtet e punës, si dhe në familje.

Danjel Bica, Kryetar i Shoqatës Ekspertët e Rinj Mjedisor

Emigracioni, sidomos i të rinjve mbi 20 vjeç, lidhet ndër të tjera edhe me keqqeverisjen e pushtetit vendor, i cili nuk ka mundur prej 3 dekadash të ofrojë shërbime në infrastrukturë, hapjen e vendeve të reja të punës, mbështetjen e talenteve të reja, krijimin dhe mbështetja e bizneseve të reja, me iniciativa nga të rinj.

Dibra rezulton ndër rajonet më të prekura nga emigrimi, pasi nuk shfrytëzohen pasuritë natyrore, në dobi të komunitetit dhe punësimit të të rinjve. E vetmja mundësi punësimi, ka mbetur shteti, ku punësohen persona me bindje partiake, por që janë të pamjaftueshme si vende pune, për të mbajtur të rinjtë në vend.

Mungesa e hartimit të politikave e projekteve afatgjata, për zhvillimin e ekonomisë, kanë çuar në varfërinë dhe për pasojë shpopullimin e rajonit. Një tjetër faktor negativ në këtë drejtim, mbeten edhe pagat nga më të ultat në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë, me të cilën në mos e pamundur, tejet e vështirë për të mbajtur familjen. Gjë kjo që ka detyruar të rinjtë të largohen në kërkim të një jete më të mirë.

Rruga e Arbërit nr. 181

vendlindje

Allajbegia, lagjja ime

Nga **OSMAN XHILI**

Nuk ka njeri që të mos tërheqë zvarrë kujtimet e fëmijërisë. Ato janë lidhur e thurur keq në subkoshiencën e secilit, pa mundur ti shqisësh, sado të përpiqesh. Ato ecin me ty, flenë me ty, pushojnë me ty, ecin sërish me ty e vdesin bashkë me ty. Dikush më shumë e dikush më pak, të gjithë kanë nostalgji për vendlindjen, qoftë ajo fushë pjellore, qoftë ajo dhe një majë mali, ku është e vështirë mbijetesa, ku vetëm zogj e kafshë të egra mund të ketë dhe vetëm rrallë e tek ndonjë shtëpi. Dhe unë nuk munda ti shpëtoj kësaj dalldie, për të kapur fillin e kujtimeve të fëmijërisë e për ta shpleksur atë ngadalë e me kujdes.

Ajo është me të vërtetë një lagje që nuk meriton ta lesh në harresë. Nëse sheh Murat begu e ndërtoi xhaminë e Allajbegisë para 500 vjetësh, rezidenca e tij është pikërisht në këtë lagje, aty mes banesave të Besim dhe Qemal Xhilit. Tashmë dihet se ai ka qenë një sundimtar i fuqishëm, jo vetëm i fshatit, por dhe në zonë, madje me ndikim dhe në Dibër të Madhe. Nuk është habi ai të ketë ndërtuar një tubacion për të sjellë qumështin nga mali, ku ka pasur bagëtinë, deri te kulla e tij. Nëse dikush e ve në dyshim këtë gjë, le të shohë çimkat (tubacionet), që kanë mbijetuar deri në ditët tona, duke përvijuar qartë drejtimin e tij. Një nga banorët e fshatit, Blerim Sala, djali i Zabitit, duke bërë disa gërmime te shtëpia e tij, pranë rrugës së lagjes së Çifligut, ka hasur në këtë tubacion dhe ka nxjerrë disa tuba (çimka), që i kemi paraqitur dhe në fotot e librit. U takon studiuesve të ndjekin këtë linjë të hershme, të shohin ekstremet e këtij tubacioni dhe të dalin të dhëna të tjera, akoma më interesante.

E etiketuar si "lagjja e beglerëve", që nga shtëpia e Izet Tonuzit, deri te shtëpia e haxhi Rushitit, babai i Medat dhe Gafur Salës, ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në tërësinë e menaxhimit të këtij fshati. Në muajin e Ramazanit, hoxha i fshatit shkonte çdo natë në iftar në ndonjë familje dhe lagjja jonë e mbante më të shumtën e ditëve. Ne të vegjlit, ndiheshim krenarë, por dhe me detyrimet që buronin nga kjo, për tu bërë fëmijë të mbarë, të edukuar dhe të shkolluar mirë. Aty para shtëpive tona gjendet një shesh i vogël, mbushur plot me kujtimet tona fëminore. Natyrisht që loja e futbollit ishte më e preferuara për ne. Shpesh luanim tre me tre, por kishte raste dhe pesë me pesë, apo dy skuadra me nga gjashtë veta. E kuptonim që ishim shumë për atë lloj fushe, por donim të luanim të gjithë. Mund të ishte pluhur, mund të ishte pak baltë, por ndonjëherë dhe dëborë, e të gjitha këto nuk kishin rëndësi për ne. Kur gjuanim lart, topi binte shpesh te kopshti i Gëzimit, aty pas avllisë. Kur nuk kishte njerëz brenda, shkonte Gëzimi dhe e merrte. Kur ishte Xha Ismali në shtëpi, puna ishte më serioze. E merrte topin dhe nuk na e jepte më, të paktën për atë ditë. Topi atëherë

ishte një luks i madh dhe ne me veshë të varur e të pikëlluar në kulm, ktheheshim në shtëpi ose fillonim ndonjë lojë tjetër.

Nganjëherë luanim pas shtëpisë time, te shkolla. Luanim e luanim, derisa binte mbrëmja e vinin prindërit duke na thirrur. Shqyenim këpucët e dëmtonim këmbët, që të nesërmen ishin me shenja mavi nga enjtja. Kishte raste që prindërit na qortonin, pasi nuk i kishim ndihmuar për ndonjë punë, por dhe detyrat nuk i kishim bërë për të nesërmen. Premtonim që nuk do të luanim më, por ditën tjetër e njëjta skemë përsëritej.

Dimri i atyre viteve ishte sa i vështirë, aq dhe i bukur e interesant. Kur binte bora e qëndronte me javë të tëra, kur stalagtitet e akullit vareshin nga çatitë e shtëpive, ne fëmijët dilnim për të rrëshqitur, një lloj skijimi amatoresk. Merrnim ndonjë shkop ku mbaheshim gjatë rrëshqitjes e shpesh rrëzoheshim e ngriheshim sërish. Dikush kishte sajuar një kaik për të rrëshqitur, që nuk ishte gjë tjetër, vetëm se disa dërrasa të shkurtëra të farkuara mbi dy copa druri, duke e bërë më komode rrëshqitjen tonë. Në darkë shkonim në shtëpi me rrobat krejt të lagura e mezi gjenim të tjera për të shkuar nesër për në shkollë.

Por futbolli ishte vetëm një nga lojërat e shumta. Jo rrallë luanim një lojë që quhej dokër. Në qendër ishte një gropë dhe gjithçka vërtitej rreth asaj , a thua ishte qendra e botës. Ca gropa më të vogla ishin anash saj, ku vinin këmbët lojtarët, të gjithë të pajisur me nga një shkop në dorë. Shkopi shërbente për të qëlluar një copë koçan misri, që e thërrisnim brolle. Lojtari që kishte shërbimin tentonte ta fusë brollen në gropë, ndërsa të tjerët tentonin ta largonin atë, duke e gjuajtur me shkopinj.

Lojra të tjera ishin dhe shkop e kliskë, apo një lojë tjetër me toka, ku ne përfaqësoheshim me emra shtetesh si Shqipëria, Greqia, Italia apo dhe shtete të tjera. Secili synonte ta zgjerojë pjesën e tij të tokës dhe ne në përfytyrimin tonë fëminor na dukej sikur krijonim e ndërtonim perandori të vërteta. Disa perandori binin, të tjera lindnin e zhvilloheshin dhe ne i përjetonim ata shumë seriozisht.

Shumë interesante ishte dhe loja me arra. Vizatonim një trekëndësh në tokë dhe aty vendosnim dy, tre, katër, apo më shumë arra, sipas numrit të personave, që merrnin pjesë në lojë. Caktonim një vizë tre katër metra larg trekëndëshit dhe secili me nga një kokërr are në dore, i hidhnim me synimin kush e kush të afrohej më pranë trekëndëshit. Ai fatlum që ishte më pranë, kishte të drejtën të qëllojë mbi grumbullin e arave, për ti fituar ato. Kur dy persona kishin distancë të njëjtë nga trekëndëshi, veç syrit matja bëhej dhe me pëllëmbë e me gishtërinj. Na pëlqente shumë kjo lojë dhe shpesh, lojtari që humbiste arat, shkonte diku, gjente shtatë kokrra të tjera dhe fillonte lojën sërish. Unë kisha shumë trupa të mëdhenj arrash, aq sa babai i dërgonte të qëruara në Tiranë, ku nxirrte një fitim jo të vogël. Ama kënaqësia ishte kur fitonim arrat aty te trekëndëshi, duke luajtur gjithë ditën.

Çdo grup fëmijësh ishte përcaktuar qartë në moshë. Gëzimi, Luani, Agimi, Shkëlqimi e Jetoni ishin gati moshatarë. Më pas vinim unë, Allamani, Alltani, Burimi, Aqifi dhe akoma më pas, më të vegjël se ne. Gjithë ditën sheshi i vogël qëndronte plot, aq sa mund të luanim me turne, ose vepronte ligji i xhunglës, pra luanim më të mëdhenjtë. Ndonjëherë dilnim për të ngrënë ndonjë mollë, kumbull, dardhë, apo qershi. Si ngopeshim mirë, mbushnim dhe xhepat, apo i fusnim mes barkut e këmishës, që kishim veshur, për ti pasur si rezervë ditore.

Krahas lojërave të ndryshme, përgatisnim dhe mësimet për të nesërmen. Në shkollë ishim fëmijë të urtë, të edukuar dhe pse jo dhe inteligjentë.

Ja, kështu u rritëm ne fëmijët e lagjes time, u poqëm e u burrëruam. Në sheshin e



lagjes filluan të luajnë fëmijët tanë. Po erdhi një ditë që ky zinxhir moshash u këput. Nuk ka më fëmijë për të luajtur. Njerëzit po ikin nëpër Europë, apo akoma më larg për një jetë më të mirë. Shtëpitë e lagjes që dikur gjallonin e zhurmonin nga fëmijët e shumtë, tani janë boshatisur e disa janë shembur. Shtëpia e Gëzimit është shembur fare, pasi ka ndërtuar një të re mbi lagjen e Çiflikut. Shtëpia e Bajram Ademit është bosh dhe vetëm verës Bajrami, bashkë me të shoqen, Festën, vijnë për pak kohë në trojet e vjetra. Shtëpia e Qemal Xhilit është shembur, pasi janë ngritur në Tiranë. Bosh janë dhe shtëpitë e Isuf Salës, Bardh Ademit, Kamber Osmanit, apo e Ismet Ademit, që rrallë vjen verës për të pushuar, në rezidencën e tij, siç dëshiron ta quaj regjizor Aqifi.

Bosh, gjithandej bosh. Dhe në rrugë fare pak kalimtarë ka. Vetëm çifte gati të moshuar, që flasin në darkë me fëmijët e shpërndarë në Itali, Greqi, apo diku tjetër. Shkolla që rrudhen përditë për nga numri i nxënësve, që kthehen me klasa kolektive, apo rrezikojnë të mbyllen fare. Më duket si një ëndërr e keqe e nuk dua ta besoj. Lagjja ime, e bukura, fisnikja, e madhërishmja, më duket sikur është në kllapi e po jep shpirt. Po në mos tjetër, le të jenë këto rreshta të hedhur në një libër kujtimesh, një mënyrë të jetuari për lagjen e fëmijërisë time.

Por unë, Osmani, biri yt, të jap fjalën se nuk lëviz që këtu. Nuk më mahnit shkëlqimi i qyteteve të zhurmshëm e me pallate të lartë. Ti, lagjja ime je misi i parë dhe i pa konkutrueshëm nga asnjë vendbanim tjetër. Qetësia, freskia, ajri i pastër, bollëku në pemë e perime, uji e shumë të tjera, janë faktorë të mjaftë për të mos e menduar lëvizjen. Të dua dhe kështu lagjja ime e pazëvendësueshme. Dhe kështu të lodhur, me numër të paktë njerëzish e shtëpish, që jeton mes lavdisë së dikurshme e trishtimit të sotëm. Kujton ata kohra, kur pleqtë e motshëm dilnin tek kodra, nën hijen e dy lisave qindra vjeçarë. Kuvendonin e merrnin vendime, që i thirrnin me emrin "itifak". Por një ditë dhe lisat i prenë për të furnizuar furrën e bukës me dru zjarri, duke djegur bashkë me drutë dhe lavdinë e dikurshme. Por unë, biri yt, të premtoj se nuk të harroj kurrë, jo vetëm me fjalë, por me vepra. Dua të të bëj të bukur si një nuse, në mos tjetër soj, të paktën me këtë shkrim përkujtues, që do ngelet si vulë e lashtësisë dhe e krenarisë tënde.

Bosh, gjithandej bosh. Dhe në rrugë fare pak kalimtarë ka. Vetëm çifte gati të moshuar, që flasin në darkë me fëmijët e shpërndarë në Itali, Greqi, apo diku tjetër. Shkolla që rrudhen përditë për nga numri i nxënësve, që kthehen me klasa kolektive, apo rrezikojnë të mbyllen fare. Më duket si një ëndërr e keqe e nuk dua ta besoj. Lagjja ime, e bukura, fisnikja, e madhërishmja, më duket sikur është në kllapi e po jep shpirt...

turizëm

Ne mund të bëjmë diçka.Unë kudo që shkoj gjej mikpritje dhe kjo ishte mënyra ime për ta kthyer atë mbrapsht.

Pavel Kunc, aktivisti çek që po **mbjell Lurën**

Buzëqeshja, energjia dhe mirësjellja e karakterizojnë 39 vjeçarin Pavel Kunc, i cili po mëson dhe shqipen së fundmi.

Lëvizja që ai përfaqëson quhet Pemë për Lurën (Trees for Lurë) dhe synon të mbjelli 2 500 fidanë çdo vit. Ky është viti i tretë i mbjelljeve. Ne e takuam nga afër për të sjellë te ju eksperiencën e tij.

Si e takove Lurën?

Rreth 4 vite më parë, kur po kthehesha nga India me motor, kalova nga Lura. Rrugës në një krua aty pranë, pashë qese dhe mbeturina hedhur ngado. Mora një çantë me mbeturina dhe bëra një video në Youtube, e cila u bë tërësisht virale në Shqipëri. Unë nuk e dija këtë, por shoku im, i cili më bëri videon, Doriani, më thotë se isha kthyer në një 'yll'.

Kur u frymëzove për të ndërmarrë aksion?

Ishte një vit më vonë kur u ktheva sërish në Shqipëri. Ishim në Korab duke pirë disa birra me shokun tim, Dorianin, kur u hap tema e pemëve në Lurë. Pse ishin prerë? Pse nuk ishte më parku si dikur? Çfarë mund të bënim së bashku? Ndoshta ishin birrat, ndoshta lidhja që kisha krijuar me Lurën, por aty nga Korabi, lindi ideja për të mbjellë pemë çdo vit në Lurë.

Ne mund të bëjmë diçka.Unë kudo që shkoj gjej mikpritje dhe kjo ishte mënyra ime për ta kthyer atë mbrapsht. Ti zgjedh një vend si udhëtar dhe vendos të ndihmosh pikërisht aty. Këtu lindi ideja për të bërë një projekt të mirëfilltë, për të filluar një fushatë për mbjelljen e pemëve.

Pavel, a kishit eksperiencë të mëparshme në nisma të ngjashme mjedisore?

Jo. Unë kam studiuar shkenca kompjuterike, por si udhëtar i natyrës jam kthyer në një natyralist që e dashuron pa kushte çdo natyrë. Lidhja me natyrën, udhëtimet, duke parë shumë problem, të krijon ide të ndryshosh dhe të ndihmosh.

Pse zgjodhe pikërisht Lurën për të ndihmuar?

Parku i Lurës kishte më shumë nevojë. Vetëm një punonjës për të gjithë atë park është e pamundur ta mbrosh apo ta

mbjellësh. Ishte një mundësi për mua të lë një gjurmë të mirë në diçka që do të vazhdojë dhe pas meje.

Po në vendin tënd si është gjendja e pyjeve? A ka nevojë dhe aty për ndihmën tuaj?

Në vendin tim shteti financon miliona euro për mbrojtjen dhe mbjelljen e pyjeve, ka qindra organizata rinore dhe ambientaliste të angazhuara dhe të mbështetura nga shteti im. Këtu ka shumë më tepër nevojë. Parku është i madh, janë qindra hektarë për tu mbjellë. Mundësitë janë të pakta. Terreni është i vështirë. Saktësisht është vendi për të përveshur mëngët.

Si është plani juaj i mbjelljes?

Me komunitetin. Ne nuk kemi mbështetje financiare nga shteti shqiptar, po punojmë me mbështetjen e vetë shqiptarëve. Jemi duke kërkuar mbështetje në Durrës, Dibër, Lurë, Tiranë, por kërkojmë mbështetjen edhe të komunës dhe komunitetit, të çdo organizate mjedisore. Në fund të tetorit ne synojmë të mbjellim 2500 fidanë, në dy aksione. Të hapim gropat dhe të bëjmë gati tokën është hapi i parë. Ne kemi gjetur paratë për të paguar një pjesë të komunitetit në hapjen e gropave. Më tej shpresojmë të bashkohen dhe vullnetarë që të arrijmë objektivin tonë.

Pavel, cila është fjala jote për të rinjtë shqiptarë dhe ata që e duan vendin e tyre shumë?

Të jem i sinqertë, kjo është një pyetje shumë e vështirë. Problemi, mendoj, është se ata nuk po shohin siç duhet vlerën e një mjedisi të pastër, të një natyre të shëndetshme, të qëndrueshme. Ata e duan vendin dhe Lurën, por nuk shohin vlerë në mbrojtjen e tyre, por në paratë dhe përfitimin për ti shkatërruar. Ky është problemi më i madh.

https://www.facebook.com/298080000211903/posts/4784002124952979/

Një ditë çoban në Lurë

Akeni menduar të qëndroni disa netë në stan? Imagjino peizazhet më të rralla malore... Imagjino qindra kafshë që të zgjojnë në mëngjes me zhurmat e tyre të bukura. Imagjino një ditë si çoban në mal. Imagjino një krevat të ngrohtë në bjeshkë, pranë zjarrit, me miliona yje mbi kokë. Pa lukse, pa teknologji, në thjeshtësinë e një stani.

Kjo është aventura që na pret së bashku në bjeshkët e Lurës në datat 8-9-10 Tetor 2021. Skuadra më e bukur e udhërrëfyesve të Lurës, barinjtë dhe bareshat, do na tregojnë shtigje dhe peizazhe që askush veç tyre nuk i di. Bashkë me ta do jetojmë si ta për 2 ditë. Rrethuar nga delet, dhitë , lopët, do shëtisim kullotave dhe livadheve të natyrës më të bukur shqiptare.

Çobenjtë do na çojnë krojeve, shpellave, majave, monumenteve më të bukura të natyrës lurase.

3 Ditë Aventura në Lurë:

- Një ditë me barinjtë në bjeshkë.
- Dy net në stanet e ëndrrave.
- Sport shtigjeve dhe krojeve të Lurës me biçikleta.
- Vizitë në Shpellat e Lurës: shpella e Zotajve, shpella e Kishzave, shpella e Erës, shpella e Sorrës.
- Shëtitje me kanoa në Liqene.
- 3 ditë ushqim bio: djathë, gjalpë, salcë, qumësht, kos i freskët stani, patatja më e rrallë e maleve, perime bio. Frutat plot vlera të Lurës: mollët, rrushi, manaferrat. Mjalti i Lurës dhe raki thane e kumbulle, me kafe stani.

Të gjitha ofruar nga barinjtë dhe bareshat tona me dashuri. FALAS!

Muzika është po bio: Tingujt më të bukur të natyrës janë falas, melodia e fyellit të barinjve do jetë me ne. Në darkë në zjarrin e miliona yjeve, me këngët e bareshave në kitarë.

Qëllimi: Turizmi i staneve synon të mbrojë traditën e barinjve, e cila po rrezikon të zhduket. Eko turizmi në stane është një nga mënyrat për të mbajtur ekonomitë e vogla të staneve, për të sjellë energji të reja në një traditë shekullore.

Aktiviteti organizohet nga skuadra Ecovolis dhe barinjtë e Lurës.

Transporti vajtje – ardhje kushton 2.000 Lekë. Çdo gjë tjetër është falas.

Datat 8-9-10 Tetor, (nisja ora 07:00, para pallatit të Kongreseve).

Te Stani në Majë të Malit, 2 mbrëmje të paharrueshme.

Linku:https://www.facebook.com/events/s/te-stani-ne-maje-te-malit/832965677263140/

Rruga e Arbërit nr. 181

ekspozitë



Zaya - nga sytë e Nanës

Nga dr. **ERMIR HOXHA**

Në skenën e artit bashkëkohor nuk është e shpeshtë të takosh një artist që zgjedh për subjekt nënën e tij. Ndodh patjetër që çdonjëri prej tyre të ketë realizuar një vepër a skicë, por një projekt të mirëfilltë kuptimor, të shtrirë në kohë mbi të si të vetmin subjekt, është e vështirë të gjendet. Arsyet e kësaj moszgjedhjeje duket se kuptohen lehtë. Artistët bashkëkohorë (në pjesë të konsiderueshme), luhaten shpesh mes kërkimit të temës së angazhuar, zbërthimit të saj konceptual dhe materializimit të së tërës në mediumin e duhur. Pjesa tjetër pozicionohet si përkrahëse dhe kërkuese e një estetike personale mbi subjektin e zgjedhur. Ato variojnë nga më klasiket, me temë rurale a urbane, tek ato më ekzistencialet, ku figura e njeriut qendërzon si nevojë për të zbërthyer ngërçet apo kontrastet e kohës. Në realitetin vendas, ky grupim i dytë, tejet i madh në numër, u ndërtua në standardin më të mirë akademik të kohës, aq sa duket sikur shpesh ende e përkufizon atë.

Piktori Zaim Elezi (i njohur edhe me emrin e artit Zaya) është produkt pikërisht i këtij grupimi. Lexues i ethshëm, ai u ndërtua në institucionet artistike të kohës dhe, si i tillë, pasqyron gjithë rrugëtimin tipik të artit të saj. Ai nis prej realizmit të imponuar tematik, drejt kërkimit të një gjuhe stilistike personale frymëzuar nga modernizmat e fillimshekullit XX. Padyshim që kjo tendencë e dytë do të merrte formë më të plotë sidomos pas ndryshimit të sistemit, në fillimvitet '90, materializuar në ekspozita të shumta në grup a personale.

Ekspozita e tij e fundit "Nana", sendërtuar mbi një subjekt kaq intim e personal, propozohet si një shumatore e këtij kërkimi estetik, aq sa dhe si një ndalesë mbi vlerat e vërteta njerëzore provuar në vrullin e përditshmërisë.

SUBJEKTI

Subjekti është esenca e veprës së artit. Si të tillë Zaya për këtë ekspozitë zgjodhi nënën e vet. Marrë e rimarrë në kohë ajo është aty në dhjetëra poza. Ajo është në këmbë, ulur a shtrirë, në kopsht a duke qëndisur, gatuar a biseduar, e përkulur nga mosha apo zhytur në botën e vet. Si për t'u mostrazuar, ajo kundrohet teksa plaket, ndërsa rrudhat i shtohen dhe lëkura i bëhet e tejdukshme si letra. Ajo vendoset aty, në profil a gjysmë profil, si në formatin e Rilindjes së Hershme, kur personazhet kompozoheshin si subjekte për t'u vëzhguar. Për shumë aspekte ajo ngjan me pikturën e zhanrit propozuar nga Vermeer, kur subjektet e përditshmërisë fitojnë qendrën e kompozimit, vrojtuar apo thjesht vendosur pa mendje në po ato dhoma, poltrona apo oborrin e shtëpisë.

Në një pjesë tjetër ajo e kërkon vëmendjen. Rri e sheh artistin, e patrazuar me faqet e plota, si shenjtore tokësore apo me veshjen

tipike të nënave veriore. Kërkon aty vështrimin e tij, e dyzuar mes kureshtjes dhe merakut të përhershëm. Ndryshe nga stereotipat e njeriut socialist, të cilët gjithnjë kërkojnë vëmendje maksimale, ajo është subjekt i një prezence të përditshme, ndërtuar nga gjeste të vogla, por me një dashuri konstante. Këto interferenca historike, projektuar mbi një subjekt kaq delikat amësor, nuk janë gjë tjetër veçse një riprojektim i ndryshëm i të njëjtit subjekt të shtrirë gjatë në kohë.

Një vëzhgues i kujdesshëm artisti e kundron atë që në vitet e shkollës, kohë kur patjetër e pozicionon si subjekt për detyrat semestrale, e përgjatë viteve si lidhje ombelikale e ngjizur në krye të kohës. E projektuar në kohë, marrë e rimarrë, parë e riparë, gjithnjë ndryshe, por gjithnjë njësoj, ajo është aty si përkufizimi i dashurisë së pakushtëzuar, pavarësisht kohës, çastit apo largësisë.

STILI DHE ESTETIKA

Prej viteve '90, Zaya, ashtu si shumë kolegë të tij, nisën një aventurë të re vizive. Frymëzuar pa kushte nga modernizmat e një shekulli më parë, edhe pse jashtë kohe, kjo tendencë erdhi si një lloj "vetëshkatërrimi" a nevoje për të rithemeluar veten sa më larg metodës të imponuar të sistemit socialist.

E gjitha kjo manifestohet në krijimtarinë e tij në gjithë tematikat që prek. Shihet qartë aty vendosja e subjektit në hapësirë, drita e impresionistëve apo vibrimi kromatik herë ekspresionist e herë i abstraguar në limitet e të kuptueshmes. Në fakt, Nana herë është në plan të parë, fizikisht e vogël e intime, e herë të tjera monumentale, teksa gjestikulon përhumbur në një vorbull të ethshme kromatike. Si e tillë ajo ndërtohet e rindërtohet në dhjetëra formate stilistike, si një mozaik imazhesh, që në fund ndërtojnë jo vetëm një personazh të mirëfilltë, por një metamorfozë ndjesish fenomenologjike.

Një vizitor i rregullt i natyrës, riteve e personazheve, për Zayan portreti i Nanës është në një farë mënyre "stacioni" i një kërkimi ndryshe, ndërtuar si një rrugëtim viziv mes të shkuarës dhe të tashmes. Ai është një kërkim estetik i artistit, ekskluzivisht mbi këtë subjekt, projektuar mbi sipërfaqen piktorike. Në këtë optikë ai është sa qendror, aq dhe i rastësishëm, pasi shikuesi vështron bashkë me të dhe aventurën stilistike të artistit në telajo. Si të tilla ato janë një ftesë sa stilistike, aq dhe subjektive, kur vështrimi mbi objektin/subjekt, nis nga vështrimi mbi sipërfaqe për të kuptuar brendësinë. E thënë ndryshe, ajo nuk është vetëm një pasqyrë tjetër e metamorfozës stilistike, por dhe një ftesë për të zbërthyer psikologjinë dhe universin e marrëdhënieve njerëzore.

Mbi autorin

Autor i ekspozitës "Nana", Zaim Elezi (Zaya), artisti dibran i lindur në vitin 1958, studioi në Liceun Artistik të Tiranës (1974-1978) dhe në Institutin e Lartë të Arteve (1979-1983) për skenografi. Prej vitit 1984 ai është pjesëmarrës në dhjetëra ekspozita kolektive brenda e jashtë vendit, autor i katër ekspozitave personale, e fundit në Muzeun Historik Kombëtar (2020) dhe fitues i disa çmimeve kombëtare. Paralelisht ai ka ushtruar profesionin e skenografit dhe kostumografit për dhjetëra shfaqje teatrale e filma artistikë.

Gjithashtu, ai ka qenë i angazhuar ndër vite në disa pozicione administrative në sektorë të ndryshëm, mes arsimit e institucioneve vendore. Aktualisht veprat e tij janë pjesë e shumë koleksioneve private në Shqipëri, Angli, Francë, Zvicër, SHBA dhe Kanada.

Zaim Elezi *ka krijuar simfoninë e tij në pikturë*

Nga **DHIMITRI ÇIKA***

Ekam njohur Zaim Elezin ne shtatorin e vitit 1980.E njoh mirë krijimtarinë e tij, ndaj mendoj se meriton vëmendje. Pse?

Krijimtaria e tij është e madhe dhe shumë e pasur, peshon shumë. Aty mund të shohësh gjithçka për një artist, që nuk ndal së kërkuari të bukurën, duke gjetur artin, që gjithmonë është pranë nesh, por rri fshehur.

Zaimi ka krijuar simfoninë e tij në pikturë. Si në një orkestër, çdo vegël më vehte, tingëllon bukur, por së bashku akoma më bukur. Kjo është pasuria e tij, një pasuri plot kolor, skicime, vizatime, skenografi, kostume, kopertina, ide kompozicionale dhe kompozime të përfunduara. Gjithçka e krijuar e bën këtë artist të meritojë vëmendje, dashuri, respekt, në këtë rrugëtim kaq të gjatë e të lodhshëm, por të bukur. Një piktor i kompletuar dhe i merituar.

Te pikturat e Zaimit gjen jetën, fshatin, aromën, cicërimën, gurgullimën, kakarisjen, hingëllimën e çdo bukuri tjetër. Gjen edhe qytetin me interpretime të veçanta piktorike e shumë të bukura.

Portreti është një tjetër tregues i një niveli të lartë mjeshtëror e artistik në krijimtarinë e tij. Kjo krijimtari e bollshme dhe kaq e larmishme, me shumë portrete të pikturuara, e bën edhe më interesante. Kaq bukur e sjell Nana Ijen, siç e quan piktori nënën e tij, sa të ngelen në kujtesë të gjitha tablotë. Dëshmi e një kulture të ngritur në vite, me shumë dashuri, që spikat në të gjitha portetet e saj. E si nuk e ka pikturuar Zaimi nënën! E ka pikturuar me tërë forcën e shpirtit dhe njohjen e artit që ai mbart. Me një kolorit shumë të pasur, të gjetur mirë, raporte të guximshme, ku dominon e ftohta hera-herës, në portret, duar apo edhe diku tjetër. Plastika aq e ndjeshme kudo. Nana Ija, në piktura kaq të bukura të djalit të saj, pikturuar për të mos u harruar!

Një karakteristikë që duhet theksuar te ky piktor është se vizatimi në portretet e tij nuk vjen nëpërmjet linjës, nuk është i përcaktuar, siç ndodh në shumë piktorë. Zaimi vizaton nëpërmjet pikturimit, në një gërshetim të bukur. Është me interes të theksohet kjo veçanti. Kjo e bën më të kuptueshëm atë impresionizmin e bukur dhe tërësisht individual, duke e bërë Zaim Elezin piktorin që meriton vëmendje!

Mendoj që dhe artistë të tjerë, kolegë e miq të piktorit, mund dhe duhet të individualizojnë pikturën e tij në tërësi.

Mirënjohje dhe respekt artit të bukur dhe plot ngrohtësi të Zaim Elezit!

** piktor, ikonograf dhe restaurator*

Nga data 20 shtator në Galerinë FAB në Tiranë, piktori Zaim Elezi (Zaya) hapi ekspozitën e tij personale me piktura, titulluar "NANA"

Një **rrëfim** mbi historinë më të bukur **që ka përcjellë njerëzimi**

Tema e Amësisë ka prezantuar ndjenjën e dashurisë së thellë, lidhjen e pazgjidhshme dhe hyjnore që lidh nënën me fëmijën, duke mbetur një nga temat më të bukura dhe më tërheqëse në historinë e Artit.

Nga prof. SADIK SPAHIA*

Tema e Amësisë ka prezantuar ndjenjën e dashurisë së thellë, lidhjen e pazgjidhshme dhe hyjnore që lidh nënën me fëmijën, duke mbetur një nga temat më të bukura dhe më tërheqëse në historinë e Artit. Imazhi i gruas që krijon jeta është emblemë e vlerave të vërteta, të pastra dhe ndjenja e mbrojtjes ndaj krijesës së saj, na sugjerojnë lidhjen e dashurisë dhe të empatisë për të gjithë njerëzimin.

Zaim Elezi prezanton në ekspozitën "NANA" një grup punimesh, që fillojnë nga vitet '80-të e deri më sot, kohë që rrok dy sistemet, shumë ndryshime, por që në këtë ekspozitë ruan vetëm një dimension, dashurinë për nënën, të parë në 360 gradë.

Ajo çka dallojmë, së pari, që bën veçantinë e këtij autori në raport me temën, është se ai nuk ka reshtur së pikturuari nënën, duke mbetur në thellësi tema e jetës në krijimtarinë e tij.

I gjithë korpusi i këtyre veprave nuk është ekspozuar asnjëherë. Ai i ka pikturuar ato për kënaqësinë e tij. Sado narciziste të duket kjo, e parë në kontekstin e kohës ku shtrihen shumica e veprave, përbën një sfidë përballë temave dhe kanoneve të imponuara të realizmit socialist. Tema e nënës, ndjenjat nënë-fëmijë, si ndjenjat më natyrale, mund të vinin në plan të dytë ose vinin në dyshim tematikën e asaj kohe.

Autori nuk shfaqet asnjëherë me praninë e tij fizike, (përveç një rasti të sjellë enkas), duke e lënë personazhin në përditshmërinë e saj. Vështrimi ynë e ndjek atë në momente dhe vende krejtësisht të zakonshme, pa ndonjë impostim të veçantë, e pavetëdijshme për vëmendjen tonë, por e mbrojtur nga engjëjt, në dedikimin e saj të pafund, plot sakrifica të pabujshme. Është një paraqitje e jetës në vërtetësinë e saj vetëmohuese, larg pathosit idealizues, larg protagonizmit skenik, disi prapa kuintave.

Zaya e vizaton atë në mënyrën e tij, e në shumicën e rasteve pa praninë e modelit. Ne e ndjekim personazhin tonë që nga mosha e pjekurisë, kur Zaya ishte student, e deri më sot. E shohim si ajo plaket pa u vënë re dhe, më së fundi, shohim përpjekjen e piktorit për ta nxjerrë në skenë duke e mbështjellë me një qetësi dhe siguri të përplotësuar, dhe herë-herë me një buzagaz ironik. Ai e ndërton personalitetin e saj çast pas çasti,

Zaim Elezi prezanton në ekspozitën "NANA" një grup punimesh, që fillojnë nga vitet '80-të e deri më sot, kohë që rrok dy sistemet, shumë ndryshime, por që në këtë ekspozitë ruan vetëm një dimension, dashurinë për nënën, të parë në 360 gradë.

ditë pas dite e vit pas viti, për t'i ruajtur këto momente përgjithmonë pranë tij (siç autori shprehet), pa asnjë qëllim tjetër. Është vështrimi i një jete që konsumohet me një devocion vetëmohues. E sjell fshehurazi këtë, në kontrast me paraqitjen fizike të saj, e fortë, e plotë, vitale si një forcë e natyrës. Vizatohet dukshëm nga Zaya në një formë të tillë, figura, torsi, portreti dhe veçanërisht duart, janë në kërkim të vazhdueshëm të një gjendje në lëvizje, drejt një selektimi ku të gjitha treten në dimensionin e të Zonjës së Shtëpisë. Ai qaset disi spontanisht, në mënyrën si paraqet personazhin në impostimin e saj, gjestin, vështrimin, kontekstin ku ajo vepron, zgjidhjen koloristike, raportin me shikuesin, rekuizitën, dekorin, dritën dhe hapësirën, duke mos i dhënë asaj ndonjë status të privilegjuar e moralistik në vërtetësinë e çasteve të së përditshmes.

Lexojmë dy histori: historinë e nënës dhe të një djaloshi që bëhet burrë. Është rrëfimi i tij mbi historinë më të bukur që ka përcjellë njerëzimi. Një histori që flet shumë më tepër se historia e dy njerëzve.

Në mënyrë instiktive ai reflekton ndjeshmëri paralele, të dyfishta. Imazhet e trupit njerëzor përmbajnë dhe ofrojnë imazhe të ambientit kulturor, të strukturave të tij, të kodeve të tij. Trupi është një sociografi dhe një histori e kulturës. Mjetet janë të shumta.

Mjeshtëria e vizatimit e ndihmon atë ta ndjekë personazhin pa e trazuar, duke e përcjellë si kujtesë në ritualin e saj. Ai e modelon fort atë, duke kërkuar tridimensionalitetin, i cili në shumicën e rasteve e zotëron hapësirën. Me një modelim skulptorik prania e personazhit fuqizohet pa zbukurime të jashtme, duke fituar siguri dhe forcë. Ngjyra vepron në drejtime të tjera. Aty ai është më spontan, aq sa ruan masat e mëdha dhe të sheshta, aq dhe e shkërmoq sipërfaqen duke e prekur me ndjeshmëri të rralla.

Peneli i tij sa i dukshëm dhe i ngjeshur mbi telajo me plot siguri, po aq tretet dhe zhduket, duke i lënë vend një hapësire pa tregues, duke vënë në pah gjendjen psikologjike. Ai është mjeshtër i ekuilibrit dhe i fokusit ritmik. Mënyra si kompozon çdo element në telajo, balanca dhe atmosfera që krijon, të çojnë lehtësisht atje ku ai dëshiron, te portreti i nënës. Aty shohim gjithë arsenalin e tij piktorik, qoftë në momentet psikologjike e piktorike të një realizmi mjeshtëror, deri në abstragime të realizuara mjeshtërisht me forcën e frymëzimit dhe talentit.

Lexojmë dy histori: historinë e nënës dhe të një djaloshi që bëhet burrë. Është rrëfimi i tij mbi historinë më të bukur që ka përcjellë njerëzimi. Një histori që flet shumë më tepër se historia e dy njerëzve.

Shef i Departamentit të Skulpturës
Fakulteti i Arteve të Bukura
Universiteti i Arteve, Tiranë

Në qendër të Okshatinës, në anë të rrugës, ndodhet punishtja e tij që ngjan me një galeri artesh në natyrë

Lulzim Plaku, djali i mrekullive

Nga **OSMAN XHILI**

Aty në qendër të Okshatinës, në anë të rrugës që të çon për Bulqizë e më pas për Tiranë, syri të kap pamje me të vërtetë interesante e magjepsëse. Të duket sikur sheh një galeri artesh, apo një ekspozitë piktorësh të mëdhenj. Në fakt, autori i kësaj mrekullie është Lulzim Plaku, një djalë i thjeshtë, që jeta e përplasi furishëm në dallgët e saja për mbijetesë. Ndoshta dhe tetë klasët nuk i mbaroi tamam, pasi duhej të kulloste tufën e dhive për të mbajtur gjallë familjen. Në vend të çantës me libra, kërrabën e çobanit, në vend të lojërave fëminore, hallet e brengat. Kishte dëgjuar për demokracinë si një sistem vlerash, si një ëndërr e bukur, por jo, nuk paska qenë e tillë. Të paktën Lulzimit të vogël nuk i kishte sjellë gjëra me vlerë.

Vitet po ecnin dhe një ditë ai e la tufën e dhive. U nis për në brigjet e Italisë, si shumë të rinj të tjerë. Ishte vetëm 15 vjeç. Nuk ishte i madh, por ndjehej i tillë. Jeta e kishte kalitur dhe e kishte mësuar ta fitonte vetë bukën e gojës e të mos i bëhej barrë dikujt tjetër.

Italiani me emrin Andrea e trajtoi si djalin e tij. Ai kishte një biznes familjar, ku prodhonte vazo dhe gjëra të tjera artistike dhe Lulzimi e ndihmonte në procese të ndryshme të kësaj pune. Ndonjëherë shërbente dhe si shitës në dyqanin e familjes së tyre. Lulzimit po i pëlqente mjaft ky lloj biznesi dhe mendoi se mund ta realizonte vetë një gjë të tillë. Në fshatin e tij, në Okshatinë kishte dy dynymë tokë, ngjitur me rrugën. Ta provonte njëherë, nëse mund të ecte i vetëm, pa ndihmën e dikujt!

Largimi i popullsisë në përgjithësi dhe i të rinjve në mënyrë të veçantë, siç dëmton çdo biznes tjetër, le gjurmë dhe te Lulzimi. Ai i ka letrat e rregullta për në Itali dhe fare mirë mund të transferohet atje, të punojë e të jetojë, madje me të ardhura më të mira. Lulzimi dëshiron të qëndrojë në fshatin e tij, ku kaloi fëmijërinë, dëshiron që rrugët e fshatit të mbushen me zhurma fëmijësh, dëshiron të vizitojë vendet e bukura që ka Dibra dhe Shqipëria, dëshiron që atdheu i tij të jetë modeli, që të tjerët duhet të ndjekin.

HAPAT E PARË NË BIZNES

Viti 2014. Lulzimi i mban mend fare mirë punimet e para. Mendoi ta fillonte me lavamanë dhe bëri gjashtë të tillë. Emocione të mëdha përjetoi. A do ti dilnin të bukura punimet? Për më tepër, a do t'i shiteshin ato? Si të gjitha fillimet dhe i tij ishte disi i vështirë. Sa fitonte ndonjë lekë, nxitonte të marrë materiale për punën e re, apo të porosiste ndonjë formë, apo kallëp më të bukur se të parët.

Shtatë vite që atëherë. Lulzimi ka ngritur një perandori objektesh, aq sa dhe emrat tyre e ke vështirë ti thuash të gjithë. Aty gjen delen, bashkë me qingjat e saj, siç sheh dhe kuajt me lëkurë të lëmuar, që janë gati për gara. Shumë shqiponja! Të mëdha e të vogla në madhësi, me ngjyra të ndryshme, në pozicione të ndryshme. Aq shumë përngjasojnë me të gjallat, saqë të duket se do të nisen nga një moment në tjetrin për tu ngjitur në lartësi. Ndoshta, vetëm dashuria për Lulzimin, djali që u dha formën dhe shpirt nga shpirti i tij, i mban akoma aty akoma të palëvizura.

Kafshët e malit sigurisht që janë të pranishme. Ujku e dhelpra pranë e pranë njëri-tjetrit, si dy miq e armiq në të njëjtën kohë. Ka dhe lepuj në park, siç ka dhe gjela. Më tej vijnë kafshët e xhunglës të përfaqësuara nga tigri dhe luani. Sa shumë mund e lodhje, sa shumë përpjekje për të ecur përpara në këtë biznes të një lloji të veçantë! Piktori punon

në letër dhe e ka shumë të vështirë, kurse këtu granili, çimentoja, hekuri, uji, përzihen sëbashku në masa të caktuara, në temperatura të caktuara. Lodhje fizike dhe mendore në të njëjtën kohë për të bërë më të mirën, për të arritur atë çfarë ka synuar në fillim.

Nuk do habiteni po të shihni në këtë "ekspozitë " dhe bustin e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, të punuar me shumë kujdes e dashuri. Ndoshta ai ka rolin e komandantit të përgjithshëm për gjithë ato që janë prezentë në këtë koleksion interesant.

Lulzim Plaku e meriton të quhet djali i mrekullive . Gati një dynym vend është i zënë nga ekspozita e punëve të bukura, që ai ka krijuar gjatë këtyre shtatë viteve. Sa lavamanë të shitur mbajnë vulën e duarve të tij, sa vazo të prodhuara prej tij, janë vendosur në vila e resorte, të mbushura me lule, sa shpendë, pëllumba e shqiponja ! Punët e tij e kanë kaluar kufirin e Dibrës, kanë udhëtuar në qytete të tjera të vendit, por ka dhe punë të shitura jashtë shtetit.

Lulzim Plaku, ky mjeshtër duarartë dhe fjalëpak, ka një disiplinë të lartë në punë. Ai përpiqet të nxjerrë gjithmonë punime cilësore për të kënaqur klientët, por dhe veten e tij. Çdo gjë që hedh është në masën e duhur, pa kursyer asgjë, pasi do që njerëzit t'ja bëjnë hallall paratë që i kanë dhënë në këmbim të mallit.

Bashkëshortja e tij, Gëzimja, është partnerija e tij, pa të cilin ndoshta nuk do të kishte arritur këto gradë suksesi. Ajo, jo vetëm bën detyrat si zonjë shtëpie, por punon si specialiste klasi, bashkë me Lulzimin. Ata kanë tre fëmijë, tre djem, ku më i madhi i tyre është Aliu në klasën e pestë. Lulzimi dëshiron ti shkollojë ato më së miri, të paktën të plotësojë diçka nga ajo që nuk arriti vetë gjatë jetës. Por jo gjithnjë gjërat shkojnë sipas dëshirës. Krahas mësimit, djali që tani është bërë një mjeshtër i vërtetë i punës, ngjashëm me babain e tij. Ndoshta duan kështu të krijojnë një traditë familjare për ta përçuar në breza.

ME SYTË NGA E ARDHMJA

Lulzim Plaku rend e vrapon në garë me kohën. Ai nuk ka frikë nga konkurrenca e të tjerëve. Kur e sheh që dhe dikush tjetër ka bërë punime si të tijat, ai menjëherë gjen dhe sajon diçka të re, që askush nuk e ka prodhuar më parë. Zeja e tij nuk ka të ndalur në cilësinë dhe shumëllojshmërinë e gjërave. Ai zbukuron shtëpitë me kolona, ai prodhon zgara cilësore për të pjekur mish, apo për të bërë gatime të ndryshme. Kohët e fundit Lulzimi po u kushton vëmendje punës me oxhaqet, që i monton sipas porosive në vilat e reja. Klientët thonë, se askush si ai nuk di të bëjë montimin e oxhaqeve. Futja e leshit të gurit në sasi dhe cilësi, rregullimi i lëvizjes së ajrit në oxhak dhe shumë elemente të tjerë teknikë e bëjnë punën e tij të dallueshme dhe të kërkuar gjithnjë e më tepër.

Largimi i popullsisë në përgjithësi dhe i të rinjve në mënyrë të veçantë, siç dëmton çdo biznes tjetër, le gjurmë dhe te Lulzimi. Jo, ai nuk frikësohet për vete e për familjen e tij. Ai i ka letrat e rregullta për në Itali dhe fare mirë mund të transferohet atje, të punojë e të jetojë, madje me të ardhura më të mira. Lulzimi dëshiron të qëndrojë në fshatin e tij, ku kaloi fëmijërinë, dëshiron që rrugët e fshatit të mbushen me zhurma fëmijësh, dëshiron të vizitojë vendet e bukura që ka Dibra dhe Shqipëria, dëshiron që atdheu i tij të jetë modeli, që të tjerët duhet të ndjekin.

portret

Nga cikli:
100 vjet Lan-Lurë, 100 vjet Shqipëri

Pasioni për Dibrën i çidhnakut Mustafa Tola

Do të desha që më 28 tetor 2021, në 100 vjetorin e betejës heroike të Lanë-Lurës, nga maja e Shkëmbi të Tajanit, prej ku pamja e Dibrës me Korabin në ballë e me Luginën e Drinit ku janë zhvilluar 18 nga 24 betejat fitimtare të Skënderbeut kundër turqve osmanlinj dhe dhjetëra beteja të dibranëve të vetëm në luftë kundër pushtuesve serbë, këngëtarët epikë Arif Vladi dhe Kastriot Tusha të këndonin hapakrahësh Himnin e Djelmënisë Dibrane...

Drin o lum i gjatë, plaku i malësisë,
A ke me ia lanë Dibrën Serbisë...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

E kam njohur Mustafa Tolën një jetë të tërë.

E kam njohur në trojet e të parëve në Çidhën ku kafja ti mbledh në gojë shijet e maleve të Dibrës, ritin e papërsëritshëm të pjekjes, bluarjes, shtrirjen mbi dërrasën e sharruar dhe zdruguar vetëm për të, zierjes dhe derdhjes në filxhanin pa bisht, karakteristik për Dibrën.

E kam njohur në përkushtimin në profesion dhe në qytetari.

Më shumë e kam njohur nga larg, në mërgimin tim të detyruar, atëherë kur intelektualë të Dibrës i vunë shpatullat për ta mbajte e ngritur lart...

E kam njohur në betejën e madhe të tij për mbrojtjen e Setës, lumit të jetës së tij, lumë ku kapte troftat me duar, lumë ku ka mësuar notin, lumë që u fliste kohëve me shkumën e burimeve e melodinë mbi pentagramin e rrjedhës.

Nuk e ekzagjeroj po të them se Mustafa Tola është intelektuali në krye e në ballë të mbrojtjes të bukurisë dhe begatisë së lumit të Setës.

I kam qëndruar në krah në të gjitha ballafaqimet dhe kundërshtinë e tij për ndërtimin e hidrocentralit mbi Setë. Kam shkruar, mbase dhjetëra herë, në dhjetëra organe me thirrjen që Seta, lugina madhështore e saj, kanioni që mban heroizmin dibran për ndërtimin e kanalit të Çidhnës, vepër unike që meriton të shndërrohet në një "auditor" natyror mësimi historie e mjeshtërie ndërtimesh popullore...

Edhe unë, në shkrimet e mia, kam qenë për ndërtimin e një hidrocentrali mbi Setë ashtu siç kam menduar që degët e Drinit (Seta, Murra, Veleshica, Malla, Zalli i Okshtunit..." të prodhojnë energji elektrike dhe me ujëmbledhësit e tyre ti shtojnë Dibrës "Sy" për të parë qiellin, "Sy" që për mendimin tim do të prodhonin aq energji elektrike sa Skavica mbytëse dhe shkatërrimi ekologjik e historik të Dibrës. E kam menduar (dhe shkruar në "Po Dibrës! Jo Skavicës!" etj.) me një digë në ngushticën e fundit të saj para se të marrë paksa frymë nga kanioni i thellë ku natyra e ka burgosur, diku mbi hidrocentralin që merr ujë nga Kanali i Çidhnës. Një digë argjile apo betoni me lartësi sa pasqyra e ujit të arrijë nën këmbët e burimit të madh në Gurë Lurë. Kam shënuar që nëpër atë labirint malesh të lundronin "gondola" ku turistët të lexonin bukurinë e natyrës dhe heroizmin e papërsëritshëm dibran. Kam shënuar që nga Gurë Lura, tashmë një qytezë turistike ku rakia e thanave dhe kecat rritur tërë vitin në natyrë, të ishin shija dhe menyja e udhëtimit)me një teleferik turistët të ngjiten tek Liqeni i Luleve e të bridhnin liqeneve të tjerë e fushës madhështore të Pllajës ku thonë se dikur Skënderbeu kishte bazën e riprodhimit të kuajve luftarakë.

Mustafa Tola dhe Ali Hoxh, gjatë një proteste për mbrojtjen e Setës

Seta e menduar dhe e "ndryshuar" me syrin e ekologut, elektrologut, turistit, bisnesmenit... duhet të ketë një projekt për sot dhe për të ardhmen....

Këto i kam gjetur në shikimin e thellë të Mustafa Tolës, në intelektin e tij do të thosha brilant.

Ndaj e kam përkrahur.

Ndaj do ta përkrah.

Dibra ka nevojë për vizion intelektual, vizion që ta shohë të nesërmen me dashuri e përkushtim.

Mustafa Tola erdhi e më gjeti mëngjesin e 17 korrikut 2021 në Malin e Robit ku kam një shtëpi të vogël, të vetmen shtëpi të jetës sime sot.

Pimë kafe dhe udhëtuam maleve të Dibrës.

Mjerisht me mend se mërgimi një çerekshekullor dhe gjunjët e ngrirë të pleqërisë ma ndalën tu ngjitem atyre vendeve ku kam dëgjuar zanat të këndojnë e njerëzit e qeshur fiksuar në celuloid.

E brente diçka, kishte një brengë dhe donte ta ndante me mua.

Mu bë qejfi. E falënderoj për respektin dhe për zgjimin që më bëri pas shumë muajsh "thyerje lapsi" e heshtje publike.

Kishte lexuar një shkrim timin botuar në vitin 1992 ku pasi përshkruaja paksa betejën historike të Lanë-Lurës, betejë që e përcolli serbin përfundimisht tej kufirit të Londrës-1913 pyesja se kujt i intereson shkatërrimi i lapidarit vendosur në kujtim të asaj ngjarjeje të madhe.

Kish lexuar edhe shkrimin nxitur nga 100 vjetori i Luftës së Vlorës ku ballafaqoja hedhjen e italianit në det nga luftëtarët shqiptarë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe mbytjen e serbit në Drinin e zi nga luftëtarët dibranë, pa një pushkë të vetme nga krahinat e tjera të Shqipërisë.

Dhe kishte bredhë ditë të tëra në kërkim të "zërave historianë" që 100 vjetori i betejës historike të Lan-Lurës të dilte në dritë me tërë madhështinë e vet.

Kishte trokitur shumë. Në shumë dyer e dritare.

Kishte trokitur në dyert e bashkisë së Peshkopisë.

Kryebashkiaku i ri nuk dinte gjë, nuk kishte asnjë letër në sirtarët e tij për 100 vjetorin e betejës së Lan-Lurës, 100 vjetorin e vendosjes përfundimtare të kufijve që kemi sot (!)

"Si është e mundur"?, kishte pyet

Kishte trokitur në dyert e Akademisë sonë të Shkencave. Ishte takuar me personalitete të historiografisë shqiptare, nga ata "me pak zë" dhe nga ata me "shumë zë".

Kishte parë se si ngriheshin supet e shtrembëroheshin në fytyrë...

"Beteja e Lan- Lurës"?

"Kur është bërë"?

"100 vjetor"?

Asnjë program, asnjë aktivitet akademik...

Një intelektual dibran, një zooteknik në profesionin universitar, u tregon arat baballarëve të historisë...

Diçka mori nga ato takime.

Diçka zgjoi.

Kishte këndellë një zjarr që përmes krandeve të thara nxori gjuhëza flake...

* * *

Iku duke më lënë në shpirt një brengë, brengën që e kisha shprehur afro tri dekada më parë kur lapidari i betejës së Lan-Lurës u shkul nga rrënjët me synimin të shkulet burrëria dhe trimëria dibrane, e vetme në një betejë ku nuk pati asnjë "pushkë" nga asnjë trevë e Shqipërisë, ASNJË!...

I dërgova shënimet e mia të një viti të shkuar në adresë të kryetarit të bashkisë së Dibrës me një skenar të gjerë të përkujtimit të 100 vjetorit të Betejës së Madhe. I dërgova shkrimin tim:"KUJT I INTERESON SHUARJA E FITORES SË LANË-LURËS?" – 1992 dhe shkrimin:"NJË 100 VJETOR QË DUHET PËRKUJTUAR E FESTUAR NË MASËN E LUFTËS SË VLORËS" si dhe disa shkrime historike që lidhen me fitoren madhështore të dibranëve në mbrojtje të vatrave të tyre shqiptare nga synimi serb për të dalë në Drin e për të marshuar drejt Durrësit. Kishte vijuar trokitjet derisa zgjimi me sy ende të përgjumur kishte bërë rrugë...

Më njoftoi se të shtunën... do të bëhej një takim i ngushtë...

U gëzova.

Më shumë për të, për përpjekjet e tij në një rrugë me shumë gropa...

Më ftonte të bëhesha pjesë e atij takimi...

I thashë se nuk mundesha. Një udhëtim makinë pas makine nga Mali i Robit në Tiranë ishte i vështirë për moshën dhe shëndetin tim.

Kur u ktheva në Athinë përsëri mora njoftim për një takim për 100 vjetorin e betejës historike...

Mësova nga njoftime të shkurtra në fb se diçka ishte vënë në platformën e përkujtimit të ngjarjes. Një si "sesion shkencor" e të tjera...

Unë, siç edhe e kam kërkuar një vit të shkuar në letërkëmbimin me kryetarin e bashkisë së Dibrës DionisYmeraj do të desha një festim të madh, më të madh se ai i 100 vjetorit të Vlorës kur italianët u hodhën në det (vetëm në det se Sazani i tyre mbeti deri në përfundim të Luftës II Botërore)...

Shkruaja:

"Vitin e ardhshëm është 100 vjetori i Betejës së Lanë-Lurës, (28 tetor 1921) betejë që mbyti serbo-jugosllavët në Drin, betejë që bëri jehonë të madhe në të gjithë botën dhe solli pavarësinë përfundimtare të Shqipërisë.

Ky përvjetor duhet të përkujtohet në masën e "Luftës së Vlorës". Me madhështi, me përkushtim qytetar dhe në vijim të shndërrohet në një festë të madhe shqiptare të përvitshme. Në Lanë-Lurë, në krye të saj, atje ku ka qenë vendos lapidari, çuditërisht i shkatërruar në hapat e parë të demokracisë (Shiko shkrimin "Kujt i intereson shuarja e fitores së Lanë-Lurës, Z.P dhjetor 1992) mendoj se duhet të ngrihet një memorial madhështor që të dominojë pamjen, madje edhe nga sateliti. Bashkangjitur po ju dërgoj një shkrim timin të një çerek shekulli më parë kur lapidari i ngritur në krye të fushës së Lanë-Lurës u shkatërrua. Sugjeroj një vendim që tani nga ana e Këshillit -Bashkiak dhe bërjen e një programi me hollësi për përkujtimin e saj.

Lura, shumë vite më parë, kremtonte "Festën e Liqeneve". Mendimi im është që ajo duhet të zgjerohet dhe festohet me qendër fushën e bukur të Lanë-Lurës e me degëzime deri në Fushën e Pelave dhe fushën e Krej-Lurës, me veprimtari atdhetare, konkurse, gara hipizmi (Fusha e Pelave ose e Lanë Lurës), me panair tregtar me prodhimet e vendit, me tërheqje masive turistësh vendas e të huaj. Për hollësi organizimi, më në detaje, mund të komunikojmë pas vendosjes së festimit të 100 vjetorit. - Athinë, 23 shtator 2020"

Do të desha qëmë 28 tetor 2021, në 100 vjetorin e betejës heroike të Lanë-Lurës,nga maja e Shkëmbi të Tajanit prej ku pamja e Dibrës me Korabin në ballë e Luginën e Drinit ku janë zhvilluar 18 nga 24 betejat fitimtare të Skënderbeut kundër turqve osmanlinj dhe dhjetëra beteja të dibranëve të vetëm në luftë kundër pushtuesve serbë, betejën aktuale të Mustafa Tolës dhe të një grupi të gjerë intelektualësh dibranë që ajo luginë të qëndrojë ashtu siç e ka bërë Zoti, që eshtrat e luftëtarëve në histori të mos lëvizen nga varret e të mos mbyten nga liqeni i turbullt i Skavicës, DESHA DHEDUA që këngëtarët epikë ***Arif Vladi dhe Kastriot Tusha*** të këndonin hapakrahësh "Himnin e Djelmënisë Dibrane..."

Drin o lum i gjatë, plaku i malësisë,
A ke me ia lanë Dibrën Serbisë...

A do ta këndojnë?

Nuk e besoj.

Ju e besoni?

Athinë, 29 shtator 2021

Me rastin e 100 vjetorit të betejës së Lanë Lurës
28 tetor 1921

Luftërat e Dibrës kundër ndërhyrjes ushtarake

Prof. **BAJRAM XHAFA**

Beteja në Lanë Lurë është beteja e fundit në ballafaqimet luftarake të dibranëve me serbët, në Luftën Çlirimtare të Dibrës kundër Intervencionit Ushtarak Jugosllav të viteve 1918 – 1921.
Kjo betejë përmbyll një etapë historike të qëndresës luftarake të shqiptarëve me fqinjët ballkanikë dhe jo ballkanikë, periudhë që kanga popullore në mënyrë poetike e ka stampuar në vargun "Qe nantë vjet luftojmë me krajla"...

Me rastin e 100 vjetorit të betejës së Lanë Lurës, 28 tetor 1921, organizojmë këtë akademi përkujtimore shkencore në këtë vit jubilar. Është beteja e fundit në ballafaqimet luftarake të dibranëve me serbët, në Luftën Çlirimtare të Dibrës kundër Intervencionit Ushtarak Jugosllav të viteve 1918 – 1921.

Beteja në Lanë Lurë në fakt përmbyllte një etapë historike të qëndresës luftarake të shqiptarëve me fqinjët ballkanikë dhe jo ballkanikë, periudhë që kanga popullore në mënyrë poetike e ka stampuar në vargun "Qe nantë vjet luftojmë me krajla".

Çfarë e detyroi Shqipërinë dhe Dibrën të luftojë pa da me krajlat e Ballkanit dhe të përtej Ballkanit për nantë vjet rresht, nga 1912 –ta deri më 1921? Gjatë kësaj periudhe bota pa dy luftëra: një Ballkanike, 1912-1913 dhe një Botërore 1914-1914 në të cilat u përfshi edhe Shqipëria. Cili ishte shkaku i këtyre luftërave, që shqiptarët as i shpallën dhe as ua kishim borxh.

Pavarësia shqiptare, një e drejtë e ligjshme e tyre, u shpall në momentin më të keq historik; në dimrin më të acartë, jo vetën si stinë apo si muaj i vitit, por edhe si stinë politike kur Evropa po e çonte botën drejt Luftës së Madhe. Pavarëria erdhi kur qielli dhe toka e saj gjëmonin nga topat dhe krismat e pushkëve, zjarri dhe flaka e Luftës Ballkanike; kur koalicioni i shteteve të krishtera të Ballkanit, ngarkuar me urrejtje racore dhe fetare ndaj shqiptarëve, me nxitjen e Evropës, i kishte shpallur luftë Perandorisë Osmane, pjesë e së cilës ishte Shqipëria. Nën qiellin tokën e shkrumbuar shqiptare, shqiptarët qenë të detyruar të shijojnë pavarësinë e tyre.

Është pak ose aspak e besueshme, që kryengritjet shqiptare sollën pavarësinë e tyre. Jo se ata nuk e kanë dashur pavarësinë, por kryengritjet dhe luftërat e shqiptarëve më shumë i kanë nxitur e manipuluar armiqtë e Shqipërisë për interesat e tyre. Shqiptarët vetëm sa kanë dredhur gjakun. Kjo është në thelb tragjizmi i shqiptarëve para dhe pas këtyre ngjarjeve. Shqiptarët më shumë kanë qenë protagonistë gjakhupët. Ata e kishin merituar prej kohësh pavarësinë, madje shumë para fqinjëve të tyre, por ajo u llogarit kur Evropa i kishte "bërë" fqinjët tanë gati 100 vjet para tyre. Ajo "erdhi" kur fqinjët e krishterë ballkanikë i kishin zatekur keqas shqiptarët dhe u turrën kundër tyre me zjarr e me hekur për t'i shfarosur.

Në këtë sfond historik, gjaku e ploje dhe nën ultimatumin e rrufeshëm të ngjarjeve të luftës u shpall edhe Pavarësia e Shqipërisë. Ultimatumi i rrufeshëm i ngjarjeve[1] (shprehje e historianit francez Hanato) detyroi Evropën që çështja shqiptare të shtrohej zyrtarisht për zgjidhje në tryezat e diplomacisë së Fuqive. Kështu "erdhi" edhe pavarësia shqiptare. Dhe ashtu si e sollën atë, por të ngarkuar me farën e luftës, nga jashtë e nga brenda,

Me fillimin e Luftës së Ballkanit, Evropa nuk mund ta zvarriste më gjatë punën e sistemimit të kësaj race të torturuar, që vegjeton, e *rrahur nga të gjitha furtunat e fatit të keq*, në bregun tjetër të Adriatikut, të shqiptarëve, e që me fatin e së cilës lidhet aq shumë paqja e diplomacive, shkruan Italo Sullioti[2]...Eshtë, pra, (citojmë), i vënë në gabim a në dashakeqësi ai që, duke u marrë me çështjen shqiptare, shtiret t'ia fshehë vështirësinë e jashtëzakonshme. Europa e ka trajtuar Shqipërinë, gjithmonë si një pikë qendrore të një pëlhure diplomatike (Sullioti, f. 25).

Në këto kushte u mblodh Konferenca e Ambasadorëve të gjashtë Fuqive të Mëdha në Londër më 17 dhjetor 1912 – 12 gusht 1913. Ajo do të merrej ekskluzivisht me "çështjen shqiptare"; me statusin (pozitën politike), caktimin e kufijve të saj dhe organizimin e brendshëm të Shqipërisë. Ç'bëri ajo? Një mynxyrë të vërtetë, një krim politik të pashembullt. Pas Luftës Ruso-Osmane dhe Serbo e Malazezo-Osmane të vitit 1877-1878 dhe Kongresit të Berlinit 1878, Lufta Ballkanike dhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912-1913 e hodhën në greminë Shqipërinë kombin dhe popullin shqiptar. I shkaktuan atij katastrofën më të madhe në gjithë historinë e tij 3 mijë vjeçare. Me dhimbje në shpirt e në gjendje dëshpërimi të thellë Mehmet Akif, poeti i madh dhe autor i himnit kombëtar turk me origjinë nga Peja, më 1913 shkroi këto vargje:

Dëgjoje këtë nga unë: po, unë jam shqiptar /
Tjetër s'kam ç'të them, ja, ***u shkatërrua atdheu im***[3]

Origjina e luftërave të shqiptarëve ka si vektorë të saj: së pari ambiciet e shfrenuara politike shoviniste të shteteve ballkanike dhe, së dyti, përkrahjen dhe mbështetjen politike e diplomatike të Fuqive të Mëdha të Evropës.

Diplomati amerikan Xhorxh F. Wiliams, ish ministri i Amerikës në Greqi dhe Mal të Zi dhe vrojtues i Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit në Shqipëri më 1914, në librin "SHQIPTARËT" (1934), shkruan porosinë që anglezi Uksensherna (1583 - 1654) kançelar i Suedisë 1612 i jep djalit të tij: Djali im, ti nuk e din se me sa pak mëshirë qeveriset bota. Kurse ne shqiptarët duhet të themi se sa e pamëshirshme dhe katile është treguar Evropa me vendimet për Shqipërinë. Ne s'na mbetet veçse të lëshojmë atë namën e Hoxhë Kallës kur nga fundi i jetës kuptoi pabesinë e madhe që i ishte bërë në fillim të jetës: "më paske pre në besë dhe më ke marrë në qafë, (zotni Elez), por aq shumë sa ne besojmë në perëndi, aq i madh qoftë ndëshkimi për ty. Edhe neve s'na mbetet tjetër veç të fshajmë: "Aq i madh qoftë ndëshkimi i të Madhit Zot për Evropën!".

Shqipëria, një vend kaq i vogël dhe i prapambetur, shkruan Wiliams, pse luan një rol kaq të madh në politikën e Evropës? Përgjigja më e shkurtër, thotë ai, është se situata gjeografike e Shqipërisë paraqet probleme politike edhe më të gjëra se ato të parashtruara prej shteteve të tjerë të Ballkanit. *Gjendja e Shqipërisë është një faktor kryesor i problemit të Lindjes*, mbasi kjo është udha natyrale e kalimit prej Adriatikut në Lindje. Përveç kësaj është pikërisht vendi për daljen e tregtisë së Ballkanit dhe së fundi, *ajo ka në dorë komandën e hyrjes në Adriatik në ngushticën e Otrantos*. Portet e saj, me portet në detin Egje të Selanikut dhe të Bosforit, *janë çelësat e dyerve të Evropës Lindore për në Detin Mesdhe* (nënvizimi im). Për të marrë në dorë këto çelësa diplomacia e Evropës ka punuar për dy shekuj resht. Dmth, për dy shekuj ne na ka gërryer Evropa, jo Turqia.

Përmbi të gjitha del e dukshme figura e Rusisë, qëllimi politik i së cilës ka qenë me pas kalim të lirë në detin Mesdhe. Për këtë qëllim ajo synon shkatërrimin e Turqisë, konkludon Wiliams dhe vazhdon:

Austria dhe Italia komandojnë detin Adriatik përveç ballit të Shqipërisë dhe presin të shtinë në dorë portet e këtij vendi. Ata qenë posaçërisht në marrëveshje: e para, që asnjëra prej tyre të mos sundonte Shqipërinë dhe e dyta, që asnjë fuqi tjetër të mos vendosej në Adriatik. Këtu e ka fillin pavarësia e Shqipërisë; këtu janë edhe detonatorët që e mbajnë Shqipërinë në zjarr e gati në shpërthim.

Në këtë plan veprimesh Austria dhe Italia ishin pa kundërshtim fuqitë lëvizëse. Kur Austro - Hungaria mori më 1908 Bosnjën dhe Hercegovinën për pak qe duke u shkaktuar një luftë evropiane dhe vepra e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar sigurisht qe duke ndezur një ndeshje të përgjithshme.

Plani për një perandori sllave ushqehesh më tepër prej Serbisë nën emrin e krijuar "Serbia e Madhe". Edhe Mali i Zi është bashkuar me këtë plan; që të dy duke qenë nën kujdesin e Rusisë, mbrojtëses së tyre të betuar.

Xhorxh Wiliams bën fajtore diplomacinë evropiane që e ka mbajtur peng Shqipërinë.

Shqipëria, viktima kryesore e kësaj diplomacie, mbetet e lodhur, e kërrusur dhe e zhytur në gjak...Diplomacia e shastisur (e Evropës) vendosi të zbatojë forcën dhe tiraninë për të sunduar këtë popull; por ky vendim doemos do të binte poshtë sikurse u pa.

Shtetet e Europës kanë bërtitur dhe kanë shpallur se Shqiptarët janë popull i pabindur, i egër e barbar. Por në anën tjetër deshën të krijojnë mbi ta një qeveri pa pyetur dëshirat e tyre, pa u siguruar ndonjë farë lirie ose të drejta trashëgimore, e, më në fund, pa asnjë këmbë ushtari për të vënë në zbatim programin e tyre, sollën vetëm disa oficerë[4], kurse ushtarë jo.

Ata prenë copa me rëndësi nga toka Shqiptare dhe ia dhanë fqinjëve në Veri, në Jug e në Lindje, duke shkaktuar kështu ngatërresa dhe lufta të përditshme në mes të këtyre shteteve, shkruan diplomati amerikan. Në fakt Evropa e "këputi për mesi" Shqipërinë. Këtu qëndron burimi i gjakderdhjes së shqiptarëve që do të vazhdojë për nantë vjet e për dy shekuj rresht. Copën që mbeti nga gërshëra e tyre, thotë Wiliams, e quajtën shteti i pavarur i Shqipërisë që është bërë tehu i influencave heterogjene që e tërheqin atë në drejtime të ndryshme (Wiliams, "Shqiptarët" f. 43).

Kur gjashtë fuqitë e mëdha hartuan një plan qeverimi për Shqipërinë, vepra e tyre tregoi një pazotësi të çuditshme, sepse ai qe një plan që nuk i përshtatesh një shteti si ky. Marrëveshja e Londrës përmbante nenet:

1. Një Principatë autonome, sovrane, me të drejtë trashëgimi të fronit nga të paslindurit dhe nën sigurimin e gjashtë fuqive të mëdha. Në këtë kohë Evropa llogariste të shpërthente luftën mes vedit. Dhe kjo nuk e mbushi as vitin. Atëherë, si do t'i vente halli princit dhe principatës? Ky fat ka për faturë gjakderdhjen e shqiptarëve. A nuk ndodhi kështu me Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme?

4. Kontrollimi i administratave qytetare dhe i financave i jepet një komisioni ndërkombëtar të përbërë prej delegatësh të gjashtë fuqive të mëdha, shkruan Wiliams. Kur të fillonte lufta, siç edhe filloi, si do të funksiononte komisioni, anëtarët e të cilit do të ishin në luftë me njëri tjetrin?

7. Emërimi i princit, formimi i një qeverie kombëtare përfundimtare, funksionet e autoriteteve të vendit si dhe qetësia e popullit i lihen në dorë komisionit në fjalë. Kur komisioni do të shpërbëhej për shkak të luftës, ku do të "vareshin" princi, qeveria kombëtare dhe autoritetet e vendit?

8. Sigurimi i popullit dhe rregulli do të bëhet nga xhandarmëria që do të jetë në dorën e oficerëve të huaj. Tani, si mund të formohet një shtet mbi një plan si ky, pyet diplomati amerikan.

Sipas vendimit të marrëveshjes (së Londrës), princi do të zgjidhej pa pyetur dëshirat e popullit[5]; gjithashtu funksionet e autoriteteve të vendit dhe sigurimi publik u hoqën nga duart e popullit. Nuk qe vënë përpara një statut në bazë të të cilit të qeverisej ky popull dhe as ndonjë premtim nuk i qe bërë për një liri të plotë ose për të ushtruar të drejtat tradicionale. Ky qe vetëm një sundim tiranik dhe një despotizëm i deklaruar me urgjencë; mesa gjykohet, **kjo qe një anarki për të shkaktuar revolucione**. *Po të mos ngrihej populli shqiptar në formën e quajtur rebelizëm, për shqiptarët nuk do të besohej mjaft dhe do të thuhej se këta nuk kanë idenë mbi lirinë që kërkojnë*. Kështu u ngrit "mbi vullkan" shteti i parë shqiptar, llogaritur te shpërbëhej pa mbushur gjashtë muaj. "Shqipja u ringjall mbas sa qindvjetash, tha Noli në Kongresin e Triestes në mars 1913, por ajo asht e shitueme". Edhe *Konica* në "*Kopështi shkëmbor i Evropës jug-lindore*" (f. 193) shkruan: "**Shqipëria u bë shtet, por u rrëgjua në një të katërtën e hapsirës tokësore natyrore që i përkiste**".

Nga kjo marrëveshje e Londrës doli një ngatërresë sa nuk bëhej më e madhe dhe më e keqe, thotë diplomati amerikan. Përfaqësuesit e Evropës janë përfaqësuesit e "decline paradigm" (paradigmës së rrënimit). Gjaku i derdhur i shqiptarëve e ka burimin në vendimet e fuqive të mëdha të Evropës dhe në patriotizmin dhe vrullin luftarak të popullit shqiptar si reaksion e pasojave të tyre. Le ta shohim në këtë mijëvjeçarin e ri se çdo të bëjë Amerika. Hillëri Klinton, ish ministre e Jashtme e SHBA-ve ka thënë se Amerika do të qëndrojë në Shqipëri aq kohë sa ka qendruar Turqia. Pyetje: A do ta çojë Amerika Shqipërinë në hapësirat gjeografike të Shqipërisë Etnike aty ku e mori Turqia në shek. XV dhe "e la" më 1913? A do t'i thoshte Ajo "prapsohu!" Vendimeve të Kongresit të Berlinit 1878-ë, të Konferencës fatale të Ambasadorëve të Londrës 1912-1913 e të Parisit 1921; dy Versajave dhe gjithë "Epokës" gjëmëmadhe të Enverit e t'ia kthejë ato të drejta elementare e të patjetërsueshme që i janë mohuar shqiptarëve, një popull rrënjës, *autochthonous,* e më i vjetri në Evropë? Shqiptarët shpresojnë shumë, shumë. Dum spiro, spero – Sa rroj, shpresoj.

Sipas shtypit të kohës *gjatë viteve 1912-1913 u vranë nga agresorët serbë 120.000 deri në* ***130.000*** *veta*. Vetëm në Shkodër e përreth saj pati 30.000 viktima nga serbët e malazezët. Po kështu edhe në zonën e pushtuar nga Greqia dhe Mali i Zi. Politika e shfarosjes së shqiptarëve nuk u ndërpre edhe pas vitit 1913[6].

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Dibra u bë shesh lufte nga më shumë se pesë shtete: ushtritë serbe, austro-hungareze, bullgare, italiane, franceze e serbo-jugosllave. "Fat" i rrallë në histori për një krahinë. A thua se aty (në Dibër) ishte çelësi i rrotullimit të globit për planet e luftës dhe të "paqes" për gjithë Ballkanin dhe botën.

Me nënshkrimin e Armëpushimit në nëntor 1918, Shqipëria nuk pushoi së qeni "në luftë". Ajo u nda në 4 zona pushtimi: italiane (Vlorë-Gjirokastër), zona franceze (Korçë), zona serbo-jugosllave e pushtimit me "Kufij strategjikë" e me "Vija demarkacioni" si dhe pushtimi ndëraleat i Shkodrës (angezë, francezë, italianë). Ato "Aleatë" me të cilët edhe shqiptarët ishin "aleatë", tani u bënë rivalë e armiq në truall shqiptar. Vallja e luftës do të hidhej mbi Shqipërinë e drobitur e të sakatuar. "Qaje Zot të keqen"! Ta qajnë e të mjerojnë shqiptarët, se Zoti është gjithmonë fitimtar.

Dekada e dytë e shekullit XX po mbyllej tepër e zymtë për Shqipërinë. Në vitin 1920 ajo hyri me problemin e pazgjidhur të statusit shtetëror dhe të kufijve të saj. Në Konferencën e Paqes në Paris, më 9 dhjetor 1919 memorandumin anglo-franko-amerikan, të cilit i bashkangjitet edhe një promemorje i njihte Italisë sovranitetin e plotë mbi Vlorën dhe krahinën e saj si dhe mandatin mbi shtetin shqiptar të gjymtuar. Kjo e bënte Shqipërinë "syri i ciklonit" në Ballkan. Për Shqipërinë 1920-–ta prodhoi tre luftëra: Luftën e Vlorës, atë të Koplikut (Shkodrës) dhe Luftën e Dibrës. Shqiptarët duhej të paguanin të tjera fatura gjaku. Dibranët, po e po, më të parët.

Episode ndeshjesh të shumta luftarake me intervencionistët ushtarakë serbo-jugosllavë dhe mercenarët e tyre shqiptarë. Forcat qeveritare kombëtare me Elez Isufin, Hakik Menën – bajraktarin e Lurës, Miftar Kaloshin, Brahim Gjoçin, Dik Xhelilin, kapiten Ali Riza Kosova - ushtaraku me përvojë e kualitet të lartë, komandant i Batalionit "Drini", formuar me vullnetarë dibranë; kapiten Preg Jakun me batalionin shetitës-një shqipe mali e besnik tek s'thuhet nga njëra anë dhe, nga ana tjetër forcat esatiste me prijësa: Halit Lleshi, Tafë Kaziu, Selim Noka për Dibrën dhe Mahmaut Rexhep Bulicën për Lumën. Një intervencion ushtarak serbo-jugosllav përzjerë me një "luftë civile" në Qafë Gëlqere 31 korrik 1921, në Lanë Lurë ku kishte shtabin Elez Isufi, në Grykë-Nokë e Kodër Leshe, në Muhurr etj dhe ajo finalja në Lanë Lurë më 26-28 tetor 1921. Artilieri Gani Dida nga Prizreni i kishte mahnitur armiqtë me saktësinë e tij goditëse sa që serbët akuzonin se në radhët e forcave shqiptare kishte oficerë italianë.[760]Ai kishte marrë pjesë në të gjitha aksionet e batalionit Drini të zhvilluara kundër sulmeve të

kujtesë

jugosllave **i hapën** rrugën shtetit **kombëtar shqiptar**

ushtrisë jugosllave që nga Dibra e Poshtme e deri tek Ura e Vezirit.

Duke e ndjerë se së afërmi Konferenca e Ambasadorëve do të jepte vendimet e saj për çështjen e kufijve të Shqipërisë si dhe duke shfrytëzuar apatinë e Lidhjes së Kombeve, qeveria e Pashiçit vendosi të ndërmerrte një agresion të ri në tokat e shtetit shqiptar për të ndikuar sa të ishte e mundur më shumë në marrjen e vendimeve në favor të Jugosllavisë. Këtë radhë vendosi të veprojë më tepër duke përdorur drejtpërdrejtë forcat e veta të ushtrisë së rregullt, pa neglizhuar edhe ato të Marka Gjonit e të forcave të tjera mercenare. Agresionin e filloi në gjysmën e dytë të shtatorit në Dibrën e Poshtme e në veri të Shkodrës.

Me 17 shtator komanda jugosllave i jep ultimatum komandantit shqiptar të kufirit në Arras (nëntoger Xhezmi Frashërit) që brënda 24 orësh të liroheshin nga forcat shqiptare fshatrat Muhurr, Arras, dy Sinat, Mustafe, Grykë Noka, Çidhna e Poshtme, Dardha dhe Mali i Lurës.[8] Qëllimi kryesor ishte lirimi i rrugëve që çonin në Mirditë dhe sigurimi i "Vijës strategjike". Forcat dibrane e vunë në dijeni qeverinë për këtë dhe shpreheshin se nuk do t'i lëshonin pa pushkë pozitat e tyre.

Ofensiva ushtarake jugosllave filloi në mëngjesin e 26 tetorit 1921 me një bombardim të gjatë kundër pozitave shqiptare, i cili u pasua nga sulmi i gjithanshëm i reparteve të rregullta dhe mercenare. Gjatë natës së 25-26 tetorit 1921 nga ana e Reçit në fshehtësi, 600 forca të tyre kaluan Drinin për t'u ngjitur herët në mëngjes drejt fshatit Bardhaj-Reç. Në mëngjesin e 26 tetorit, ditën e mërkurë, filloi bombardimi i vijës nga Sorica deri në Muhurr, pastaj u kalua në mësymje të përgjithshme në vijën gjatësore nga Reçi deri në Muhurr. Në fshatin Rreth-Kale, Tafë Kaziu kishte grumbulluar 1000 forca mercenare dhe serbe dhe nisi sulmin në drejtim të Muhurrit. Forcat jugosllave arritën të zënë Kodrën Leshe afër Arrasit dhe pushtuan fshatrat Muhurr, Bulaç, Vajmëdhej, Arras, Mustafe, Sinë e Epër dhe Sinë e Poshtme.[9]

Kur erdhi lajmi i rifillimit të ofensivës armike, gati 2000 malësorë të tjerë rrëmbyen armët dhe u vunë në dispozicion të komandës ushtarake shqiptare. Me gjithë epërsinë e madhe numerike, luftëtarët dibranë iu përg[10]jigjën me një qëndresë të fuqishme sulmit të forcave jugosllave e mercenare. Zjarrin e armëve të tyre e shoqëronin me thirrjet e fuqishme luftarake "A besa-besë, burra!" "me dorë, ti kapim, me dorë!", "aha, ha, ha!". Për dy ditë me radhë luftëtarët dibranë luftuan me heroizëm duke i gozhduar forcat jugosllave në vend e disa herë duke i nxjerrë matanë Drinit. Një ndeshje e ashpër u zhvillua në vendin e quajtur Guri i Shqipes ku iniciativën komanduese e mbante *Abdulla Cara*. Këtu serbët u thyen disa herë dhe lanë rreth 50-60 të vrarë. Duke përfituar nga epërsia numerike, me krahëmarrje, forcat armike thyen mbrojtjen e forcave vullnetare, pushtuan Zall - Reçin dhe Bardhaj-Reçin, dogjën disa shtëpi, shtrinë linjat telefonike dhe po bëheshin gati për t'u ngjitur drejt Lurës. Në përleshjen tek Guri i Shqipes ra heroikisht Abdulla (Dullë) Ibrahim Cara nga Bardhaj Reç dhe u plagos Ramadan M. Prençi.

Luftimet vazhduan me 26 dhe 27 tetor me përpjekjet e serbëve për të arritur kuotat dominuese me synimin drejt Lurës, por përparimi i tyre haste në qëndresën e fortë të forcave atdhetare, me sulme e kundërsulme. Rastet e heroizmit ishin në çdo hap por i veçantë ishte ai kur Sufë Xhelili me 27 vetë arriti të thyejë forcat serbe prej 400 vetësh në Fushë të Madhe të Dardhës dhe i detyroi ato të zbresin në Dri.

Ndërsa balli lindor i Lanë Lurës po mbrohej me heroizëm, forcat mercenare e serbe me Tafë Kaziun, pa shumë vështirësi kaluan në Muhurr dhe u ngjitën në Selishtë. Synimi i tyre ishte që t'i hapte rrugë ushtrisë serbe për në Mirditë. Duke tentuar të ktheheshin nga Pllaja fillimisht ata hasën në qëndresën e vendosur të popullit të Lukanit e të Katundit të Vjetër (Qafë Murra) të drejtuar nga Llan Destani (Ndregjoni). Në këtë përpjekje pati mjaft të vrarë e të plagosur nga forcat mercenare ndërsa nga forcat proqeveritare mbeti i vrarë Rustem Dervishi si dhe u plagosën Llan Destani, Ramadan Biba, Zenel Nika, Rrahman Dobra, etj.

Ato vazhduan përsëri sulmin në drejtim të Pllajës me qëllim që të dilnin me krahëmarrje në Lanë të Lurës, objektivi i vazhdueshëm i tyre. Por aty ndeshën në qëndresën e çidhnakëve dhe të forcave të tjera dibrane të drejtuara nga Murat Kaloshi dhe si përfundim mbetën të gozhduara e nuk mundën të depërtojnë drejt Lurës. Në këtë përleshje vetë Murati u plagos.

Forca serbo-mercenare të këtij krahu me ndihmën e Tafë Kaziut u ngjitën në Selishtë, pastaj kthyen poshtë e zunë Sharrën e Zogollit dhe Shkallën e Deshëve. Kështu luftëtarëve dibranë iu pre rruga e furnizimit me ushqim e municion nga Mati. Forcat e Lurës po futeshin në gjysmë rrethim. Armiku rrezikonte të pushtonte Lisin, qendrën e n/prefekturës së Matit. Ja si e raportonte gjendjen Ali Rizaj në një letër që i drejtonte Bajram Currit me 28 tetor: 1. Serbia po na bombardon me 21 topa. 2. Municion s`na mbeti aspak. 3. As Tirana as Lisi nuk po na japin as përgjigje. 4. Udha e Sharrës së Zogollit u mbyll. 6. Ne nuk po dijmë se kah me ja mbajtë.[10]

Më *28 tetor 1921*, ditën e premte, forcat serbe dhe mercenare bënë një mobilizim, u ngjitën në shtigjet dhe kreshtat malore të Lanë Lurës dhe u hodhën në një sulm të përgjithshëm. Kjo ishte dita e tretë e betejës, më heroikja: beteja e Lanë Lurës.

Forcat atdhetare kishin zënë pikat kyçe ku mund të tentonte për të kaluar armiku që nga Lana, Suka e Dardhës, Kaprat e Reçit, etj. Ahmet Lekës, Rremë Lushës dhe Can Lalës me shokë u ishte besuar shtegu më i rrezikshëm. Ahmeti 57 vjeçar nga fshati Ndërshenas i Reçit, që kishte marrë pjesë edhe në Luftën e Kolesianit më 1912 dhe në luftëra të tjera, e kishte zakon ta priste armikun në tabe të parë, duke qendruar në këmbë, ballë pë ballë. Në krah qëndronte bashkëfshatari i tij Rremë Lusha. Në ahishten e shpeshtë, nën dritën e hënës fekste shkëlqimi i bajonetave të ushtarëve serbë që po afroheshin drejt tabes së tyre. Ahmeti përveshi këmishën e gjërë, rrasi kësulën në kokë me të dy duart, u kreshpërua dhe lëshoi britmën e zakonshme "A besa besë burra, t`i kapim me dorë!". Për ta populli ngriti këngën: "Ahmet Leka e Rremë Lusha, / Po luftojnë si dy arusha./ Ai Can Lala trim me fletë, / Vdekun len, sa herë po qet".[11]

Forcat dibrane kundërsulmuan në mënyrë të shpejtë e të rrufeshme. Me britmat e tyre të zakonshme luftarake, duke mos i lënë kohë armikut t`i sulmonte dhe të zinte pozicionet, e detyroi atë të tërhiqej në rrëmujë dhe të kalojë në anën lindore të Drinit. Kjo përbënte një fitore të madhe për Dibrën dhe mbarë Shqipërinë. Beteja e Lanë Lurës pati pasoja të rëndësishme. Me të u dogj karta e fundit e ushtrisë së Beogradit.

Në Betejën e Lanë Lurës shkëlqeu në veçanti një heroizëm i rrallë popullor, nga njerëz të thjeshtë por edhe nga oficerë si nëntoger Abdulla Tirana, aspirant Mynir Dibra i këmbësorisë dhe aspirant Gani Dida i artilerisë. Pa dyshim që rolin më të madh këtu e kishte vetë Elez Isufi, që ishte shpirti dhe krahu i forcave atdhetare, si dhe veprimet taktike të studiuara e zbatuara me mjeshtrinë e artit ushtarak të komandantit të batalionit "Drini", Ali Riza Kosovës. Megjithatë, gjendja e forcave atdhetare ishte shumë e rëndë.

Me 29, 30, 31 tetor dhe 1 nëntor, forcat atdhetare qëndruan në Nezhdë të Lurës ose Majën e Kunorës. Këtu në lartësitë e maleve bora kishte mbuluar tokën dhe kishte filluar një të ftohtë shumë i madh. Kushtet ishin jashtëzakonisht të vështira. Armiku i kishte ndërprerë lidhjet me Matin. Prandaj fuqia e Lurës, i shkruan Elez Isufi deputetit Kristo Dako, u detyrua të zbrapset, jo se u demoralizua por "nga mungesa e municionit, të armëve e të topave...Ushtarët ishin të zhveshun e të zbathun, pa kapota, pa këpucë, pa çadra, pa velenxa, pa çorape, pa spata, pa kazma e pa lopata, e u shtërnguem me 2. XI. 1921 me ra në Lamë të Kolecit (Selitë)" ose Lami i Madh.[12] Që nga Lama e Kolecit Elezi i shkruan letrën e mirënjohur deputetit Kristo Dako me 13 nëntor.

Aty nga 2 nëntori Kurt Agë Kadiu me forcat e tij liroi Shkallën e Deshëve (Deja e Macukullit) dhe u tërhoq pa rezistencë. Armiku ra në Macukull. Në ndihmë të forcave qeveritare, drejt Macukullit u nisën forca të tjera të vullnetarëve matjanë. N/prefekti i Matit njoftonte ministrinë e Brendshme se "Sulë Kurti me parinë e Prellës me 100 vullnetarë u bashkuan me fuqinë qeveritare në Macukull. Ashtu edhe Dule Bej Buzhiqi me 40 vetë u nis për në front te Dine Hoxha". Forcat armike vazhdojnë të bombardojnë me top Macukullin dhe Butrojn.[13]

LËVIZJA SEPARATISTE E MIRDITËS DHE ASGJËSIMI I NDËRHYRJES JUGOSLLAVE

Ndërsa në Lurë bëhej përleshje me armikun i cili tentonte të depërtonte në thellësi, në Tiranë kishte plasur lufta për pushtet. Pas zgjedhjeve për Këshillin Kombëtar në pranverë, në parlamentin që doli u krijuan dy grupe kryesore politike: grupi "Popullor" dhe grupi "Përparimtar" si dhe një grup më i vogël që quheshin "Indipendentë". Grupi "Përparimtar" që nuk fitoi shumicën në zgjedhje dhe nuk mund të krijonte qeveri, nuk u mjaftua që në korrik i bënë vend në një qeveri koalicioni të pamerituar, me qëllim që të ulnin tensionet politike, por iu vunë punës që ta merrnin pushtetin me puç, me rrugë jashtë parlamentit.

Për të përballuar gjoja më mirë ndërhyrjen e huaj dhe "çështjen e Mirditës" propozuan bashkimin e grupeve parlamentare në një organizëm të quajtur "Bashkimi i Shenjtë" i cili u bë me 12 tetor. Hasan Prishtina, Mustafa Kruja, Luigj Gurakuqi llogarisnin të rrëzonin qeverinë dhe të krijonin një qeveri të re me Mustafa Krujën dhe Luigj Gurakuqin. "Bashkimi i Shenjtë", një organ antikushtetues, krijoi një komision prej tre vetësh: Bajram Curri, Qazim Koculi dhe Avni Rustemi, i cili do të propozonte qeverinë. Nga ky komision arbitrazhi dhe jo nga parlamenti doli qeveria e Pandeli Evangjelit e cila erdhi në fuqi me 19 tetor 1921.

Tre komandantë në operacionet e ndërmarra nga qeveria për të shtruar Mirditën kishin dështuar njëri pas tjetrit. Më 4 nëntor 1921 qeveria shpalli Ahmet Zogun komandant të operacioneve ushtarake në frontin Lindor të trupave të rregullta e të parregullta (vullnetare) shqiptare kundër ushtrisë jugosllave e atyre të Marka Gjonit. Po me 4 nëntor emëroi Bajram Currin komandant të forcave të rregullta ushtarake dhe të atyre të zonës Pukë-Zadrimë, d.m.th. komandant të frontit Perëndimor. Një ditë më vonë, më 5 nëntor 1921, qeveria emëroi Elez Isufin kryekomandant të trupave të parregullta të Lurës dhe Ahmet Zogun komandant të fuqive të parregullta të Matit. Këto ishin pjesë e intrigave të "Grupit të Shenjtë" për të larguar Zogun nga Tirana, me shpresë që të hante kokën atje në Mirditë, që ata të kishin më shumë liri veprimi në kryeqytet për marrjen e pushtetit me grusht shteti.

Në krye të një fuqie prej 100 xhandarësh dhe afro 1000 dibranësh e matjanësh Ahmet Zogu arriti në Orosh si komandant operacioni dhe komandant të ushtrisë major Meleq Frashërin. Me arritjen e Zogut situata u përmbys. Zogu hyri në kontakt me kryengritësit e me bajraktarin e Oroshit, Prengë Marka Prenga, me të cilin bisedoi shtruar e miqësisht, grumbulloi ushtrinë e shpërndarë sa andej këndej dhe thirri në raport komandantët e kolonave.

Në një raport të ministrisë së Luftës drejtuar kryeministrisë mbi gjendjen e sotme të kufirit me 14.11.1921 thuhej: "Serbët me fuqi të rregullta ndodhen në Qafë Bulqizë (Buall), Qafë Murrë e në Lanë të Lurës...Në Lumë e në viset e Dibrës, brenda kufinit të 1913-ës kanë çue krahinarë e kanë formuar një gjindarmëri të vendit. Në Arras, Dardhë e në Reç ju kanë marrë bagëtinë (5.600 kokë) e anëtarëve të qeverisë shqiptare u kanë rrëzue çatitë e shtëpive e tjegullat jua kanë hedhë në Dri. Këto shtëpi bahen ma shumë se 100. Disa ushtarë serbë të vrarë në luftimet e fundit në Lurë, qeveria serbe nuk i ka varros, por i ka fut në një shtëpi dhe i ruan me roje. Shkaku i kësaj nuk dihet...".[114]

Elez Isufi nga Lama e Kolecit njoftonte kryeministrinë me datë 18.11.1921 se "Serbia në Reç e në Dardhë ka pru 1000 (njëmijë) vetë e civila prej Kosove të cilëve u ka dhanë vetëm nga nji kapot. Xhandarë e civila të Lumës që shërbejnë për interes të Serbisë me 17.11.1921 kanë pasë një të pjekun (takim) tek Ura e Kukësit me Gjon Marka Gjonin për t`u bashkue me Mirditë e me vu në veprim qëllimet e Marka Gjonit duke përdorë fuqinë e tyne kundër nesh e major Rexhep Shalës e Bajram Currit. Me gjasë duket se edhe fuqinë civile që ka pru në Reç e Dardhë ka për t`i shti në Mirditë me i ndihmue".[15]

Duke mos patur përkrahjen e drejtpërdrejtë të forcave të armatosura jugosllave dhe për shkak të pakësimit të ndihmave materiale e në të holla, armë e municione, Marka Gjoni e Zef Ndoci parashikuan dështimin e tyre. Prandaj me 12 nëntor ata kërkuan takim me një përfaqësues të qeverisë. Qeveria autorizoi Elez Isufin. Takimi u bë me 16 nëntor në Kullën e Mardhoçit, në Selitë. Në bisedime, krerët e Mirditës propozuan që "Dibra, Luma, e Mirdita" të shkëputeshin e të formonin një qeveri të vetme. Meqenëse shumicën e popullsisë e përbënin myslimanët, Marka Gjoni propozonte të merrej një princ nga familja e sulltanëve të Turqisë. "Unë, relatonte Elez Isufi, u bana të ditun se nuk u takova me ta për të zgjedhë princ a mbret, por pata shpresë se po bashkoheshim për të shpëtue Shqipninë... Kryetarët e Mirditës, vinte në dukje ai, dëshirojnë prishjen e Shqipnisë dhe jo lirinë, indipendencën e vetqeverimin e kombit shqiptar". Meqenëse populli i Mirditës,- konstatonte Elez Isufi- nuk ishte në këtë besë tradhëtare të krerëve, për realizimin e qëllimit ata kishin futur ushtrinë serbe deri në Lurë dhe kërcënonin se " në rast se qeveria e Tiranës nuk i lironte të 12 bajraqet, ata do të përpiqeshin të futnin ushtrinë serbe më brenda territorit shqiptar, deri sa të arrihej synimi i tyre".[16]Takimi nuk dha asnjë rezultat.

Të nesërmen me 17 nëntor 1921 Zogu i paraqiti qeverisë dhe ministrisë së Luftës propozimin për marrëveshje me krerët e Mirditës: 1. Faljen e përgjithshme. 2. Qeveria t`u falte misër. 3. Marrja e vergjisë dhe e ushtarëve nga krahina e Mirditës të shtyhej për më vonë. 4. Nomi i xhibalit të vazhdonte në Mirditë aq kohë sa do të vazhdonte edhe në malësitë e tjera.

Kabineti i aprovoi propozimet e Zogut, kurse Regjenca i kundërshtoi. Madje edhe mësymjen kundra Marka Gjonit nuk desh që ta bënte Zogu por Elez Isufi, kurse ky i fundit (Zogu), urdhëronte Regjenca, duhej t`i shpërndante edhe forcat vullnetare të mbledhura në zonat e ndikimit të tij. Konfuzionin që kishte krijuar në Tiranë, Këshilli i Naltë (Regjenca) po e përcillte edhe në bazë.

Pas kësaj Zogu lajmëroi se operacioni mori fund, duke vendosur në këtë mënyrë rendin dhe qetësinë pa derdhur një pikë gjak. Komanda e operacionit shpalli faljen e përgjithshme pa kushte. Kush nuk paraqitej në komandë brenda një jave "pas shpalljes së faljes, do të ndiqej me rreptësi, shtëpia do t`i digjej dhe malli do t`i konfiskohej".[17] Të nesërmen paria e Mirditës me gjithë armët e tyre vinin në komandën e operacionit dhe nënshkruanin bindjen ndaj qeverisë.

Orvajtjet e qeverisë jugosllave për ta ndryshuar vendimin e Konferencës së Ambasadorëve dështuan. E cilësuar si agresore ndaj Shqipërisë, Jugosllavia u detyrua më në fund t'i largonte ushtritë e saj nga territoret e pushtuara. Më **9 nëntor, Konferenca e Ambasadorëve** i hodhi poshtë pretendimet jugosllave për "vijën strategjike". Ajo mori vendim për miratimin e kufijve të 1913-ës, por me "rektifikime" në krahinën e Lumës, Hasit dhe të Dibrës në zonën e Gollobordës. Po me 9 nëntor qeveria angleze njoftoi se njeh zyrtarisht qeverinë shqiptare. Beogradi e kuptoi seriozitetin e qëndrimit të Konferencës së Ambasadorëve dhe të Këshillit të Lidhjes prandaj filloi të tërhiqte trupat nga Shqipëria. Megjithatë ajo i vazhdoi edhe më tej provokacionet për të shkaktuar sa më shumë trazira në Shqipëri përpara se të vinte në kufi komisioni ndërkombëtar i caktuar për të vëzhguar zbatimin e vendimit të Lidhjes së Kombeve dhe para se të mbaronte afati i tërheqjes së ushtrisë jugosllave nga Shqipëria.

Për kufijtë verilindorë vendosi të bënte ndryshime përsëri në dobi të shtetit SKS (Jugosllavisë), duke i dhënë kësaj të fundit *një pjesë të krahinës së Lumës, Hasit dhe Gollobordës*, me një popullsi shqiptare prej disa mijëra frymësh: Dibrës i hoqën edhë fshatrat: Hotishan, Zepisht, Drenok dhe Modriç.

Vendimi tjetër cënonte pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit shqiptar. *Italisë i njihej një pozitë e veçantë në Shqipëri*. Në këtë mënyrë u zgjidh përfundimisht çështja e sovranitetit të Shqipërisë.

Më **10 dhjetor 1921** nga territori i Dibrës dhe i gjithë Shqipërisë politike u larguan ushtarët e fundit të Jugosllavisë. Atë ditë flamuri kombëtar u ngrit në pikën kufitare të Bllatës. Kështu, pas 9 vjet e disa ditë nga shpallja e Pavarësisë kombëtare të mbushur me luftëra të ashpëra e të pandërprera, pjesa më e madhe e trevës dibrane më në fund u lirua nga pushtuesit serbo-jugosllavë për t`u bashkuar me gjysëm-shtetin e pavarur shqiptar.

(vijon në faqen 17)

Beteja e Lanë-Lurës shënoi fitoren historike të dibranëve në luftë me serbët dhe me këtë luftë u farkëtua liria dhe pavarësia shqiptare.

Nga **GËZIM LOKA**

Beteja e Lanë Lurës, epopeja e madhe e qëndresës

Në arealin e luftërave të njëpasnjëshme dhe qëndresës së pathyeshme luriane kundër pushtimeve dhe tiranisë së të huajve, Beteja e Lanë Lurës e vitit 1920 është një faqe e ndritur historie, që do të bëjë krenare në jetë të jetëve jo vetëm Lurën e lurianët, jo vetëm Dibrën e dibranët, por gjithë shqiptarinë.

Në këtë betejë madhore shkëlqeu edhe një herë shpirti qëndrestar lurianë, guximi, trimëria, besa e burrëria luriane, virtytet më të mira të një krahine, ku kanë kaluar mbretër e perandorë, princa e gjeneralë, shkrimtarë e diplomatë të shquar, të cilët ia kanë ngritur zërin dhe lavdinë Lurës sonë. Ajo shënon përplasjen e madhe të skalioneve të barabarisë serbo-jugosllave me patriotët dibranë e shqiptarë, të cilët të braktisur nga qeveria e kohës, për shkak të frikës së ndonjë konflikti civil, që mund të sillte pasoja për të, u vetëudhëhoqën në një luftë titanike, duke vënë në krye strategë e gjeneralë madhorë si Elez Isufi, që kanë hyrë në analet e ndritur të historisë së kombit dhe janë ajka e krenarisë dibrane e shqiptare.

Beteja e Lanë-Lurës, (kulmoi më 28 tetor 1921) ka hyrë në histori si beteja e një populli të etur për liri, që mbyti serbo-jugosllavët në Drin, betejë që bëri jehonë të madhe në të gjithë botën dhe solli pavarësinë përfundimtare të Shqipërisë. Për nder të kësaj lufte emblematike, mendoj se duhet të ngrihet një memorial madhështor, përkushtues dhe me një fushëpamje të gjerë, që të bëjë me dije çdo vizitor vendas apo të huaj zhvillimin e kësaj beteje, me të cilën do të krenohen në jetë të jetëve lurianët dhe dibranët.

Historia e kësaj beteje, në kufijtë e legjendës, nuk është e shkëputur nga gjithë areali i rezistencës dibrane e gjithëshqiptare ndaj agresorit tinëzar e mizor serbo-sllav.

Në ndërkohën nëntëvjeçare, 1912 – 28 tetor 1921, hark i cili nis me betejën dhe fitoren epokale të Kolesjanit dhe përfundon me betejën e Lanë- Lurës, është një baticë e egër qëndrese të shqiptarëve kundër Serbisë e synimeve shoviniste serbo-jugosllave, ku Dibra, dhe Luma kanë një peshë të madhe, unike. Në këtë kohë, u ngrit dhe u dallgëzua një furi madhore e qëndresës popullore, në mbrojtje të tërësisë kombëtare, të trojeve të lashta të këtij vendi, që nuk njohu kurrë një ditë të vetme qetësi e paqe.

Beteja e Lanë Lurës është një ftesë e hapur për historianët, shkrimtarët, gazetarët, që të hulumtojnë e të shkruajnë të vërtetat e saj, ende të mbuluara me pluhurin e harresës dhe mosvëmendjen e merituar, që në të vërtetë duhet të ketë një ngjarje kaq e madhe historike, që është krenari e dinjitet për gjithë popullin shqiptar…

Beteja e Lanë Lurës shënoi aktin kulmor të ndeshjes epokale midis atdhetarëve luftëtarë që mbronin lirinë dhe pavarësinë e vendit të shqipeve dhe serbo-sllavëve që kërkonin me çdo kusht aneksim e pushtim të Shqipërisë.

Udhëheqësi popullor Elez Isufi kishte lëvizur në trajektoren Dibër-Lumë dhe tre ditë para nisjes së betejës pati udhëtuar nga Reçi në Lurë, shoqëruar me bashkëluftëtarët e tij besnikë. Në Lurë, ku bujti disa netë, u mbështet masivisht nga burrat trima lurianë, që u ngritën në këmbë dhe iu bashkëngjitën kryeluftëtarit.

Në gjithë ditët e betejës, në mes të zhegut përvëlues, gratë dhe vajzat luriane poqën bukët në çerep dhe furnizuan me bukë e ushqime Elez Isufin dhe trimat e tij, që në llogore të luftës po luftonin fyt a fyt, për vdekje a liri, me armikun shekullor të shqiptarëve, ushtrinë serbe.

Prijësi legjendar, Elez Isufi qëndroi në krye, duke udhëhequr me largpamësi e gjenialitet këtë furtunë qëndrestare, që u ngrit me furinë e Nëntë Maleve dhe Lurës, malit më vete, mbi bishën gjakatare serbo-sllave.

Shumë është folur dhe me të drejtë për Luftën e Vlorës, por shumë pak për betejën e Lanë Lurës, e cila është thuajse e njëkohshme me të parën. Është detyrë e historianëve që Luftën e Lanë Lurës, këtë betejë me të vërtetë të lavdishme në historinë e Shqipërisë së re, ta studiojnë dhe ta ngrenë në piedestalin që i takon.

Dibranët dhe lumianët e kurdo herë me ta dhe lurianët trima e sypatrmebur e kanë shkruar me gjak e sakrifica historinë e tyre të vjetër e të re, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar në historinë e vërtetë të Shqipërisë, e cila pa u shkruar siç është historia e këtyre krahinave qëndrestare, nuk do të jetë kurrë një histori e plotë dhe e bazuar në të vërtetat historike.

Duhet thënë se beteja e Lanë-Lurës shënoi fitoren historike të dibranëve në luftë me serbët dhe me këtë luftë u farkëtua liria dhe pavarësia shqiptare, të kërcënuara seriozisht nga qeveria e Beogradit, që nuk arriti ta luante kartën e fundit për aneksimin e një pjese të territoreve shqiptare, për shkak të thyerjes që i bënë dibranët në "shtatë e shtatëdhjetë" në betejën e Lanë Lurës, duke bërë që ushtria barbare të tërhiqej në panik e të mbytej në ujërat e Drinit të Zi.

Forcat militare serbe, nga paniku i humbjes së madhe, nuk i përsëritën më operacionet e tyre dhe kësisoj fitorja ushtarake e dibranëve solli edhe fitoren politike, në arenën ndërkombëtare, që u vetëdijësua për luftën e drejtë të bijve të shqipes. Kështu, më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve e etiketoi Jugosllavinë si agresore dhe hodhi poshtë pretendimet e saj për të ashtuquajturën "vijë strategjike", mbi të cilën bazoheshin pretendimet e saj absurde territoriale.

Por tentativat provokuese të skalioneve serbo-sllave vazhduan, në mënyra nga më të stërholluarat, për të dështuar në të gjitha rastet me turp dhe duke bërë që historia t'i dënojë si agresorë dhe të pabesë.

Beteja e Lanë – Lurës përbën arealin, palcën dhe karakollin rreth të cilëve u ngrit dhe qëndroi e pathyeshme kështjella e qëndresë dibrane në verën dhe vjeshtën e vitit 1921.

Përmasat e kësaj qëndrese të pashembullt nisnin nga Muhurri në Reç, gjatë tërë gjatësisë së Drinit të Zi (në lindje), nga Qafë-Murra në Qafë-Mërkurth e në Qafë-Drajë (në perëndim e në veri).

Në këtë betejë të pashoqe, me përmasa gjithëpopullore, shkëlqeu herozimi dibran dhe lurian, u farkëtua uniteti i madh i popullit të këtyre anëve me tribunët e lirisë dhe u pagëzua me gjak e sakrifica sublime vetëdija e lirisë dhe pavarësisë së trojeve etnike të popullit shqiptar.

Valët e kësaj beteje unike vazhduan disa muaj, duke kulmuar më 26-27 e 28 tetor 1921, ditë që përbëjnë një ngritje madhore të kurbës së kësaj lufte titanike, ku Dibra dhe Lura u bënë karakolle të pathyeshme qëndrese e shprese për shqiptarinë.

Në Lanë të Lurës, në këtë vend strategjik, u nisën për udhë drejt pavdekësisë vargjet epistolare, shkrirë mbi mbi telat e çiftelisë, i quajturi "Marshi i Djelmënisë Dibrane", që do të bëhej himn i shoqërisë "Djelminia Dibrane" dhe "Bashkimi Dibran".

Ja çfarë thuhet ndër të tjera në atë:

Drin, e Lum i gjanë, Plaku i malësisë, / A ke me ja lanë Dibrën Serbisë? /Kurrë nuk durohet kjo robëni, / Dibra e Mosiut asht Shqipëni... / Çohu burra, çohu, /Gjithë me besa besë / Për Dibrën luftoni /Me të madhe shpresë. / Lurë, o vend i nalt, vend i trimërisë / Aty u banë fjalët, besa e lirisë...

Dibra do të jetë ndër breza krenare për këtë betejë, por ende më krenare do të jetë Lura, që priti Elez Isufin dhe trimat e lirisë, radhët e të cilëve i mbushi me djemtë e saj më të mirë, që luftuan fyt me fyt e me besa a besë, të pathyeshëm kundër ushtrisë së Krajlit serb.

Beteja e Lanë Lurës është një ftesë e hapur për historianët, shkrimtarët, gazetarët, që të hulumtojnë e të shkruajnë të vërtetat e saj, ende të mbuluara me pluhurin e harresës dhe mosvëmendjen e merituar, që në të vërtetë duhet të ketë një ngjarje kaq e madhe historike, që është krenari e dinjitet për gjithë popullin shqiptar…

Luftërat e Dibrës kundër ndërhyrjes ushtarake jugosllave i hapën rrugën shtetit kombëtar shqiptar

(vijon nga faqja 17)

GRUSHT-SHTETI I DHJETORIT 1921

Në Tiranë puçist kishin shkuar përpara në projektet e tyre. Artizanët e "Grupit të Shenjtë" vendosën të shpërndajnë parlamentin dhe të përmbysin qeverinë që vetë i dhanë votbesimin për të vendosur tërësisht pushtetin e tyre. Me 4 nëntor thërrasin parlamentin duke thënë se qeveria do të bënte një ekspoze mbi situatën e jashtme të Shqipërisë. Për çudinë e deputetëve, në vend të ekspozesë u lexua dekreti i Këshillit të Naltë për shpërndarjen e parlamentit me motivacionin se qeveria ka nevojë për liri veprimi, për t`i bërë ballë situatës së rrezikshme të krijuar gjatë kufirit jugosllav. Pastaj me forca ushtarake rrethojnë kryeministrin Pandeli Evangjeli në Hotel Internacional dhe e detyrojnë të japë dorëheqjen duke e kërcënuar në natën e 6 dhjetorit. Si anëtar i Këshillit të Naltë, Aqif Pashë Elbasani caktoi *Qazim Koculin* kryeministër. Ky pranoi me kusht që në qeveri të mos bëte pjesë Hasan Prishtina, por nuk mundi të qëndrojë as 4 orë në atë detyrë, prandaj u detyrua të japë dorëheqjen. Ministrat, deputetët, funksionarë, oficerë e shumë patriotë, bashkë me kompaninë e kapiten Osman Gazepit dhe me 150 xhandarë të destinuar për vijën e demarkacionit nën komandën e major Ibrahim Jakovës, nga pasiguria u nisën pasdreke nga Tirana për në Elbasan. Para nisjes, me korrier special lajmërojnë Zogun mbi ngjarjet në Tiranë. Dy anëtarët e Këshillit të Naltë, Aqif Pasha dhe Imzot Bumçi ngarkuan **Hasan Prishtinën** për formimin e kabinetit, por situata u tensionua edhe më shumë, prandaj edhe ky nuk mundi të qëndrojë në krye të qeverisë veçse 4-5 ditë.

Lajmi i grushtit të shtetit dhe formimi i kabinetit të ri u prit me protesta të fuqishme në kryeqytet. Shefat e zyrave dhe gjithë nëpunësit lanë zyrat dhe organizuan demonstrata në të cilat mori pjesë populli i kryeqytetit duke kënduar këngë kombëtare dhe duke thirrur "Poshtë agjentët e Italisë!". Qeveria u detyrua të japë dorëheqjen me 12 dhjetor. Dy anëtarët e Këshillit të Naltë ngarkuan **Idhomene Kosturin** të krijonte një kabinet "teknik" me sekretarët e përgjithshëm dhe drejtorët e ministrive.

Lajmin se "Bashkimi i Shenjtë" kishte bërë grusht shteti dhe kërkesën për kthimin e forcave në Tiranë për stabilizimin e situatës, Zogu e mori në Mirditë ditën kur operacioni kishte marrë fund. Me forcat e rregullta ushtarake dhe me vullnetarë dibranë, matjanë e mirditorë (që i dha me vete Prengë Marka Prenga) Zogu hyri në Tiranë me 14 dhjetor 1921 me oficerët trima e patriotë të devotshëm Preng Jaku e Meleq Frashëri. Me 16 dhjetor u kthyen nga Elbasani në Tiranë deputetët dhe gjithë të larguarit të cilëve iu bë një pritje madhështore. Me 22 dhjetor u mblodh parlamenti i cili diskutoi mbi deputetët e Drinit dhe duke marrë parasysh se në viset e prefekturës së Drinit që u liruan nga pushtuesit jugosllavë nuk ishin bërë zgjedhje parlamentare të rregullta, vendosi t`i rrëzojë ata nga deputetësia. Pasi dëgjoi raportimin e Pandeli Evangjelit për grushtin e shtetit, ai vendosi rrëzimin e Aqif Pashë Elbasanit dhe Imzot Bumçit nga Këshilli i Naltë mbasi kishin qenë në krye të komplotit dhe zevendësimin e tyre me Omer Pashë Vrionin dhe Ndoc Pistullin.

Tiranë, 12. 09. 2021

REFERENCA

1 Hanotaux, Parathënie, Gabriel Louis-Yaray, Shqipëria e panjohur, Në mbretërinë e shqiptarëve, Tiranë: Dituria, 2007, f. 11. "Sot Shkodra dhe Janina janë të rrethuara, çështja shqiptare është shtruar për zgjidhje para Evropës nga ultimatumi i rrufeshëm i ngjarjeve" (f. 11).
2 Italo Sullioti,
3 Hasan Kaleshi, "Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame", International Islamic Publishing House, 1992-1412, f. 12.
4 Oficerat hollandezë që erdhën në Durrës.
5 Ndër të gjithë delegacionet e Parisë Shqiptare që shkuan ta përurojnë Pricin Vilhelm kur Ai erdhi në Durrës, kryeqytetin e Shqipërisë së pavarur, vetëm Ahmet Bej Zogu i kërkoi të sanksiononte Princërinë e tij me mbledhjen e një asambleje kushtetuese. E dinte vetë këtë të drejtë kushtetuese ky djalosh 19 vjeçar, apo ja mësoi dikush, kjo tregon formimin e tij politik dhe juridiko-kushtetues, e... siç del nga zhvilimet e mëvonëshme politike, del se ai qe i "nominuar" ta bënte shtetin e parë kombëtar dhe ligjor shqiptar mbi baza kushtetuese..
6 Th. Murzaku, "Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftës Ballkanike 1912-1913", Tiranë, 1987, f. 339.
7 AQSH, fondi 251, viti 1921, dok. 51, f. 233.
8 AQSH, fondi 251, viti 1921, dosja nr. (50), 51, f.222; AQSH, Letër e Elez Isufit, Kristo Dakos; "Shqipëria e re", viti III, Nr. 051, Konstancë, 6 tetor 1921.
9 AQSH, fondi, 251, viti 1921, dosja 51, f. 345; AQSH, Letër e Elez Isufit, Kristo Dakos.
10 AQSH, fondi Bajram Curri, viti 1921, dosja 8/3-320.
11 Xhemal Laçi, "Ahmet Leka e Rrem Lusha, po lutojnë si dy arusha", gazeta "Ushtima e maleve", 16 tetor 1982.
12 AQSH, Letër e Elez Isufit dërguar deputetit të Dibrës Kristo Dako, përfshirë edhe në "Kujtime..." të I. Strazimirit.
13 AQSH, F. 251, dosja nr. 51, faqe 359, viti 1921. Mat-Lis , 5.XI.1921, nr. 2619.
14 AQSH, fondi 249, dosja I-338, f. 5, viti 1921. Kur thotë: anëtarëve të qeverisë u ka rrëzue çatitë...njoftimi ka parasysh ata familje që kishin njerëzit e tyre në Batalionin e Drinit apo me vullnetarët që shkonin me forcat qeveritare.
15 AQSH, fondi 251, viti 1921, nr. 8/f.
16 AQSH, fondi i Kryeministrisë, dosja I-240, dok. pa emër, datë 16.11 1921.
17 AQSH, fondi i Kryeministrisë, dosja I-238, dik. 880, datë 15.11.1921; shih edhe H. Kordha, "Lëvizja demokratike në Shqipëri në vitet 1921-1922", disertacion, f. 189-190.

Vendimet e drejta e të paanshme të Vesel Murrës merren si precedente dhe shërbejnë si aksioma për zgjidhjen e konflikteve të sotme, kur palët nuk duan t'i drejtohen gjykatës.

Vesel Murrja **"Plaku"** me famë **i Dibrës**

Nga **ARIF MURRJA & XHELADIN MURRJA**

1. HYRJE

Jeta dhe veprimtaria e Vesel Murrës është pjesa e gjashtë e studimit "Kronologjia, e fisit Murrja në Luzni të Dibrës". Vesel Murrja lindi më 1884 dhe vdiq në shkurt të vitit 1961. Jetoi 77 vjet në fshatin Selane (Figura 1.1). Kastragjyshi i Veselit ishte Halil Murrja, pinjolli i parë i fisit Murrja, në fshatin Hotesh që mori të drejtën e Parisë/Kreut të Malit/Krahinës të/së Luznisë. Stërgjyshi i Veselit ishte atdhetari Elez Murrja, përfaqësuesi i krahinës së Luznisë në qeverisjen e Dibrës në shekullin XIX-të (Kreun e Malit e trashëgoi nga i ati, Halili). Elez Murrja është dekoruar nga Komuna Luzni, ndërkohë shumë kohë më përpara është dekoruar nga Kuvendi Popullor "Për merita patriotike, në luftë kundra pushtuesve Osman". Gjyshi i Veselit ishte Isuf Murrja, i cili ndoqi rrugën e të atit dhe nuk kurseu as jetën kundra pushtuesve Osman. Isuf Murrja është dekoruar nga Kuvendi Popullor me 4 qershor 1966. Dekoratën e mori Jahje Abdulla Murrja, nipi i Isuf Murrës. Babai i Veselit ishte Miftari, djali i katërt i Isufit. Miftar Murrja është vrarë nga serbët në vitin 1913. Vëllai i madh i Veselit ishte Xhetani, i cili është vrarë ngaserbët në vitin 1918.

1.1 -Vrasja e Miftar Murrës (Babai i Veselit)

Në shtator të vitit 1913 tek ura e Mehmetit në Ravna të fshatit Grevë një togë serbe e kapi në befasi të pa armatosur Miftarin dhe Qazim Zebin, nipi i tij. Pasi i kishin identifikuar, Qazimit i kishin thënë: Ti mund të ikësh. Ai nuk pranoi duke iu përgjigjur se, o do të ikte bashkë me dajën, o na vrisni të dyve. Atëherë serbët i ekzekutuan të dy nip e dajë.

1.2 -Vrasja e Xhetan Murrës (Vëllai i Veselit)

Pas pesë vitesh nga shtatori 1913, në tetor të vitit 1918 një grup ushtarak shëtitës serb kapi Xhetanin në arën e tij duke vjelur misër dhe e ekzekutuan. Një muaj pas vrasjes së Xhetanit, vëllai i Qazim Zebit, Vahidi së bashku me Beqir Selishtën, nipi i Vahidit në vendin e quajtur Kroi i Jasharit në jug të fshatit Pjekë i organizuan një pritë policit të postës maqedonase Dhimitër Çaushit, duke vrarë në vend, si hamarrje ndaj vrasjeve të Miftarit dhe Xhetanit.

2. KUSH ISHTE VESEL MURRJA

Vesel Murrja vinte nga një trung familjar me vlera patriotike nga më të shkëlqyerat në Dibër (Figura 2.1). Kastragjyshi i Veselit ishte Halil Murrja, pinjolli i parë i fisit Murrja në fshatin Hotesh, i cili mori mihirin/mihajrin (vulën e Parisë së Malit të Luznisë) nga fisi i Sefere në Luzni. Stërgjyshi i tij, Elezi ishte atdhetari më i madh i kohërave në mbrojtjen e Luznisë dhe Dibrës nga perandoria Osmane. Gjyshi ishte dëshmori Isuf Murrja, i vrarë nga turqit më 1881. Babai i tij ishte Miftar Murrja i vrarë nga serbët më 1913 dhe vëllai i madh Xhetani i vrarë po nga serbët më 1918. Veseli la dy djem Shefqetin dhe Musain.

Ai vinte nga një familje e mesme fshatare, banonte në një shtëpi dykatëshe me 8 dhoma. Shtëpia ishte ndërtuar nga gjyshi i tij, Isufi. Kishte aftësi të jashtëzakonshme intelektuale dhe ishte shkolluar si autodidakt. Zotëronte në mënyrë prefekte turqishten, filste, lexonte, shkruante dhe e përkthente atë. Lexonte arbasishten. Ishte besimtar, falte pesë vaktet, urrente shumë ateizmin dhe ateistat. Falë diturisë së tij, gjykonte në mënyrë të thelluar dhe me urtësi olimpike. Ai ishte filozof popullor.

Figura 1.1 –Trojet ku lindi dhe jetoi Vesel Murrja (Foto e realizuar nga Fitim Murrja, nipi i Veselit)

Vesel Murrja ishte shumë bujar, "Oda e madhe e tij" apo thënë ndryshe "Oda e mikpritjes" nuk mbahej mend të ishte pa miq. Në krah të majtë të oxhakut kishte një dollap muri të brendshëm, ku mbante libra shqip, turqisht dhe arabisht. Urrente provokimet dhe reagonte shume shpejtë ndaj tyre.

Në verën e vitit 1952, në një dasëm në fisin Murrja në konak ishte një ateist, i cili propogandonte ateizmin dhe përbuznte Fuqinë e Mbinatyrshme. Nuk mundi ta duronte dhe ju përgjigj duke e ofenduar sipas mënyrës së tij alegorike. "Qeni që lidhet, bën një punë ruan shpinë dhe njerëzit. Qeni që nuk lidhet nuk bën asnjë punë (e kishte fjalën për njerëzit pa besim) dhe quhet zagar".

Veseli ishte edhe shumë punëtor. Duke thyer një gur me varre dëmtoi njërin sy. I përbuznte dembelët. Njëherë shkoi në shtëpi një mik, Halim Ferruku nga fshati Pjekë, fshat fqinjë me Selanen, për të bërë muhabet. Pasi kishin ngrën darkë, kishin ndenjur pak dhe kishin mbetur pa muhabet. I kishte thirr të shoqes së tij: Oj zonja e shpisë bjeri petkat e fjetjes (dysheket dhe jorganët) e të biem. Halimi i kishte thënë: Është herët, o Vesel, unë kam ardh për muhabet tek ti. Mirë, i thotë, ku ta fillojmë: Në Stamboll e të vijmë këtu, apo këtu e të shkojmë në Stamboll? Jo, i thotë miku: Këtu e të shkojmë në Stamboll.



Figura 2.1 – Vesel Murrja në trungun gjenetik të fisit Murrja (Burimi: A. Murrja, Xh. Murrja)

Mirë, i thotë Veseli, kur u nise për të ardhur tek unë mik a u lae fëmijëve një hua miell për bukë? Jo, i thotë Halimi. A u ke lënë fëmijëve një barrë me dru për t'u ngrohur? Jo u përgjigj Halimi. Veseli i thotë Halimit: A e ke nënën e fëmijëve? (e kishte fjalën për lopën që të kishin qumësht e bulmet me hëngër). Jo, i thotë Halimi. Veseli shton më tej, leje pra, llafet paskan mbaru. Një njeri që nuk i shërben familjes, çfarë i duhet muhabeti. Përsëri shton Veseli. O Halim të mirat njeriut i vijnë vetëm me punë, ndershmëri e sinqeritet e jo me llafe.

Një ndër pyetjet e shumta të bëra Veselit në mexhelise (oda) ishte: Çfarë bëni Ju, kur zihen dy veta (persona)? Me talentin e tij natyror, Ai i përgjigjet: -Dy të mençur (zgjuar) nuk zihen kurrë, ndërsa kur ngatërrohet një i zgjaur me një budalla, përsëri është e kollajtë (e lehtë), sepse i mençuri i hap rrugën allçakut apo torollakut (budallait). Me të mbaruar përgjigjen, personi e pyetën përsëri: -Po kur zihen dy budallenjë? Përgjigja ishte: -Ndodhsh ti në këtë zënkë, sepse budallai nuk i hap rrugën budallait.

3 -SI E MORI TË DREJTËN "PLAKUT" VESEL MURRJA?

Para Veselit, xhaxhai i tij, Avdulla Murrja, djali i madh i Isufit ishte Plaku i Luznisë. E kujtojnë Abdullain si një burrë të bëshëm e të madh me shpatulla të gjera, i veshur me dollmë të zezë, kësul konike të kuqe me lidhëse të zeza (uniforma e Plakut të krahinës në kohën e sundimit Osman). Avdullahi ka vdekur rreth vitit 1911 në Selane. Plakëllëku i takonte Jahes (djalit të tij), por ai ishte vetëm 3 vjeç, ndërsa Veseli ishte 29 vjeç. Atëherë plakëllëku kaloi tek Veseli sepse ai gëzonte të gjitha tiparet dhe cilësitë e karakterit të drejtë njerëzor. Në kohën e Veselit, Luznia kishte edhe tre Pleqë të tjerë, Xhurxhin në Hotesh, Nikollin dhe Palluçin në Katund të Ri. Ai nuk kishte uniform. Veseli me intelektin dhe zgjuarsinë e tij e pasuroi akoma më shumë Kanunin e Dibrës. Aftësia e tij intelektuale dhe qetësia e tij olimpike bëri që të zgjidhte shumë konflikte me pasoja njerëzore. Zgjidhja e konflikteve midis individëve ishin të panumërta. Ka pasur shumë raste që e kanë kërkuar palë të tretë, pasi palët nuk kanë gjetur pikat e marrëveshjes (thënë ndryshe një nivel më i lartë i gjykimit). Kur Jahja u bë 20 vjeç, Veseli e merrte në të gjitha çështjet kanunore. Jahja ishte trim i hutuar, besnik dhe shumë i zgjaur.

-Zgjidhja e konfliktit midis dy lagjeve të fshatit Dohoshisht (1943)

Në vitin 1943 dy lagjet e fshatit Dohoshisht, Mahmutet në krahun e djathtë të rrjedhës së përroit të Peshkopisë dhe Varrenë në krah të majtë të përroit hyjnë në konfliktë për ujin vaditës. Të dyja lagjet merrnin ujë vadidës tek ura e Peshkopisë. Mahmutet nuk lejonin pjesën që u takonte Varrenit. Atëherë dy palët kërkuan tre pleqë për të zgjidhur problemin e ujit. Palët nuk kishin rënë dakort. Kishin thirr, si pleqë Nokën, Pirën dhe Kaloshin. Në fund kishin thirr Veselin. Palët në konflikt dhe tre pleqtë pritnin Veselin.

Kur shkon Veseli tre pleqtë dhe dy palët në konflikt, i gjen në bahçen e Kadriut (lagja Mahmute). Pasi prezantohet dhe u përshëndet me pjesëmarrësit u mori leje që të merrte fjalën.

Thënia e parë e tij ka qenë: Kanuni nuk zgjidhet këtu në bahçe, por në "tam të vijës" (ujëmbledhësi i kanalit vadidës). Kjo për t'u njohur më qartë me kushtet apo rrethanat e konfliktit dhe për t'i paraprirë espertizës.

Si e zgjidhi konfliktin? Merr dy palët e konfliktuara dhe shkon në "tam të vijë". Dy palët rrinin anash dhe Veseli përvesh mëngët e këmishës dhe futet vet në sfratin e ujit. Gurët që i kapte dora i mbështet në krah të Varrenit, ndërsa gurët më të mëdhenjë i mbështet në krah të Mahmute. Në dy anët rridhte uji dhe të dy palët dolën të kënaqura me sasinë e ujit.

Për nder të Veselit, Ramadan Gjuti i Vjetër nga Varreni bën një drekë të madhe, ku morën pjesë përfaqësitë e dy lagjeve dhe Veseli.

3.2 -Zgjidhja e konfliktit midis fshatit Deshat dhe lagjes Kabe (1941)

Në vitin 1941 futen në konflikt fshati Deshat i njësisë administrative Kastriot me lagjen Kabe të fshatit Pilafe. Shkaku i konfliktit kishte ardhur nga pronësia e një sipërfaqje toke (mera) midis tyre. Meraja ndodhej në perëndim të lagjes Kabe dhe në lindje të fshatit Deshat.

Pasi ata në radhën e parë kishin thirrë Pirën dhe Kaloshin për ta nda se kujt i takon kjo mera dhe nuk kishin rënë dakord me zgjidhjen e tyre, si plak të tretë thirrin Veselin, i cili shoqërohej nga Jahja.

Në bisedë e sipër u thotë palëve, ju që ziheni për këtë tokë, po ju pyes: Kjo tokë a ka emër? Po, i thotë njëri nga përfaqësuesit e Lagjes Kabe. Po, si e ka emrin? Kjo tokë e ka emrin "Rrafshat e Kabe". Kanuni qenka i ndarë u drejtohet palëve. Përse nuk e ka emrin "Rrafshat e Deshatit". Përfaqësuesit e Deshatit kishin lidhje me Xhaferr Balin, komandant i xhandamërisë së asaj kohe. Kapën Veselin dhe Jahen dhe i mbajtën në burg 24 orë. Dolën nga burgu me ndërhyrjen e Miftar Kaloshit tek Xhafer Bali.

-Zgjidhja e konfliktiti midis Kadrieve të Dohoshishtit dhe Ukëve të Pollozhanit

Të jesh plak nuk mjafton fakti i të qënit i zgjuar, por duhet të jesh edhe shumë trim. Kadriet e Dohoshishtit me Ukët e Pollozhanit ishin në konflikt vrasjesh me njërti-tjetrin me disa dekada. Pas disa vitesh vrasjesh njëra pas tjetrës Ukët marrin plak Veselin, për të përcjellë mesazhin e tyre tek Kadriet.

Mirëpo Ukët i thanë Veselit: Të shkosh kështu: kemi me marrë hak, e verteta ishte ndryshe, Kadriu kishte për të marrë. Atëherë u thotë Ukëve "Plak me të mësume nuk ka". Nëqoftëse do të pranoni ashtu siç e mendoj unë, do të shkoj, ndryshe unë shkoj në shtëpinë time. Ukët i thonë Veselit: shko sikur ta mendosh ti.

Kadriet e kishin marrë vesh të gjithë bisedën dhe debatin që kishin bërë Ukët me Veselin dhe kishin bërë plan që nëse Veseli do të vinte me mendjen e Uke, do ta vrisnin. Ndërkohë Veseli troket në derë të Kadriut. Përshëndetet me Rustan Kadriun si më i madhi i fisit. Të gjithë përfaqësuesit e fisit Kadrie ishin të shpërfytyruar, sepse pritshin një tragjedi në konak (Kadriet do të vrisnin Plakun e Uke).

Veseli gjak ftohtë u thotë Kadrieve. Keni të fala prej Ukës: "E kemi var në kunj". Menjëherë ngrihen në këmbë duke i thënë paç faqen e bardhë o Vesel Murrja. Me këtë ngjarje i tha Dibrës dhe pleqëve të Dibrës se "Plak me të mësume nuk ka".

4. PËRFUNDIME

Gjyqësitë e Plakut Vesel Murrja janë të shumta në numër, por ne në këtë artikull sollëm disa prej tyre. Vendimet e drejta e të paanshme të Vesel Murrës merren si precedente dhe shërbejnë si aksioma për zgjidhjen e konflikteve të sotme, kur palët nuk duan t'i drejtohen gjykatës. Edhe sot në mexhelise të Dibrës thuhet kështu ka thënë apo kështu e ka nda Vesel Murrja. Vendimet e këtij filozofi popullor kanë shërbyer dhe do t'i shërbejnë dibranëve si precendete të drejtësisë në breza e shekuj.

Etnia dibrane është e vendosur brenda katër pikave gjeografike, të cilat në zhargonin popullor thuhen, "Gur e Mbigur dhe Mall e m'Zall.

DISA MBIEMRA NË TREVËN E DIBRËS

Nga **Haki Përnezha**
Valdrin VLESHA

(vijon nga numri kaluar)

87. Xheka: -bark Gjininë Mertajni, Fisi Thaç; -bark në gjininë Midhi (Pukë) Fisi Koman; -bark në gjininë Mertajni, Fisi Blinisht në Mirditë.

88. Doda: -bark në gjininë Ndërvigj në Vig, Fisi Gashi; -bark në gjininë Pepa, Fisi Thaç në Lezhë; -bark në Gjininë Gegaj, Fisi Thaç në Fan; -bark në gjininë Deskaj, Fisi Berishë; -bark i gjininsë Mërtur, Fisi Berishë në Korthpulë.; -bark në gjininë Ndocajnë Fisin Yzeve, Pukë; -bark në gjininë Drobaj, Fisi Yzve në Kryezi; -bark e gjini në Fisin e Mirditëve në Orosh; -bark në gjininë Gjoprenaj, Fisi Mirditve në Orosh; -bark e gjini në Fisin e Mirditëve në Simon; -bark në gjininë Gjetpalaj Fisi Pashtrikas në Pështjesh. Sipas Coronell *"... vëllazëri anas në Rrjoll..."* Valentini fq 285.

89. Kuçi: -bark në gjininë Qefalia, Fisi Gashi. Në Defterin osman të vitit 1485 janë regjistruar me këtë mbiemër: dy familje në fshatin Ivrash, Malsi e Madhe; një në fshatin Muriqan dhe një në fshatin Istulush të Tuzit. - «Shfaqet si mbiemër pranë Tuzit më 1335; më 1416-1417 në Shkodër...Pas dhunës në vitet 1878 u shpërndanë në shumë zona të Shqipërisë së Veriut». Valentini fq 331.

90. Çela: -bark në gjininë Buloshi, Fisi Shalës.?????

91. Tola: -bark në gjininë Gjonbardhaj, Fisi Gashi. Në Defterin osman të vitit 1485, me këtë mbiemër është regjistruar një familje në Bozhan të Pejës.

92. Ko(a)cani: -gjini në Fisin e Krasniqes, sot fis në Kukës i afërt me Sulin dhe Brahen.

93. Reçi: -Përmendet shumë në Kadastrën (1416-1417) ndërsa në vitet 1541-1552 përmenden pesë stradiot me këtë mbiemër. Është mjaft i përhapur si toponim. Sipas Gopç, më 1640 përmendet si grup njerzor dhe më 1881 grup me 10 shtëpi. Sot fis në Rrëshen dhe në Dibër.

94. Voka: -bark në Gjininë Degaj, Fisi Krasniqes

95. Piperi ~ Piperku: - *"Një mbiemër i tillë shfaqet për herë të parë" në Kadastrën 1416-1417; dy persona tjerë me këtë mbiemër "bëjnë famë si kaçakë në teritorin turk"...Si komunitet shfaqet më 1455 në fshatrat e Zetës...Piperët konsideroheshin të lirë nga turqit..." Valentini fq 378.*

96. Loca: -bark në gjininë Hunozaj, Fisi Gashit; -Gjini në Buçgjeçaj, Fisi Thaçit; -bark dhe gjini në Fisin Zajsit në Mirditë, Pukë.

97. Huta: -bark në gjininë Hunozaj, Fisi Gashit.

98. Lasku: -bark në gjininë Gjoni, Fisi Gashi; -bark në gjininë Dushaj, Fisi Koman; bark në gjininë Xhetani, Fisi Yzeve; gjini dhe kryefis në Spaç, Fisi Yzeve; -bark në gjininë Jakaj, Fisi Yzeve në Gojan; -bark në gjininë Tusha, Fisi Ndërshenve në Rrëshen; -bark në gjininë Kolgjonaj në Simon, Fisi Zajsit.

99. Pepa: -bark në gjininë Ndërvigj, Fisi Gashi; -gjini në Fisin Gashi; -bark në gjininë Mërtajni, Fisi Thaçi; -bark në gjininë Marlleshi Fisi Zojsit në Bushkash; -bark në gjininë Buloshi, Fisi Shoshit; -bark në gjininë Bujan, Fisi Këlmend, Malsi e Madhe

100. Krosi: -bark në gjininë Kodraxhinjtë, Fisi Gashi; -bark dhe gjini në Fisin e Dibrrakës, i afërt me Marken.

101. Loshi: -Kryefis dhe bark në gjininë Vulit, Fisi Këlmendi. Ndërsa Valentini duke cituar Gjeçovin shënon: *"Losha duhet të ketë qënë pjesë e fisit Mazreku." fq 342*

102. Miha: -bark në gjininë Gega (Bolit), Fisi Këlmend; -bark në gjininë Mitaj në Shkodër.

103. Bali ~ Balja: -fis në Vuthaj.

104. Prençi: -bark në gjininë Gjokolaj, Fisi Këlmend; -gjini, bark dhe fis në Dukagjin; -fis dhe bark në gjininë Prenaj në Gjon Shkodër; -bark në gjininë Gjonaj, Fisi Gashit; -bark në gjininë Dedaj, ardhë nga Peja. Fisi Fanëmëdhenj; bark në gjininë Sallaku, Fisi Blinisht në Zadrimë; -bark në gjininë Jushi, Fisi Ndërshenve në Rrëshen; -gjini e fis në Simon, Fisi i Zajsit. Në Defterin osman të vitit 1485 në fshatin Goran pjesë e ziametit Altun Ili-së është regjistruar një familje.

104. Istrefi: -bark në gjininë Gjokola, fshati Qerem Tropojë, Fisi Këlmend.

105. Tanuzi: -gjini dhe fis në Vukël.

106. Laci: -bark në gjininë Hoti, Fisi Këlmend; -bark në fisin Alia gjinia Aldedli, Fisi Kastrat; -bark në gjininë Qaforleka në Pukë, Fisi Kabash.

107. Alia: - fis në Gjininë Aldedli në Kastrat dhe që ndahet në barqe: Hysa, Laci, Buci; -bark e krye fisi në Dukagjin; -bark e gjini në Kir; -gjini në Fisin Gashi; -bark në gjininë Dragobi, Fisi krasniqi; -bark në gjini Buçgjeçaj, Fisi Thaçi; bark në gjininë Dushi, Fisi Koman; -bark në gjininë Gjoka, Fisi Yzeve. Valentini në fq 262 duke cituar Gjeçovin, shkruan *"...fis i dëgjuar në Kastrat"*.

108. Buci: -bark në fisin Alia, gjinia Aldedli në Fisin Kastrat; -bark në gjininë Shipshan, Fisi Gashi.

109. Gjini: -gjini në Dukagjin, fis në Shalë e në Shosh; -fis në Spaç gjinia Gjogjin, Fisi Yzeve; gjini në Fisin e Blinishtëve në Kurbin; -krye fisi dhe bajraktar në gjininë Gjeshgoraj në Kir, Fisi Këlmend.

110. Gjegja: -bark dhe fis i gjnisë Buçgjeç, Fisi Thaçi në Fan; -bark në gjininë Vathi, Fisi Yzeve në Spaç.

111. Kaza: -fis dhe gjini në Fisin Thaç në Fan i afërt me gjininë Gjokaza dhe Laskaza; -bark në gjininë Koka, Fisi Mirditë në Orosh.

112. Gjeta: -bark në gjininë Kaza Fisi Thaç.

113. Çera: -bark në gjininë Geaj, Fisi Thaç në Fan; Gjini në Fisin fanëmëdhenjve në Gojan. Valentin në fq 281, duke cituar Gazullin shënon: "fis anas në Kalivaç, Mirditë"

114. Dauti: -bark dhe fis në fshatin Has, Fisi Thaç.

115.Leka: -bark në gjininë Mertajni, Fisi Thaç; -bark në gjininë deda, Fisi Fanëmëdhenjve ardhë nga Peja; -bark në gjininë Boçi, Fisi Fanëmëdhenjve ardhë nga Klina (Kosovë) në Mirditë.; -bark në gjininë Kametaj, Fisi Pa Emër në Kamec; -bark në gjininë Gjokola, Fisi Zajsit ne Gjoçaj.

115. Mjeshtri: -bark në gjininë Palojas, Fisi Thaç; -gjini në Fisin Blinisht.

116. Tafa: - bark në gjininë Bacaj Fisi Thaçi; -bark në gjininë Gjurra, Fisi Shoshit në Pelan (Plan).

117. Çuni: -bark në gjininë Bacaj, Fisi Thaçi; -bark në gjininë Doçi, Fisi Berishë në Kashnjet; -bark në gjininë Marprendaj, Fisi Mirditorve në Orosh.

118. Bitri: -bark në gjininë Pepa, Fisi Thaçi në Lezhë. Në Kadastrën e 1416-1417 gjenden shumë persona me mbiemrin Bitër, por kemi edhe plot emra Bitër. Si patronim ndodhet i shtrirë në shumë zona të Shqipërisë.

119. Nezha: -bark në gjininë Taci në Fisin Pa Emër në Shebe.

120. Kurti: -bark në gjininë Kalthi, Fisi Pa Emër, nga Proseku vendos në Mat.

121. Loka: -bark në gjininë Lugja Fisi Pa Emër në Kthellë.

122. Meta: -bark në gjininë Kametaj në Fisin Pa Emër, Kamec.

123. Gjoçi: - gjini e Fisit Zajas në Gjoçaj; -bark në gjininë Vladi, Fisi i Lurës.

124. Skura: -bark në gjininë Hasanpepaj, Fisi Zajazit në Lëm të Madh, i afërt me Përgjegjin. Valentini, në fq 395, shënon: "si mbiemër shfaqet që më 1273 në Durrës, më 1602 njihen me këtë mbiemër tre nga pleqtë kryesor të Kurbinit.

125. Përgjegji: -bark në gjininë Hasanpepaj, Fisi Zajazit në Lëm të Madh.

126. Spahiu: -Valentini në fq 397 shënon: " vllazni anas në Qelëz".

127. Shira: -bark në gjininë Dajçi, Fisi Zajsit në Karicë.

128. Mani: -bark në gjininë Dajçi, Fisi Zajsit në Karicë.

129. Nuzi: -bark në gjininë Dajçi, Fisi Zajsi në Karicë.

130. Disha: -bark në gjininë Cara, Fisi Zajas në German.

131. Halili: -bark në gjininë Cara Fisi Zajsit në German; -bark në gjininë Tota, Fisi Yzeve; -bark në gjininë Cakoni, Fisi fanëmëdhenjve në Bushkash.

132. Nela: -bark në gjininë Cara, Fisi Zajsit në German; -bark në gjininë Blazë, Fisi Zajsit në Mat

133. Arapi: -fis i afërt me Velia në Fisin Zajas.

134. Beqa: -fis i ardhur nga Malsia e Mbishkodrës, në Fisin Zajas.

135. Skeja: -fis në gjininë Bardhi Fisi Zajs i afërt me Leshin; -bark në gjininë Gjonlala, Fisi Zajas në Germa.

136. Koçi: - Sipas Valentinit fq 324: "...fis i përmendur nga Bol që më 1614...në Mal të Zi».

137. Bojku: -Në Dëfterin osman të 1485, ky mbiemër shfaqet në fshatin Petroshan të Tuzit, dy familje.

138. Kurtçuni: -vëllazëri në Shllak.

139. Lata: -vëllazëri, mbiemër stradiot më 1523-1546.

140. Lica: -vëllazëri në Domgjon. Valentini fq 339.

141. Losha: -vëllazëri. Sipas Muralt "Losha duhet të ketë qënë pjesë e fisit Mazreku" Valentini fq 342.

142. Mallkas: -dikur fis, mbiemër stradiot. Fshat i shuar në Dibër.

143. Marçen: -vëllazëri e njohur që në 1288 (Valentini 351). Në Defterin osman 1485 në fshatin Marshenj të Shkodrës janë regjistruar tre familje me këtë mbiemër. Sipas Valentinit, *"... vëllazëri e njohur që në 1288...",(fq 351);* sot toponim në disa zona dhe grup fisesh në Çidhën.

144. Delishi: -sipas Valentinit, *"...fis anas në Koplik, tani i shuar." fq 283.*

145. Matrisi: -bark në Rubik, Fisi i Dibrrakëve. Në Defterin osman të vitit 1485, në fshatin Prekal të Shkodrës është regjistruar një familje me këtë mbiemër.

146. Dush-aj: -Sipas Valentinit, *"...bajrak i Pukës". fq 288.*

147. Dani: -bark në gjininë Nika, Fisi Yzeve. Në Defterin osman të vitit 1485, në Gril të Shkodrës është regjistruar një familje me këtë mbiemër.

148. Cani: -fis dhe gjini në Fisin e Fanëmëdhenjve në Kukës.

149. Krrash-i: -Sipas Valentinit, *"...vëllazëri Krashi-Grashi...Kirasi...persona të ndryshëm me këtë mbiemër ndodhen në Kadastrën Shkodrës 1416-1417." fq 295.* Në Defterin osman të vitit 1485, fshatin Grizhë të Shkodrës janë regjistruar katër familje me këtë mbiemër.

150. Korumi: -bark në gjininë Deda, Fisi Kabashit, ardhë nga Malsia e Madhe, sot në Qelëz.

151. Coli-Colja: -bark në gjininë Ndreu Fisi i Yzeve.

152. Xhani: -Sipas Valentinit ky mbiemër vjen nga *"misionarët e italianizuar. Përmendet që më 1883 në Dukagjin, i njohur në punimin e drurit." fq 300*

153. Osmani: -bark dhee fis në Fisin e Fanëmëdhenjve në Kukës.

154. Keça: -bark në gjininë Ndreu Fisi fanëmëdhenjve në Zhyn Mirditë.

155. Smaçi: -fshat në zonën e Hasit. Sipas Valentinit, *"...vëllazëri. përmnedet* në Kadastër 1416-1417...më 1541 disa veta më këtë mbiemër mes *stradiotëve...këmi fshat në Gjakovë dhe Mal Bardhë Kurbin..." fq 396.* Në Defterin osman të vitit 1485, në Shkodër është regjistruar një familje me këtë mbiemër.

156. Voci: -bark në gjininë Sinani, Fisi fanëmëdhenjve në Gëziq; -bark në gjininë Martini, Fisi Mirditve; -bark në gjininë Losha, Fisi Kastrati në Malsi Madhe; -bark në gjininë Morenaj, Fisi Yzeve.

157. Xheleshi: -bark në gjininë Uka Fisi Yzeve.

158. M'ziu: - sipas një informacioni të Valentinit, *"...ishin zotërinj të lballës e Kryeziut...u shpërndnë në shekullin XVII." fq 314.*

159. Nikolli: -fis në Prosek dhe bark e gjini në Fisin Pa Emër.

160. Imeri: -fis në Macukull në gjininë Bukaçi, Fisi Pa Emër.

161. Z(h)uka: -bark në gjininë Lala, Fisi i Mirditëve në Blinisht.

162. Puci: -bark në gjininë Bujani, Fisi Kelmend.

163. Grosha: -bark në gjininë Vuçinaj, Fisi Kelmend në Malsinë e Madhe.

164. Xhediku: -Në Defterin osman të vitit 1485, me këtë mbiemër është regjistruar një familje në Pejë.

165. Mallkas: Sipas Valentinit, *"...dikur fis, mbiemër stradiot..." fq 345*

166. Nezha: -bark në gjininë Taci, Fisi Pa Emër, në Shebe.

167. Kurti: -bark në gjininë Kalthe, Fisi Pa Emër, në Mat.

168. Loka: -bark në gjininë Lugja, Fisi Pa Emër në Kthellë.

169. Meta: -bark në gjininë Kametaj, Fisi Pa Emër, në Kamec.

170. Gjoçi: -gjini në Fisin Zajas në Gjoçaj.

171. Skura: -bark në gjininë Hasanpepaj, Fisi Zajazit, Lëm i Madh, i afërt me Përgjegjin. *"...si mbiemër shfaqet që më 1273 në Durrës; më 1602 njihen 3 nga pleqtë kryesor të Skurajt Kurbin." (fq 397)*

172. Përgjegji: -bark në gjininë Hasanpepaj, Fisi Zajazit në Lëm i Madh.

173: Spahiu: *"...vllazni anas në Qelëz..." (fq 397)*

174. Korra: -Mal që ndan Nikaj me Mertur. Në Defterin osman të vitit 1485, me këtë mbiemër është regjistruar një familje në fshatin Ribar të Plavës

175. Elezi: -bark në gjininë Markgegaj, Fisi Krasniqe.

176. Vargu: -bark në gjininë Lekbibaj, Fisi Nikaj.

177. Murati: -bark në gjininë Markgegaj, Fisi Krasniqe.

178. Pali: -bark në gjininë Shoshan, Fisi Krasniqe.

179. Mustafa: -bark në gjininë Zherg, Fisi Bytiq në Has.

180. Kryemadh: -fshat në Bytyq.

181. Çaushi: -gjini në Fisin Bytiq në Has.

182. Leka: -bark në gjininë Martini, Fisi Thaç; -bark në gjininë Loca, Fisi Thaç.

183. Duraku: -gjini në Fisin Koman.

184. Suti: -bark në gjininë Dushi, Fisi Koman; -fis në gjininë Gjeçi, Fisi Yzeve; -bark , në gjininë Lala, Fisi Fanëmëdhenjve në Blinisht.

185. Lazri: -bark në gjininë Dushi, Fisi Koman në Korthpulë i afërt me Laskun.

186. Seferi: -bark në gjininë Mardedi, Fisi Yzeve; -bark në gjininë Uka, Fisi Yzeve.

187. Hysa: -bark në gjininë Vrataj, Fisi Këlmend, Malsi e Madhe.

188. Kala: -fis në gjininë Ceku, Fisi Këlmend, në Vukël i afërt me Alinë; -bark në gjininë Paldedli, Fisi Kastrat në Shkodër.

189. Cami: -bark në gjininë Pecaj, Fisi Shalës në Dukagjin; -bark në gjininë Lacgega, Fisi Hoti në Rapsh të Hotit.

190. Molla: -bark i mbështetur tek Deda, Fisi Shkrelit, Malsi e Madhe.

191. Palushi: -bark në gjininë e Buloshit, Fisi Shoshit.

192. Rexha: -bark në gjininë Vuçinaj, Fisi Këlmend, Malsi e Madhe.

193. Çeka: -gjini e vjetër në Kir, fis i Dukagjinit.

194. Aga: -gjini në Fisin Gashi , në Malsi të Gjakovës.

195. Hoxha: -gjini në Fisin Gash, Malsi e Gjakovës.

196. Kaja: -bark në gjininë Papnikaj, Fisi Gashi, Malsi e Gjakovës.

197. Hasa: -bark në gjininë Papnikaj, Fisi Gashi, Malsi e Gjakovës.

Nga Defteri Osman i Sanxhakut të Shkodrës, viti 1485, kemi veçuar këto patronime:

198. Novaku: - më këtë mbiemër janë regjsitruar tetë familje në fshatrat: Koplik Shkodrë; Buçoriq, Pobaçanxh dhe Ribar të Pejës; në Trapç dhe Kukaran të Plavës.

199. Domozeti: - me këtë mbiemër janë regjistruar pesë familje në Ribar të Plavës dhe Kaçicë të Vuçiternës.

200. Stojku: - me këtë mbiemër janë regjistruar tre familje në fshatrat Marin, Shkodër; në Gorazhde Peje dhe në Bana të Suhogerllës.

201. Kolari: - me këtë mbiemër janë regjistruar dy familje në Deçan; dhe një në Baninë të Pejës.

202. Kos(h)iqi: -me këtë mbiemër është regjsitrua një familje në Kaludri të Pejës.

203. Pu(o)liçi: - një familje në Shalë të Shestanit Shkodër.

204. Ko(a)roshi: - një familje në Vidhker të Shestanit, Shkodër.

205. Sava: - me këtë mbiemër është regjistruar një familje në Bjelopolje të Pejës ndërsa gjendet edhe si pjesë në trupin e emrave të disa emrave si psh: Vidosava; Belasave; Vukosava etj, etj.

BIBLIOGRAFI:

1. Selami Pulaha: "Defteri i regjistrimit te sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485" Tiranë 1974

1. Rober Elize: "Fiset shqiptare", Prishtinë 2017

2. Zef Valentini: "E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare" , Tiranë 2007

3. Ernesto Cozzi: "Studime etnologjike të Shqipërisë s'Epërme", Lezhë 2017

4. Bernardin Palaj: "Bota e Maleve shqiptare", Shkodër 2018

5. Nuri Koleci: "Mbiemrat, fiset në Dibër dhe Rrethinë" , Dibër 2018

Peshkopi, gusht 2021

Libri i 7-të i bashkautorëve
Halil Rama dhe Sakip Cami

Zall Dardha në ditarin e Isuf Rashës

Nga **ILMI DERVISHI**

Artisti i Madh i Dardhës, Dibrës dhe gjithë Shqipërisë, Hazis Ndreu - "Nderi i Kombit", kur donte të shkruante dhe botonte libra për traditën dhe alegorinë dibrane, njeriun e parë që takonte në Zall Dardhë dhe e pyeste rreth projektit të tij krijues ishte Isuf Rasha

"Nëse dëshiron të njohësh një njeri lexo ditarin e tij. Nëse dëshiron të njohësh një periudhë kohore historike lexo ditarët dhe shtypin e kohës.

Nëse ke mbajtur ditar tregon se je njeri i rregullt, i vëmendshëm, parashikues, optimist, krahasues, dhe vizionar.

Një nga të rrallët, por edhe të veçantët njerëz me botë të madhe shpirtërore është Isuf Rasha. Këtë e thonë ditarët e tij, që fatmirësisht bashkëshortja Hyrie dhe gjashtë djemtë e tij i kanë ruajtur si sytë e ballit. Janë ditarë shumë të thjeshtë , të vegjël, blloqe të vegjël, me një shkrim të imët, por me kaligrafi, që flasin shumë....

Pikërisht mbi bazën e këtyre ditarëve, bashkautorët e mirënjohur Halil Rama dhe Sakip Cami hulumtuan dhe pas një pune të mirëfilltë studimore-shkencore shkruan dhe botuan librin (monografi).

Kjo monografi i kushtohet njërit nga të rrallët, por edhe të veçantët njerëz me botë të madhe shpirtërore, siç ishte Isuf Rasha, shprehur kjo edhe në ditarët e tij...



Kjo monografi i kushtohet njërit nga të rrallët, por edhe të veçantët njerëz me botë të madhe shpirtërore, siç ishte Isuf Rasha, shprehur kjo edhe në ditarët e tij... Libri "Zall Dardha në ditarin e Isuf Rashës është një vepër e rëndësishme studimore-shkencore...

BASHKËKOHËSIT PËR ISUF RASHËN

Për vlerat e rralla dhe profilin krijues të I.Rashës flasin bashkohës të tij, personalitete të mirënjohura si: Beqir Shehu, Xhelil Cibaku, Isuf Xhediku, Muharrem Gjoka, Shuaip Methasani, Dr.Lazam Gjoka, Nazmi Shira, Agim Bara, Gëzim Cala, Shaqir Çerpja, Ilmi Dervishi, Gani Murati, Ferit Çerpja, Mexhit Poleshi, etj.

Në 8 kapitujt e librit me 320 faqe, botim i "M&B", veç të tjerash përshkruhen në detaje toponimet e të gjitha fshatrave të Njësisë Administrative Zall Dardhë...

Ish shefi i Seksionit të Arsimit dhe Kulturës të rrethit Dibër Beqir Shehu, në parathënien e këtij libri, ndër të tjera shkruan se: "Bashkautorët e mirënjohur Halil Rama dhe Saklip Cami (pas botimit dhe promovimit të monografive për kompozitorin Muharrem Xhediku, gjeneral Rrahman Parllaku, për Sefer Efendiun - Kazazin e Bajram Ndreun e Zall Dardhës), nëpërmjet ditarit të Isuf Rashës nxjerrin në pah vlerat e tij, ndërkohë përshkruajnë jetën dhe veprimtarinë e personazheve, duke na dhënë edhe copëza jete të malësorëve dernjanë, ku lexohen traditat dhe virtytet e popullit të kësaj krahine, si njerëz të punës e atdhetarë, por edhe si njerëz të përkushtuar për dije e të suksesshëm në të gjitha fushat e jetës".

Ndërkohë Muharrem Gjoka - "Mjeshtër i Madh" dhe President i Ansamblit Artistik "Hazis Ndreu" - "Nderi i Kombit" , ndër të tjera shprehet se: "Artisti i Madh i Dardhës, Dibrës dhe gjithë Shqipërisë, Hazis Ndreu, kur donte të shkruante dhe botonte libra për traditën dhe alegorinë dibrane, njeriun e parë që takonte në Zall Dardhë dhe e pyeste për projektin e tij krijues, ishte Isuf Rasha".

Në këto pak radhë po perifrazojmë edhe ish-shefin e seksionit të Kontroll-Revizionit të Komitetit Ekzekutiv të Dibrës, Xhelil Cibaku: "E veçantë në veprimtarinë e tij ishte koherenca në trajtimin e problemeve. Si një intelektual bashkëkohor nuk merrej me cikërrima, por me bazën reale ku duhej mbështetur analiza e mbarëvajtjes apo problematikave të kohës. Ai konkurronte kudo dhe në çdo rast me virtytin dhe vlerat shumëdimensionale që e karakterizonin".

Shuaip Methasani, intelektuali mbi 85-vjeçar që nga shunmëkush konsiderohet si simbol i urtësisë dhe menAurisë dibrane, në opinionin e tij evidenton pikërisht virtytin e Isuf Rashës si burrë i kuvendeve, ku i dëgjohej dhe I zinte vend fjala.

Përveç kapitujve "Ditari" dhe "Bashkëkohësit për Isuf Rashën" këtë libër e bëjnë interesant edhe kapitujt "Ditari", në kapitullin "Njeriu I thjeshtë Isuf Rasha, me veprimtarinë e tij mbeti në kujtesën e njerëzve" spitasin tituj intrigues e impresionies si: "Kontrolli tendencioz", "Kur gjuanim lepuj, me Hekuran Isain e Ndue Gjinin...", ""Ndëshkimi" pse vrau tre qentë e kooperativës - Si e mbrojti Skënder Dema?!", "Nëpër kantieret e punës në të gjithë atdheun", "Projektues i xhadeve dhe rrugëve të brendshme të fshatrave", "Pasioni pas pemëtarisë, vreshtarisë dhe verërave" etj.

PUBLICISTIKA DHE PRIRJET LETRARE TË ISUF RASHËS

Ndonëse nuk është ndonjë autor i njohur, në labirintet e laboratorit krijues të Isuf Rashës, (të shprehur në formë ditari) gjen dhjetëra artikuj problemorë, poezi, skica etj., (disa të botuar në gazetën lokale "Ushtima e maleve", por shumica të pabotuara), ku reflektohen fakte historike, por edhe shqetësimi për mbarëvajtjen e punëve në ish kooperativën bujqësore të Zall Dardhës së tij të largët.

Pikërisht kryellogaritari i një ekonomie bujqësore provinciale, që jo vetëm i kishte të koleksionuara, por edhe të mirëstudiuara revistat "Shkenca dhe jeta" dhe "Bujqësia", do të ishte udhërrëfyes në aplikimin e metodologjisë së punës shkencore, duke mundësuar një ambientim të ri në studime, një cytje drejt përvetësimit të njohurive bashkëkohore dhe aplikimit të tyre në praktikën e përditshme, në sektorë të tillë si pemëtaria, blegtoria, bletërritja (gjuetia, parashikimi i motit e infermieria) apo deri dhe te projektimi e ndërtimi i rrugëve të ndërmjetme mes fshatrave të Dardhës, studime këto të botura në shtypin e kohës. Me fjalë të tjera, Isuf Rasha ishte intelektuali bashkëkohor, i cili edhe në kushtet e rrethanat e izolimit total, në një ekonomi provinciale, hartonte dhe zbatonte projekte që konsistonin në doza optimale të materialeve teorike, për t'i dhënë rëndësi punës praktike, nga e cila krijonte bazamente të qëndrueshme për vepra po të qëndrueshme, disa prej të cilave i hasim edhe sot pas më shumë se tri dekadash, si blloku i pemëve (sipër shtëpisë së tij) apo dhe ndonjë rrugë ndërlidhëse fshatrash...

Jo më në Zall Dardhën e largët, por ndoshta edhe këtu në Tiranë, metropolin shqiptar, rrallë mund të gjesh një bibliotekë aq të pasur, si ajo që i la trashëgim familjes së tij Isuf Rasha. Pikërisht, intelektuali bashkëkohor, që kishte lexuar (e madje konspektuar), Tolstoin, Shekspirin, Dostojevskin, Uilliam Folkner, Çarls Dikens etj., dalëngadalë, nëpërmjet leximeve, përjetimeve e asosacioneve, do të formonte profilin e tij letrar. Dhe jo vetëm kaq. Nuk është rastësi që në arkivën e tij personale gjejmë koleksionin e të gjitha nr. të revistës "NËNTORI", si dhe shumicën e nr. të gazetës "DRITA", nga ku ai, jo vetëm lexonte letërsinë e kritikën letrare bashkëkohore, por edhe mësonte rreth stilistikës së të shkruarit letërsi. Ndonëse krijimtarinë e tij nuk e publikoi, nuk është rastësi që atë e ruajti me fanatizëm në "sepetet" e familjes, me bindjen se një ditë ajo do të "zbulohej" e, madje, do të gjente dritën e botimit. Brenda "arsenalit" të tij krijues, mjafton qoftë edhe poezia (e lënë në dorëshkrim "RREBESHET E SHKUARA MË NUK KTHEHEN", për të konkluduar në peshën e fjalës, gjuhën e pasur e mjetet shprehëse brilante të një poeti të talentuar. Ligjërimin e tij poetik e gjejmë të sintetizuar qoftë edhe në vargjet: "Dikur në këto brigje qe zënë dielli/Errësira kishte bllokuar edhe qiellin/ Errësira, skamja, padituria/ U duk sikur në këto male kanë zënë rrënjë..."

Ndonëse e donte dhe dashuronte jetën, ai iku për në botën e përtejme para më shumë se dy dekada, duke lënë pas një trashëgimi të pasur dokumentare. Mjaftojnë qoftë dhe dhjetra ditaret e lënë në dorëshkrim (nëpër blloqe a fletore të asaj kohe), për të kuptuar punën e tij të thelluar studimore, duke përshkruar gjer në detaje fakte e ngjarje historike të zonës së Zall Dardhës me histori të lavdishme, për toponiminë, për Simpoziumin e organizuar në Zall Dardhë nga zona e Reçit dhe Dardhës me rastin e 75 vjetorit të pavarësisë, etj. Pikërisht, referuar këtyre fakteve, bashkautorët e mirënjohur Halil Rama dhe Sakip Cami, e kanë skalitur më së miri profilin krijues të Isuf Rashës në këtë monografi, ndaj dhe meritojnë mirënjohjen e gjithë dernjaneve e të miqve të familje së njohur Rasha të Zall Dardhës. Në harkun kohor të një dekade ata kanë botuar dhe promovuar edhe gjashte monografitë: "Muharrem Xhediku-kompozitori i tangos shqiptare" (2010); "Rrahman Parllaku – Një legjendë në kufirin e dy kohëve" (2014); "20 vjet OBVL" (2014); "Bajram Ndreu i Zall Dardhës, biri i shquar i një familje të madhe" (2015); "Histori brezash të familjes së shquar Kazazi të Durrësit" (2017) dhe "Gjenerali që sfidoi kohërat" (2019).

Libri i ri i tyre "Zall Dardha në ditarin e Isuf Rashës është një vepër e rëndësishme studimore-shkencore për një nga trevat e njohura të Verilindjes.

Skamnorët, një novelë nga Gëzim Loka

Nuk e kisha menduar ndonjëherë që ambiciet e mia modeste në fushën e shkrimtarisë të arrinin gjer te novela. Gjithmonë kam lexuar, në punë, në shtëpi, në kafe, madje dhe në stolat e parqeve publike, por nuk kam guxuar ndonjëherë ta vë veten apo ta përfytyroj atë në rolin e një prozatori e aq më pak të një novelisti. Leximi i novelave gjithmonë më ka suprizuar me një emocion të veçantë, pasi, duke qenë midis tregimit dhe romanit, ndjesia e zbulimit të detajeve të rrëfimit ka qenë për mua përherë e beftë dhe çarmatosëse, në kuptimin e joshjes së leximit dhe dilemave të postleximit.

Por hap pas hapi, duke pasur kontakte të gjalla me njerëz të të gjitha shtresave dhe niveleve shoqërore dhe duke mbajtur shënime për gjithçka, gjë që e bëj me korrektesë mbi 45 vjet, kuptova se dalëngadalë qenë krijuar subjekte rrëfimtare, që në fillim flinin në kokën time dhe më vonë po trupëzoheshin e merrnin formë, në pritje që t'i hidhja me ngut në letër.

Kjo novelë iu kushtohet atyre që ngrysen e gdhihen të uritur, pa një strehë normale, pa shtroje e mbuloje, pa veshje e mbathje, pa kushte normale jetese apo mbijetese. Ne i kemi ata në mesin tonë, ua njohim plagët, dhimbjet, trishtimin për rrethanat në të cilat është mpleksur jeta e tyre mjerane dhe bëjmë pak, fare pak për ta, aq pak sa nëse do ta shikonim vetveten në thellësitë e një radiograme tmerrësisht të saktë, do të skuqeshim gjer në majë të veshëve nga turpi. Por kjo është tjetër gjë dhe meriton një tjetër vëmendje.

E kam fjalën tek skamnorët. Nuk janë as një e dy, as dhjetëra e qindra, por qindra mijëra. Ushtria e tyre e pafund, një ushtri e lodhur deri në drobitje nga pamundësia e një ekzistence normale, apelon për pak më shumë njerzillëk, për pak më shumë ndihmë e përkrahje, për pak më shumë drejtësi e dashuri njerëzore.

Kjo novelë iu kushtohet atyre që ngrysen e gdhihen të uritur, pa një strehë normale, pa shtroje e mbuloje, pa veshje e mbathje, pa kushte normale jetese apo mbijetese.

Kjo histori është pjesë e atyre mijëra e mijëra historive të trishta, që shkruajnë çdo ditë dramën e ekzistencës në lëkurën e dhimbjes njerëzore. Shkruajnë konfliktet, dilemat, një filozofi të ngatërruar, që nuk ia del t'iu japë përgjigje shumë pyetjeve, që shoqërojnë rrugëtimin tonë jetësor. Kjo histori nuk duhej shkruar. Por fakti që po e shkruaj tregon se na dhemb deri në asht e në pore të lëkurës. Është pjesë e ëndrrave dhe shpresave të thyera, por që prapë gjejnë forcën për t'u ringritur, pjesë e zhgënjimeve, privimeve të mbijetesës në një shoqëri krejt të ftohtë e të pandjeshme ndaj vuajtjes njerëzore, në një shtet, që nuk do t'ia dijë për të varfrin dhe të pamundurin.

Personazhet kryesorë të kësaj historie janë njerëz të zakonshëm, që i hasim çdo ditë në jetën tonë. Nuk janë vipa. Nuk kanë numra llogarish, nuk kanë konto bankare, depozita në të holla, sigurim jete e shëndeti, shtëpi të ngrohta e kushte normale jetese. Por kanë një shpirt të bukur, ëndërrojnë për një jetë më të mirë dhe e meritojnë një jetë të tillë, të cilën askush nuk ka të drejtë t'ua refuzojë.

Jeta e tyre mjerane bën kontrast të trishtë me jetën e deputetëve, shefave të policisë, njerëzve me pushtet dhe me pasuri që dinë t'i llogarisin, me shuma marramendëse në numra llogarish legale e të fshehta, por që gjithçka e kanë ngritur mbi një imazh të rremë, mbi shkeljen e ligjit dhe të të drejtave qytetare të të tjerëve.

Histori të tilla ndeshim çdo ditë në jetën tonë të ngarkuar e të stresuar nga varfëria deri në skamje, nga mungesa e rendit publik dhe rendit qytetar, të cilat kërcënohen çdo çast, në mënyrë permanente nga të fuqishmit, të kamurit, politikanët dhe shtetarët e këtij vendi. Çdo përkim i personazheve të kësaj novele me persona konkret është një rastësi. Çdo përkim i ngjarjeve dhe situatave të paraqitura në këtë novelë me ngjarje dhe situate konkrete të ndodhura në realitet, është një rastësi.

Por kjo histori, këto ngjarje, këta personazhe nuk janë rastësore, por pjesë e një realiteti të trishtë të quajtur "realiteti postkomunist" dhe ku të varfrit po bëhen gjithnjë e më të varfër, të pasurit gjithnjë e më të pasur dhe politika, që konsiderohet si një art i përmirësimit të jetës njerëzore, në këtë vend është kthyer në një model antivlere, në një varrmihëse jetësh të gjalla dhe shpresash për një të ardhme më të mirë.

Kjo histori, i dashur lexues, do të doja të mos tregohej kurrë. Por ajo duhet treguar sa kohë që këta përbindësha flasin në emër të sovranit dhe vrasin jetë të pafajshme njerëzore...

(Marrë nga parathënia e librit)

Libri "Kongresi i Dibrës" i Qenan Zija Manastirit, dokumenti monumental

Nga **RAMAZAN S. ILNICA**

(Vijon nga numrin i kaluar)

• MBLEDHJA E TRETË –

Kjo mbledhje e Komsionit paraprihet nga debatet mes dy rrymave. Rryma konservatore kërkonte mbylljen e diskutimeve vetëm me nenet e komisionit nisiator, duke i quajtur jashtë juridiksionit diskutimet për çështje të tjera. Por ishte atdhetari Vehbi Dibra i cili duke kuptuar rrezikun që vinte nga mbyllja e debateve kish të drejtë të shfaqte mendimin e vet. Diskutimet me ç'rast duhej të ishin të rregullta dhe brenda proceduarve të caktuara. Këtë dije e mbështeti me ton burrëror edhe Qenan Zijai i cili nuk mungoi të thoshte :"Kemi liri të plotë, s'ka të drejtë kush, të na caktojë kufij për bisedim. Mendimet e larta të kombit bujar s'mund t'i nëpërkëmbi askush".*

Polemikat qenë të gjata dhe të ashpra në shumë raste, sidoqoftë shumica arriti që të detyronte vazhdimin e diskutimeve për çështjet e tjera që ishin shumë të rëndësishme për popullin shqiptar, si: rektifikimi i kufirit të Shkodrës, një propozim për punët botore, çështja e arsimit shqip, përdorimi i alfabetit latin në shkolla, hapja e shkollave shqipe dhe mësuesit me arsim etj.

Siç shihet në mbedhjen e tretë dhe të katërt, diskutimet u thelluan në çështjen e arsimit shqip.

Patriotët shqiptarë, në një seancë të fshehtë në konakun e Teqesë së baba Shabanit e bënë listën e kërkesave që ishin të karakterit ekonomik, administrativ dhe arsimor-kulturor, të cilën xhonturqit ishin të detyruar ta pranonin, qoftë edhe për sy e faqe. Megjithatë manovrat e xhonturqve ishin përcaktuar shumë qartë dhe, duke e shfrytëzuar fanatizmin fetar dhe prapambetjen e shqiptarëve, ata orvatën t'i përçajnë shqiptarët. Në taborin tjetër me plot krenari qëndronin: Qenan Manastiri, Gani Frashëri, Abdyl Ypi, Seid Aga, Murat Agë Gjakova, Isuf beu, Ibrahim Daci e tjerë.

Po japim disa pasazhe nga thëniet e diskutantëve në Kongres:

Qenan Manastiri kundërshton thëniet e rrymës proturke, që synonin të zbatohej politika e xhonturqve.

Polemika nisi kur Hafiz Ali Efendiu me një mocion që parashtroi kërkoi të çelen shkolla ndër vende ku ato mungojnë dhe në të gjitha shkollat të shtihet mësimi i gjuhës shqipe. Kundërshtimi nga pala tjetër ishte thelbësor që në shkolla të mësohej vetëm turqisht, si nga Riza Beu dhe disa të tjerë të krahut konservator.

Riza Beu: - Gjuha Kombëtare, don me thanë shqipja nuk na lypset. Neve na mjafton turqishtja. Ndër shkolla mjafton turqishtja. Ndër shkolla duhet me këndue vetëm turqisht.

Myfti Rexhep Efendiu: - Me thanë se nuk na duhet gjuha kombëtare, don të thotë me kërkue që ky komb të zhduket nga faqja e dheut. Ky komb që i ka ndenjë besnik kombësisë, ky komb që e don tepër guximin e trimninë, nuk mund të qëndrojë në gjendjen e tij të vjetër në nji kohë që ka ecë përpara, fiket e mbaron përballë sulmeve të kulturës. Prandaj gjuhën tonë duhet ta lypim me një rëndësi të veçantë...

Abdyl Beu: - Mbasi bashkohem pikë për pikë memejtimet e kolegut tonë të ndershëm, zotnisë së tij Rexhep Efendi do t'i përgjigjem Riza Beut... Shqipja asht kah mësohet zyrtarisht. Në nji kohë kur propozohet përgjithësimi e zgjanimi i mësimit të kësaj gjuhe aq sa t'i përgjigjet nevojës kombëtare, me thanë se s'asht i nevojës i nevojshëm mësimi i gjuhës (amtare), s'pajtohet as me pushtetin e ligjit, as me ndjenjat kombëtare...

Riza Beu – Nuk thashë për vete, por Shkodra s'e do...

Saif Aga (Krujë): - Mos thoni se s'e do Shkodra, ne sido që të jetë, do të këndojmë shqip; sepse edhe ne dëshirojmë përparim; me turqishten s'mund të nxamë...

Qenan Manastiri: " Një katundar që s'din fare nuk ka mundësi që t'i mësojë nevojat e jetës me një gjuhë, e cila asht e huej për të... Për mue e vetmja rrugë që mund të pengojë menden dhe dëshirën tonë me u prirë jashtë larg atdheut, asht mësimi i gjuhës shqipe. Veç kësaj, një fëmijë që nxen gjuhën e vet, që fillon me kuptue naltësinë e njeriut, që mëson rregullat e gramatikës, e ka më të lehtë të mësojë gjuhët e tjera. Prandaj, me i ndriçue me dritën e arsimit ato krahina që jetojnë në padije..., nuk asht me hezitue, përkundrazi me u përpjekë për këtë gja asht shërbimi ma i madh që i bahet atdheut e shtetit."

Riza Beu ngul kambë dhe ju thotë Bajraktarëve të Shkodrës: "Nuk e duëm p'a-as'po!"

Abdul Beu - (i nxemë) : - "Of, o Perëndi, fjalë babe!... po fyhet gjuha amtare! "Nuk e duam gjuhën amtare", megjithëse goja jonë nuk i ka hije një gjuhe tjetër. Nuk duhet të ndigjohet fjala e parë që flet foshnja e sisës, kanga e parë e natyrës që i shëmbëllen Bylbylit! Sepse kushedi përse s'e duëm? "Shokë! Natyra nuk ndrron; njeriu asht ai që asht; ne shqiptarë qemë, shqiptarë jemi, shqiptarë do të mbetemi; gjuhën tonë doemos do ta ngjallim."

Këto fjalë që u thanë shqip, u duertrokitën e mbasandaj muerën fjalë të tjerë si vijon:

Sait Aga: - Doemos të mësojmë gjuhën tonë.

Murat Aga (Gjakova): - Patjetër do të mësojmë shqip.

Jusuf Beu – Karasani (nga krenët e Malësisë): - Nuk mund të hekim dorë nga gjuha jonë; do ta mësojmë.

Halim Beu: - Do të këndojmë shqip... 9

Ibrahim Daci tha: "Pleqtë që ndodheshin në mbledhje nuk përfaqësojnë dëshirën e popullit, vullnetin e Dibrës dhe shtoi se vegjëlia që kishte ardhur tufë-tufë, do të thotë se në Dibër nuk do të mësohet kurrë alfabet tjetër, përveç alfabetit kombëtar".

* * *

Në mbledhjet e tjera u diskutuan dhe probleme të tjera të cilat u futën në pjesën e dytë të emërtuara "Nene Sekondare" ndërsa pjesa me nenet kryesore, "Nene paraprake bashkimore".

Pas 5 ditëve diskutime Kongresi e miratoi programin prej 17 pikash, ku sa i përket alfabetit dhe shkollës mori vendim që "ky të lihej në pëlqimin e vetë popullatës së çdo krahine" – le të përdoren ata shkronja që i do populli, d.m.th. se mund të përdoret edhe alfabeti turko-arab.

Pastaj xhonturqit filluan ta propagandonin vetëm atë pjesë të vendimeve që u interesonte atyre – që alfabeti sipas dëshirës donte të thoshte vetëm ai arab. Pas kësaj në territoret shqiptare ose, siç e quanin ata Arnautllëk, nga ana e xhonturqve do të fillojë një luftë e egër, sidomos pas mbajtjes së Kongresit të Dibrës, duke i shfrytëzuar të gjitha metodat, si ato: misionare, mediale, propaganduese, autoritative, intelektuale, represive ..

Pasi ndodhën të gjithë këto, pasuan edhe burgosje dhe internime të shumta, por synimeve armiqësore të xhonturqve, krahas mitigjeve dhe bojkoteve të ndryshme, populli shqiptar do t'u japë përgjigje në një Kongres tjetër me të vërtetë kombëtar – në Kongresin e Elbasanit, që i zhvilloi punimet me 2-9 shtator 1909, një muaj pas Kongresit të Dibrës.

QENAN ZIJA MANASTIRI (1863 – 1935)

Qenan Zijai lindi në Manastir, në vitin 1863. Familja e tij ishte ndër më të shquarat dhe me prestigj në qytetin e Manastirit dhe ndër etninë shqiptare në atë krahinë. Nga prindërit atdhetarë, trashëgoi jo vetëm dashurinë për vendlindjen, por edhe idetë që potenconin veprimtari të guximshme për krejt trojet shqiptare. Qenan Zijai mori arsim të plotë dhe të mirë për kohën dhe mbaroi një nga shkollat ushtarake. Edhe shpirti i tij do të frymëzohej prej atyre punëve të dobishme që patën kryer asaj kohe, shqiptarët në Stamboll ku ai bëri studimet dhe ishte në rrethet më të shquara të njerëzve patriotë.

Në muajt tetor-nëntor 1877, në Stamboll formohet "Komiteti për Mbrojtjen e të drejtave Kombëtare Shqiptare". Burime të historiografisë sonë, flasin qartë se nismëtarë të këtij komiteti, ishin Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Zija Prishtina etj. Edhe pse në moshë të re si student, Qenan Zijai,duke përfituar edhe nga pozita e lartë shoqërore dhe ekonomike, nga e cila vinte, hyn në rradhët e këtij komiteti me besimin e palëkundur për t'i shërbyer çështjes shqiptare.

Prej në vitin 1906 e më pas është ndër nismëtarët e krijimit të Klubit të Manastirit në vitin 1908. Fillimisht, si gjithë patriotët e tjerë, edhe Qenan Zijai do të përkrahte politikat dhe reformat e turqve të rinj, duke shpresuar në ditë më fatlume për krejt bashkëkombasit e vet. Por vetëm disa muaj më pas, ndërsa ndiqte me vëmendje diktaturën e re që turqit e rinj donin të montonin në krejt popujt e robëruar, ai pati forca të ngrihej menjëherë kundër tyre. Ai në disa tubime në Manastir e rrethina u shpreh se shqiptarët u ngritën vetëm për shkollat e gjuhën shqipe, pa ndihmën e askujt dhe vetë do ta çojnë deri në fund luftën e tyre. Ndërkaq në Manastir, në vjeshtën e vitit 1908 ishte mbajtur kuvendi madhor i abecesë shqipe.

Po xhonturqit me anë të Ministrisë së Arsimit të Turqisë, urdhëruan e ndaluan në shkollat shqipe të përdorimit të alfabetit me germa latine dhe i detyruan mësuesit të përdornin alfabetin me germa arabe. Qenan Zija Manastirliu, ishte ndër atdhetarët e parë që protestoi për këtë veprim dhe zëri i tij u ndie i fuqishëm në disa tubime me ç'rast u përshëndet prej qindra njerëzve të thjeshtë.

Ndër kulmet e atdhetarisë së Qenan Zijait, mund të merret edhe pjesëmarrja dhe qëndrimi i tij në Kongresin e Dibrës. Në veprën e tij "Kongresi i Dibrës" Qenan Manastiri shpalos me autencitet historinë e këtij Kongresi dhe të Dibrës në veçanti, të kësaj treve me histori aq të lashtë e trimërore. Veç shumë të tjerash që paraqiten në libër, vend të nderuar zë thënia lapidare në kundërvënie ndaj "turçelive" konservatoreve. Qenan Manastiri u thotë në shqip, me zërin e fortë duke iu drejtuar kongresistëve të pranishëm : "Burra na jena shqyptarë e gjuha e jonë asht shqipja. Nana na e ka mësue e s'duhet me e harrue askurrë. Jo vetëm në kët kuvend por edhe jashta tij na duhet me folë veç në gjuhë të nënës". Në fakt në Kuvend fitoi rryma e patriotëve përparimtarë shqiptarë, gjë që e paraqet me hollësi në librin e tij.

Vitet që rrodhën më pas, treguan pikërisht se biri i Manastirit do t'u mbetej kurdohere besnik i ideve dhe mendimeve të shpalosura në Kongresin e Dibrës. Me të shkuar në vendlindje, ai ndërmerr hapa konkrete duke ndikuar në ato pak shkolla të çelura që alfabeti me germa latine të përparonte sa ma shpejt. Në kontakt me Feim bej Zavalanin si edhe atdhetarë të tjerë shqiptarë, ndihmuan shtypjen e abetareve shqipe si edhe paguan nga të ardhurat e tij, patriotë të veçantë me ç'rast duke mos përfillur rreziqet, do të mund t'i shpërndanin këto abetare, në krejt trevat e Vilajetit të Manastirit. Për të hedhur dritë mbi ate çka u vendos në Kongrein e Dibrës,në vitin 1912,Qenan Zija Manastiri, boton në Stamboll, në gjuhën turke, ngjarjet kryesore të këtij kuvendi. Qëllimi me këtë rast ishte i dyfishtë. Të lexohej ky libër edhe prej shqiptarëve që nuk lexonin dot në gjuhën e tyre, por edhe prej intelektualëve turq të asaj kohe të cilët patën dëgjuar diçka mbi ngjarjet në Dibër, në vitin 1909. Në vitet që rrodhën më pas, Qenan Zijai do të mbetej padyshim një prej personaliteteve më të spikatura në Manastir e rrethina.

Vdes në vitin 1935 në Stamboll, larg njerëzve që i kish dashur, që pat jetuar e luftuar,që pat qarë e qeshur. Sidoqoftë edhe në çastin e mbramë, në gjirin e ngrohtë të familjes, kujtoi pikërisht Manastirin, atë tokë të shenjtë të vendlindjes.

Përkundrazi, në përpjekjet tona për të ndriçuar sa ma shumëveprën e tij, mendoj se është edhe nderimi i thellë për shqiptarin e madh Qenan Zija Manastirin, birin dhe burrin e shquar të Manastirit e Shqipërisë.

HAKI SHAROFI - MËSUES I POPULLIT (1894 – 1993)

Haki Sharofi ka një veprimtari aktive plot 63 vjet. Veprimtaria e tij në disa fusha, si në atë të mësuesit, studiuesit, publicistit, shqipëruesit, orientalistit, poetit dhe luftëtarit trim në mbrojtje të trojeve të veta e bën atë një personalitet të shquar të kulturës dhe qenies shqiptare.

Krahas punës së pasionuar të mësuesit, Haki Sharofi, u ka lënë brezave të dokumentuar heroizmin dibran nga lashtësia deri në ditët tona, në dy vëllime. Këto vëllime, djemtë e tij, në kuadrin e 75- vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, patën mirësinë, t'ia dhuronin bibliotekës së Peshkopisë. Këto punime janë një kontribut me vlerë për historinë krahinore të Dibrës, në veçanti dhe atë kombëtare në përgjithësi. Ato shquhet për kulturë shkencore, vërtetësi historike dhe interpretim të faktit.

Me interes të veçantë janë studimet: "Figura e Skënderbeut në Dibër" dhe lokalizimi i disa betejave të kësaj epoke në këtë trevë; "Studime mbi historinë e lashtë të Dibrës", "Dibra në prag të shpalljes së Indipendencës", "Ndërtimi i qytetit të Dibrës", organizimi shoqëror, etj. Bashkë me Ismail Strazimirin e Haki Stërmillin, është autor i monografisë "Djelmnia Dibrane". Ai na ka lënë mbi dhjetë jetëshkrime të shkurtra të figurave atdhetare dibrane, si: "Hoxhë Voka", "Kreshniku i Dibrës" (Elez Isufi), "Hamdi Ohëri", "Vehbi Agolli", "Hoxhë Muglica", etj.

Në çastet kulmore të atdheut, Sharofi shpërthen dhe si poet. Poezia e tij është domethënëse, e ndjeshme, e fuqishme, politike, që priret e mbështetet në tabanin kombëtar. Të tilla janë: "Drin, o lum i gjanë", "Një malësori", "Dita e Flamurit", etj.

Fushat e veprimtarisë së Haki Sharofit janë të shumta dhe shumë përparimtare, ndonëse ishte nga eruditët më të shquar që e radhisin Sharofin ndër teologët më të shquar shqiptarë të shekullit XX. Një eveniment shumë domethënës është dhe sjellja shumë civilizuese e Haki Sharofit si baba, si prind. Zonja Avdije Alibali, "Mamica e Skënderbeut", artiste në Tiranën e viteve të para të pas çlirimit që e çoi jetën në internime, "ishte bijë e familjes Sharofi nga Dibra e Madhe. Avdije Alibali, kur kujton të atin, e përcjell këtë mesazh me peshë sidomos për të tashmen tonë! "Teolog i shquar babai im, Haki Sharofi, më la të bëhem artiste."

Nëse do të flitnim për meritat e tij, më thotë mendja se do të duhej një studim i plotë, por kjo nuk është objekti ynë , ndoshta dhe mundësia, por unë do të veçoja meritën e madhe të zotit Haki Sharofit në përkthimin dhe botimin e librit të vyer "Kongresi i Dibrës" të patriotit të shquar Qenan Zija Manastirit.

"Dashuria për atdhe, flamur e gjuhë amtare, – ka shkruar Sharofi, – na armatosi ne mësuesve të parë të çajmë errësirën me grykën e pushkës e majën e penës."

Në vitin 1993, pas vdekjes, iu dha titulli "Mësues i Popullit"për meritat e tij të shquara në arsim.

Burime:

1. Haki Sharofi, "Kongresi i Dibrës", f.65
2. Hafiz Ali Korça, "Shtatë ëndrrat e Shqipërisë",viti 1924, faqe 28
3. Qenan Manastiri, Kongresi i Dibrës, f. 10
4. Po aty, f. 10
5. Po aty f. 15
6. Po aty f. 16
7. Po aty f. 22, 23
8. Citimet nga fq. 23, 24, 25

* Arkivi i Institutit të Historisë, dosja A-VII-63

9 Qenan Manastiri, Kongresi i Dibrës, f. 31, 32, 33, 34

fisnikëri

Marka Ndreca ra në krye të detyrës më 1.01.1954 në shërbim të popullit në atë mot me stuhi dëbore në Zabel të Nikës duke kryer misionin në shërbim të rendit.

Lum ç`sokola ka le Lura, si Marka Ndreca, burrë mbi burra...

Nga MEVLUD BUCI
Poet, studiues, publicist.

Koha dhe jeta, njerëzit dhe traditat, bëmat dhe vlerat, sikur blerojnë, ato nuk vyshken, sepse gjurmët rrezatojnë, ndaj kurdoherë mbeten frymëzim për brezat. Madhështia, thjeshtësia, provat, përkushtimi, shembëllimi dhe nderimi për popullin, për detyrën e besuar, ngjajnë me mineralet, kurrë nuk treten. Lura (bajrak), Lura e besës dhe e qëndresës, e bijve për liri e për flamur, e "300 nuseve me duvak", u flet kohërave me gjurmët e atyre që jetojnë në altarin e lirisë. Ndër ata bij fisnikë është e do të jetë edhe Marka Ndreca.

* * *

Lura dhe lurjanët janë treva e Karareve, të cilët përbëjnë modelin e drejtësisë, e veçantë kjo dhe rrezatuese. Me Kararet e kullëse të fisit u rrit dhe u edukuia Marka Ndreca. Historia e dëshmon dhe e gdhend me provat e qëndresës, të mirësisë dhe të vlerave. Geni i të parëve të Marka Ndrecës dëshmon për atdhetari e luftë për të mbrojtur trojet, për liri e për flamur.

Epika historike thotë:

Dedë Mardoda e Can Neka
Po luftojnë me dy kuçedra.

Para vitit 1900, në këto beteja shquhet edhe paraardhësit e Marka Ndrecës, deri te babai Ndreca, që vrau më sëpatë dy pushtues austriakë, e më pas mbeti i vrarë nga armiqtë, në moshë të re. Histori jete e qëndrese, plot dinjitet për atdhe e liri. Breza të patundur për trojet e veta, për këtë tokë të përgjakur, për të ardhmen e brezave.

* * *

Marka Ndreca u lind më 10. 05. 1916 në Lurë të Vjetër. Ndonëse që në moshë të vogël mbeti jetim, ai u edukua me traditat e fisit, të dajave, të Doçit të atdhetarisë. Përfundoi katër klasë të shkollimit në Lurë me mësues, të nderuarin Tërshana, Jashar Kaci, Halit Gjon Doçi etj. Shquhej për intelekt e zgjuarsi. E tregoi edhe jeta se ishte "me pak shkollë e mendjehollë, jo shumë shkollë e mendjeshollë".

Ai u ndihmua dhe u strehua në shtëpinë më të afërt të trungut familjar të Dodë Bibë Vladit. Ishte nip te fisi atdhetar i Doçit. Mbasi u rrit dhe u martua, ndërtoi kullën me mure guri ku, në krye të derës, u gdhen e u skalit shqiponja me flamurin kuq e zi në vitin 1940 nga mjeshtri i Fanit të Mirditës, Llesh Vorfi.

Marka Ndreca përkrahu luftën NAÇL dhe dha ndihmesë në strehimin e partizanëve dhe në paqtimin dhe vllazërimin në popull. Ai u rrit dhe u burrërua në llogoret e luftës, në shtigjet e lirisë. "Marka Ndreca-shkruan Nezir Mena-bashkë me shokun e tij, Llan Kacin, Ahmet Përlekën, Selman Bucin, Dedë Bibë Vladin, Cen Morisenin, Kolë Dedën, Gjon Dedën, Isuf Dullë Hotin i pritën forcat partizane me përzemërsi dhe i strehuan në shtëpitë e fshatarëve. Ai, së bashku me Dodë Bibë Vladin dhe Bibën, djalin e tij, në kishën katolike të Fushë-Lurës, strehuan komandën e Divizionit të Parë, Dali Ndreun dhe Mehmet Shehun me anëtarë të tjerë të shtabit, ku u krijuan kushte jo vetëm përbanim, por edhe për punë të rëndësishme. Kur hynë forcat partizane në Lurë, nuk pati asnjë të vrarë, as nga lurasit, as nga partizanët. Kjo ishte meritë e Markut dhe Dodë Bibës me shokë.

Pas çlirimit, ai shërbeu në detyra të ndryshme, në Komandën e Vendit në Lurë dhe në Selishtë të Dibrës. I zgjedhur në organet drejtuese të pushtetit lokal në Lurë dhe si kryetar i organizatës së Frontit Demokratik të Shqipërisë për Lurën, Marka Ndreca me shokët e tij: Ramadan Gjoka, Ahmet Përleka, Osman Musa, Selman Buci, Ramadan Mena, Ahmet Kaçorri, Bibë Doda, krijoi këshillat antifashiste nacional-çlirimtare në Lurë. Ai luftoi për mbajtjen e rendit e të qetësisë, si njeri I maturisë, besës, urtësisë, pajtimit dhe i provës në ballë të detyrës. Bashkëpunon me Sheh Muratin duke forcuar e dritësuar bashkëjetesën fetare, pajtimin e gjaqeve, thelloi luftën kundërkrimit dhe konflikteve në vitet e para të pushtetit popullor. Ai njohu dhe fitoi konsideratat e figurave të larta të kohës si Haxhi Lleshi, Jashar Mezenxhiu, Banush Goxha e shumë kuadro të tjerë drejtues në Dibër, MPB nëTiranë etj, sepse ishte i zoti për t`i kryer detyrat e besuara, i drejtë, i vendosur, misionar dhe vizionar.

Im atë, kur isha mësuesi ri, më thoshte:"Ne Lukani dhe zona e Katër Grykëve (Selishtë) nuk e harrojmë ish-shefin e sigurisë së rendit, Lurajanin Marka Ndreca dhe Bibë Dodë Vladin, që na kanë shërbyer si u ka hije. Ishin burra me karare, me urti e të guximshëm".

Vërtet, Marka Ndreca ka lënë gjurmë të urtësisë prej intelektuali fisnik e punonjësi të devotshëm. Muza populloore, të urtët, më pleqtë, shpesh në dasma e valle të odave në Lukan, Selishtë, Lurë kujtojnë Marka Ndrecën për provat në shërbim të njerëzve. Në një

dasëm në Lukan të Dibrës, kur martohej një djalë i vetëm, në fillim të viteve 50, ishte i pranishëm edhe Marka Ndreca. Banorët iu lutën, që, sipas traditës të merrnin pushkë për këtë gëzim, -tregon Dr. Hazis Ndregjoni. Marku u tha:Ju që i keni me leje dhe ata që i kanë të fshehura, të qëllojnë, vetëm të mos bëjnë aksident, më pas t`i dorëzojnë vetë sipas ligjit". Ashtu u bë dhe malësorët e mbajtën fjalën.

Marka Ndreca ishte valltar i talentuar, kënaqte të tjerët me vallet e tij, njihte mirë shpirtin dhe artin e popullit. Së bashku me bashkëshorten, Dilen, punuan dhe jetuan si u ka hije. Marku la tre djem: Ndrecën, Leninin dhe Dedën. I treti ende nuk kish lindur kur Mar ra heroikisht. Fëmijët e vegjël u rritën nën kujdesin e nënë Dilës, një grua burrneshë, nënë dhe veprimtare e shquar, drejtuese e grave lurjane, shembull i traditave të kullës së Lleshit të Mërkurthit, ku ishte bijë dhe e vlerave të fisit Lufi ku ishte mbesë. Nënë Dila rriti dhe edukoi djemtë me vlerat e kullës dhe të fisit, me dashurinë për dije. Më i madhi, Ndreca, u bë mjek I përkushtuar dhe shërbeu në disa zona si: Reç, Lurë, Kurbnesh. Lenini dhe Deda u bënë oficerë karriere dhe shërbyen me devotshmëri në forcat e armatosura deri sa dolën në rezervë. Lenini doli në pension me gradën e nënkolonelit, ndërsa Deda, me gradën e majorit. Në derën e kullës së Marka Ndrecës ku është shqipja dykrenore e gdhendur, sikur rilind vepra e Markut dhe e Dilës, të cilët lanë aty gjurmë fisnikërie dhe atdhetarie.

Si vetë shqiponja e gdhendur në gurin e derës së kullës, janë gdhendur veprat e burrërisë, të Marka Ndrec Vladit, këtij luriani të qëndresës, i cili rron në zemrat e brezave, në altarin e lirisë dhe të historisë.

Marka Ndreca ra në krye të detyrës më 1. 01. 1954 në shërbim të popullit në atë mot me stuhi dëbore në Zabel të Nikës duke kryer misionin në shërbim të rendit. Provat prej luftëtari dhe aksionet për rindërtimin e vendit, ndihmesa në pajtimin e gjaqeve, në sigurimin e bashkëjetëses fetare, në vëllazërimin e pajtimin në popull do t`u rrezatojnë brezave. Jeta etij është një flakadan lirie, se ai luftoi dhe ra në kryetë detyrës, ndaj për të nuk do të mjaftonin dhjetëra shkrime, poema, balada, këngë.

* * *

Sot, 22 nipër dhe mbesa shkojnë në gjurmët ku rrezatojnë vlerat e Marka Ndrecës dhe i çojnë ato më përpara. Marku i Ri, prej këtu e27 vitesh është emigrant në Gjermani. Edhe atje, ai i manifeston këto vlera që i përcjell gjyshi dhe gjyshja e tij. Edhe nuset e djemve si Martine Kolmarku, Tereze Vorfi, Frosina Koçi krenohen me vjehrrin dhe vjehrrën e tyre.

Për figurën e Marka Ndrecës, poeti Halim Laçi ka shkruar këto vargje:

Shtëpi e Markut me mur guri,
Pushka e varë mbështet për muri,
Sofra shtrue natë e ditë,
Luftë me hasmin grykë për grykë.
Në krye të sofrës, në kuven me burra,
Marka Ndreca nga Lura,
Emri i Markut nuk harrohet
Brez pas brezi do të kujtohet,
Vazhdoi punën në shi e në borë
Në krye të detyrës ra dëshmor. .

Si kjo epikë e madhërishme është veprae Marka Ndrecës, i cili në moshën 37-vjeçare, ra për të mos u harruar kurrë. Dhe zemra të thotë që ky shkrim të mbyllet me epikën më të re:

Nipi Doçit, i Doç trimërisë,
Ra në detyrë në armë të policisë,
Lum ç`sokola ka rrit Lura
Si Mark Ndrecën, burrë mbi burra. .

Si vetë shqiponja e gdhendur në gurin e derës së kullës, janë gdhendur veprat e burrërisë, të Marka Ndrec Vladit, këtij luriani të qëndresës, i cili rron në zemrat e brezave, në altarin e lirisë dhe të historisë.

Elegji Abdurahim Ashiku

ATA SOT JANË PËRSËRI BASHKË...

Ata, Resmia dhe Hajriu,
sot janë përsëri bashkë...
Resmie Hoxha (Kaba)
Hajri Hoxha, Hoxhvogli...
Në tjetër botë,
Në tjetër jetë...
Larg djemve,
Ndriçimit e Maksit
Larg vajzës,
Anetës tej oqeanit
Nipërve, mbesave...
Miqve, shokëve,
Bashkëluftëtarëve...
Sot, në orën tre pasdite,
10 Shtator 2021
Resmie Hoxha ikën,
mes dhimbjesh...
mes lotësh,
mbledhur e derdhur
në grushtin njerëzor...
Thonë se:
Kur njeriu ikën,
pa djegë,
kur atë e përcjellin
fëmijët, nipërit, mbesat...
Shkon i lumtur...
Kështu iku
Hajri Hoxha (Hoxhvogli),
Një vit më parë...
Kështu iku sot,
Resmie Hoxha (Kaba)...
Takoje Hajriun
Dhe i thuaj:
Ju duam shumë...
Lamtumirë...

Një fotografi,
nga arkivi familjar...
Të dy bashkë
me mall e dashuri,
po ua përcjell,
miqve, shokëve,
bashkëluftëtarëve,
atyre që u deshën
DHE JU DUAN...

Mali i Robit, 10 shtator 2021

Festa e të Vjelave

Peshkopi, 8 - 9 Tetor 2021

Bulevardi kryesor "Elez Isufi"

Gjithcka që Ju dëshironi:

- Produkte BIO
- Panaire
- Muzikë
- Lojëra popullore
- Produkte artizanale
- Ture turistike

Eja në Dibër në "Festën e të Vjelave",
Të shijoni frytet, bukuritë
dhe begatinë e vjeshtës!

bashkëpunimi gjerman

Implemented by giz

World Vision

NOA

Botimi i kësaj reklame është kontribut i gazetës Rruga e Arbërit për Festën e të Vjelave

cyan magenta yelloë black